



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 439 Akti

Nr. 581 Vendimi
Tiranë, më 1.11.2022

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Ester Arapi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 28.10.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Edina Kurti**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila kërkoi konfirmim në detyrë, përfaqësuar me deklaram në seancë nga avokate Antoneta Sevdari.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, komisioneren Xhensila Pine, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e saj ligjor, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Edina Kurti, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Edina Kurti është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Edina Kurti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 16.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine (relatore).

3. Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit të hartuara nga institucionet ndihmëse, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese komisioneren Valbona Sanxhaktari, e cila deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Edina Kurti; (ii) të njoftojë subjektin se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave, thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datën 27.9.2022 subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit me qëllim njohjen me to dhe sjelljen e provave e shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës.

7. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. 3 datë 26.10.2022, ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore në datën 28.10.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

I. SEANCA DËGJIMORE

8. Në datën në datën 28.10.2022, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhgueses ndërkombëtare, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

8.1 Seanca dëgjimore u ndërpre për të vazhduar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 1.11.2022, ora 09:50.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

9. Znj. Edina Kurti ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

10. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

11. Për subjektin e rivlerësimit Edina Kurti, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

12. Pavarësisht se në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, organet ndihmëse janë ato të ngarkuara me ligj për të kryer vlerësimin e kritereve të pasurisë, figurës dhe atë profesional për subjektin e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja¹, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Edina Kurti, e cila është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2012, me nr. indeksi ***, duke konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017 të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

15. Subjekti i rivlerësimit Edina Kurti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, datë 27.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë, shtojca 2 (deklarata *Vetting*), janë si vijojnë:

1. Pasuria apartament, me sip. 66 m², ndodhur në Lagjen *, sektori ***, ***, Durrës,** blerë në vitin 2005, me vlerë 26,000 euro, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me pjesë takuese 50%.

Burimi i krijimit: (i) kredia në “Tirana Bank”, në shumën 16,000 euro; (ii) të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortit në emigracion (në shtetin grek për periudhën 1993 – 2003) dhe të ardhurat nga familja e saj, të cilat kanë shërbyer për pagesën e diferencës së çmimit të blerjes së kësaj pasurie, në vlerën prej 10,000 euro.

Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.9.2012), por pa u referuar burimi i krijimit.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni

1.1 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje² konfirmohet se në datën 28.6.2005 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj I. K. kanë blerë³ nga shoqëria “****” sh.p.k. pasurinë e llojit “apartament” me sip. 66 m², të ndodhur në Lagjen ***, ***, Durrës,

¹Raporti nr. *** prot., datë 8.1.2019, i ILDKPKI-së.

²Dokumentacioni i depozituar nga subjekti – pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (ndodhur aneksin nr. 4/2); informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2020, të ASHK Drejtoria Vendore Durrës, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 7.5.2020.

³Kontratë shitblerjeje apartamenti nr. ***, datë 28.6.2005, redaktuar nga noteri publik S. P.

për çmimin 26,000 euro. Referuar kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie blerësit kanë likuiduar çmimin e plotë të kësaj pasurie dhe kanë marrë në dorëzim apartamentin⁴.

1.2 Ky apartament figuron të jetë i regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortit I. K., me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë: Lagjja ***, ***, Durrës.

Verifikimet e kryera nga Komisioni mbi pagesën e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi dhe analiza e të ardhurave të deklaruara si burim i krijimit të saj

1.3 Siç u evidentua më sipër, në kontratën e shitblerjes së apartamentit, datë 28.6.2005, është përcaktuar se është likuiduar plotësisht çmimi i blerjes në vlerën 26,000 euro. Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar se për likuidimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie kanë shërbyer kredia e marrë në “Tirana Bank”, në shumën 16,000 euro, si dhe shuma prej 10,000 euro me burim të ardhurat e bashkëshortit nga puna e tij në emigracion dhe të ardhurat e familjes së subjektit. Subjekti ka deklaruar të njëjtat burime edhe kur është pyetur në ILDKPKI⁵.

1.4 E pyetur nga Komisioni mbi të ardhurat që kanë shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se⁶ *diferenca në shumën 10,000 euro ka si burim krijimi të ardhurat nga emigracioni i bashkëshortit në shtetin grek, si dhe kontributi i dhënë nga familja e saj përpara ndarjes me to. Kontributi i saj dhe i bashkëshortit ka qenë i barabartë për krijimin e shumës 10,000 euro.*

1.5 Sa më sipër, rezulton se si burim krijimi i kësaj pasurie kanë shërbyer: (i) të ardhurat në shumën 16,000 euro, të përfituara nga kredia e marrë në “Tirana Bank”; (ii) shuma 5,000 euro nga të ardhurat e përfituara nga puna e bashkëshortit të subjektit në emigracion në shtetin grek; dhe (iii) shuma 5,000 euro e krijuar nga të ardhurat e familjes së origjinës të subjektit.

a) Kredi në shumën 16,000 euro në “Tirana Bank”

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të administruar në dosje⁷ konfirmohet se në datën 21.7.2005 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë lidhur kontratën e huas afatgjatë me “Tirana Bank” për shumën 16,000 euro, me objekt blerjen e një apartamenti në Lagjen ***, ***, Durrës, të ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k. Rezulton se në datën 22.7.2005 kredia në shumën 16,000 euro është disbursuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit dhe po në të njëjtën datë shuma prej 15,840 euro është transferuar nga llogaria e subjektit në llogarinë e shtetasit R. K., me përshkrim “për blerje apartamenti nga Edina Maliqati⁸”.

Kolateral për sigurimin e shlyerjes së kredisë është vendosur pasuria objekt vlerësimi, e regjistruar në ZVRPP-në Durrës, në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 20.7.2005, në emër të shtetasve Edina Maliqati dhe I. K. (bashkëshorti i subjektit).

Pra, duket se pasuria objekt vlerësimi, apartamenti me sip. 66 m², është regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj përpara nënshkrimit të kontratës së huas afatgjatë me “Tirana Bank”, pra përpara disbursimit të shumës 16,000 euro në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit.

Gjithsesi, Komisioni evidentoi pagesa të kryera, në dukje për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie, edhe pas regjistrimit të saj në emër të subjektit dhe personit të lidhur, dhe konkretisht transfertën bankare të kryer në datën 22.7.2005 në shumën 15,840 euro.

⁴Në momentin e blerjes së kësaj pasurie subjekti ende nuk kishte lidhur martesë me shtetasin I. K.

⁵Referohuni procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 11.2.2016, përcjellë me shkresën me nr. *** prot., datë 16.1.2020, të ILDKPKI-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.1.2020).

⁶Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. *** të dërguar nga Komisioni.

⁷Deklarata noteriale nr. ***, datë 26.1.2009 (me deklarues drejtorin dhe zv/drejtorin e degës së “Tirana Bank” në Durrës), redaktuar nga noteri publik A. H., ndodhur aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI; shkresë nr. *** prot., datë 14.12.2021, e “Tirana Bank”, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.12.2021.

⁸Mbiemri i subjektit para lidhjes së martesës.

Nga ana tjetër, referuar kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, në momentin e nënshkrimit të saj në datën 28.6.2005, ka qenë likuiduar çmimi i plotë i saj.

E pyetur gjatë hetimit administrativ mbi mospërputhjet e evidentuara në lidhje me kohën e pagesës së çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, subjekti ka deklaruar se *për blerjen e këtij apartamenti menduan të marrin një kredi duke mos përdorur të gjithë cash-in në gjendje që dispononin. Banka kërkoi të linin kolateral një objekt në lidhje me shumën që do të marrin kredi. Ajo dhe bashkëshorti nuk kishin pasuri të paluajtshme për ta lënë si kolateral. Ndodhur në këto kushte banka u sugjeroi që meqenëse ata e kishin zgjedhur apartamentin e banimit dhe kishin rënë dakord paraprakisht verbalisht me shitësin, të lidhnin kontratën e shitblerjes me të dhe të mundësonin kalimin e pronësisë në hipotekë, duke lënë këtë apartament si kolateral. Në këto kushte, në datën 27.6.2005 kanë hartuar deklaratën noteriale për shitje apartamenti me nr. ***, në të cilën është cilësuar vlera totale e shitjes prej 26,000 euro, si dhe se shtetasit Edina Maliqati dhe I. K. deri në këtë datë kanë likuiduar vetëm shumën 10,000 euro dhe pjesën tjetër do e likuidojnë nëpërmjet kredisë bankare. Në datën 28.6.2005 është lidhur edhe kontrata e shitblerjes së këtij apartamenti me nr. **. Pavarësisht se në kontratën përfundimtare të shitjes, nënshkruar në datën 28.6.2005, kanë deklaruar se është bërë likuidimi i plotë i vlerës së apartamentit, sqaron se një numër regjistrimi noterial më parë ishte nënshkruar prej palëve deklarata noteriale ku ishte rënë dakord që shuma prej 16,000 euro do të likuidohej menjëherë pas disbursimit të kredisë⁹.*

Sa më sipër, duket se:

- Ka mospërputhje në lidhje me kohën e pagesës, si dhe burimin e të ardhurave të deklaruara për blerjen e këtij apartamenti me dokumentacionin ligjor të administruar gjatë hetimit administrativ.
- Çmimi i shitblerjes së apartamentit referuar kontratës së shitblerjes është paguar përpara datës 28.6.2005, për rrjedhojë, huaja e akorduar me kontratë në datën 21.7.2005 nuk mund të ketë shërbyer për pagesën e çmimit të blerjes në vlerën 26,000 euro.
- Nuk ka arritur të dokumentojë vlerën e paguar, kohën e pagesës.
- Nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e çmimit të blerjes për pasurinë apartament banimi në ***, Durrës, në datën 28.6.2005 në shumën 26,000 euro.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Pasi iu kalua barra e provës mbi gjetjet e evidentuara si më sipër, Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna më parë gjatë hetimit administrativ, duke parashtruar se *ajo dhe bashkëshorti (në atë kohë i fejuari) menduan të blinin një shtëpi së bashku. Secili prej tyre do të përballonte një vlerë të barabartë dhe diferencën do ta marrin me kredi. Në kushtet kur ata nuk dispononin pasuri të paluajtshme të regjistruar, banka nuk mund të jepte kredi pa kolateral. Ata kishin likuiduar shumën prej 10,000 euro, ku secili kontribuoi në mënyrë të barabartë, për pjesën tjetër prej 16,000 euro, një ditë përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes kanë nënshkruar deklaratën noteriale (deklarata e referuar si më sipër), përmbajtja e së cilës është e qartë, ku, ndër të tjera, referohet se në datën e përpilimit të deklaratës noteriale ajo dhe bashkëshorti kishin paguar shumën prej 10,000 euro dhe pjesa e mbetur do të likuidohej nëpërmjet kredisë bankare.*

Në vijim të prapësimeve të saj, subjekti ka pretenduar se *rezulton qartësisht e provuar se përpara se të nënshkruhej kontrata e shitblerjes së apartamentit, në të cilën deklarohet se çmimi i apartamentit është likuiduar i plotë, ata kishin hyrë në një marrëdhënie të re financiare.*

⁹Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentin deklarata noteriale nr. ***, datë 27.6.2005, redaktuar nga noteri publik S. P.

Në kontratën e shitblerjes ata, si palë, deklaruan likuidimin e apartamentit pasi në deklaratën noteriale kishin marrë përsipër detyrimin për likuidimin e shumës 16,000 euro. Disbursimi i kredisë me objekt blerjen e pasurisë së paluajtshme do të bëhej në llogarinë e tyre bankare dhe më pas në llogarinë e shitësit të pasurisë. Për këtë arsye, në praktikën e kredisë së bankës është marrë në shqyrtim deklaratat noteriale dhe disbursimi i shumës është bërë drejtpërdrejt në llogarinë e tyre, duke ia transferuar në të njëjtën ditë shtetasit R. K.

Si konkluzion, subjekti parashtrroi se datën e nënshkrimit të deklaratës noteriale të huas është paguar vlera 10,000 euro dhe nënshkruan deklaratën noteriale të huas me shoqërinë, e cila ishte diferenca midis apartamentit që porositën dhe vlerës së paguar. Menjëherë sapo morën kredinë e kaluan për likuidimin e huas shtetasit R. K. Sipas subjektit, deklaratat noteriale dhe kontrata e shitblerjes janë akte dhe veprime juridike plotësisht ligjore: nga njëra anë ata morën përsipër detyrimin në shumën 16,000 euro sipas deklaratës noteriale; dhe nga ana tjetër vetë shtetasi R. K. nuk do të kishte pretendime për çmimin e apartamentit në kontratën e shitblerjes. Për sa kohë që kjo shumë do të financohej me disbursimin e kredisë bankare dhe se pjesë e këtij transaksioni ishte dhe banka, shtetasi R. K. ishte i sigurt për arkëtimin e shumës, pasi vetë banka do të disbursonte kredinë në llogarinë e tyre dhe ata nuk kishin mundësi të tërhiqnin shumën apo të transferonin diku tjetër, por vetëm në llogarinë sipas objektit që ishte miratuar kredia. Në deklaratën Vetting kredia është deklaruar si burim për blerjen e apartamentit.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

Pasi vlerësoi dhe analizoi dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklaratimet e bëra nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar Vetting, shpjegimet dhe provat e depozituara gjatë hetimit administrativ dhe me prapësimet pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pasi e dëgjoi në seancë dëgjimore, trupi gjykues krijoi bindjen se shuma e përfituar si rezultat i disbursimit të kredisë nga "Tirana Bank" ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi.

Komisioni vëren se ka qenë vetë subjekti i rivlerësimit e cila ka depozituar deklaratën noteriale të përfaqësuesve të degës së "Tirana Bank" në Durrës (dokument shoqërues i deklaratës së rivlerësimit kalimtar Vetting), në referim të së cilës evidentohet fakti i regjistrimit të kësaj pasurie në emër të saj dhe bashkëshortit I. K. përpara nënshkrimit të kontratës së kredisë dhe disbursimit të fondeve përkatëse.

Parë në këtë optikë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit në asnjë moment nuk ka dashur të fshehtë apo të tregojë rrethana të pavërteta mbi mënyrën e krijimit, përfitimit, pagesat e kryera dhe/apo burimin e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi. Sjellim në vëmendje këtu se kjo pasuri është krijuar disa vite më parë se subjekti të emërohej në funksionin e prokurorit.

Kështu, rezulton se referuar deklaratës noteriale të datës 27.6.2005, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë "****" sh.p.k. ka deklaruar se shtetasit Edina Maliqati dhe I. K. deri në këtë datë i kanë likuiduar vetëm shumën 10,000 euro dhe pjesën tjetër të mbetur pa likuiduar do ta likuidojnë nëpërmjet kredisë bankare që do të merrej prej tyre, e cila do të kalonte në llogarinë e shoqërisë "****", me administrator R. K.

Pra, referuar kësaj deklarate rezulton se përpara se çmimi i shitblerjes të deklarohet i likuiduar (në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie të datës 28.6.2005) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kishin marrë përsipër detyrim monetar, duke përcaktuar qartësisht se diferenca e mbetur e papaguar në favor të shoqërisë "****" sh.p.k. do të paguhej me disbursimin e kredisë bankare, fakt i cili konfirmohet se ka ndodhur. Në këtë kuptim, duket se deklarata noteriale e nënshkruar një ditë para kontratës së shitblerjes së pasurisë, në vetvete përbën njohjen e detyrimit ndaj shoqërisë "****" sh.p.k., sa i takon likuidimit total të çmimit të blerjes së saj. Vetë fakti që detyrimi i mbetur pa likuiduar përputhet me vlerën e aplikuar për kredi nga subjekti dhe personi i lidhur tregon qartë se palët kanë pasur dijeni të plotë dhe kanë qenë në

dakordësi për veprimet, transaksionet e kryera dhe ato të cilat do të kryheshin në vijim në funksion të marrëdhënies juridike të krijuar mes tyre, me qëllimin final shitblerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

Gjatë hetimit administrativ subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.12.2021, të shtetasit R. K., në referim të së cilës, ndër të tjera, ai ka deklaruar se: “...çmimi i shitjes së këtij apartamenti ka qenë në total shuma prej 26,000 euro. Fillimisht nga pala blerëse i është dhënë shuma 10,000 euro... Shuma prej 16,000 euro i ka kaluar me transfertë bankare nga ‘Tirana Bank’ në llogarinë e tij, në datën 22.7.2005... Me palën blerëse, shtetasit I. K. dhe Edina Kurti kishin rënë dakord që kjo shumë do të kalonte menjëherë sapo të bënin procedurat në ZVRPP-në Durrës për kalimin e pronësisë sepse kjo shumë prej 16,000 euro do të merrej prej tyre si kredi tek ‘Tirana Bank’, duke lënë pikërisht këtë apartament si kolateral”.

Komisioni konstaton se si kolateral për marrjen e kredisë në “Tirana Bank” është vendosur vetë apartamenti objekt vlerësimi, i regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortit bazuar në kontratën e shitblerjes të nënshkruar në datën 28.6.2005, një ditë pas nënshkrimit të deklaratës noteriale të referuar si më sipër.

Në këtë këndvështrim, në kushtet kur vetë qëllimi i marrjes së kredisë ka qenë blerja e apartamentit të lënë kolateral, Komisioni vlerëson se shuma e disbursuar e kredisë nuk mund të destinohej në asnjë transaksion tjetër, përveçse të transferohej në llogari të palës shitëse.

Si konkluzion, trupi gjykues i gjen bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi marrëdhënien e krijuar me shoqërinë “****” sh.p.k., duke vlerësuar përfundimisht se në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pasurisë objekt vlerësimi nuk është paguar çmimi i plotë i blerjes së saj, por se është likuiduar totalisht dhe përfundimisht në datën 22.7.2005 me transferimin e shumës 15,840 euro në favor të palës shitëse, përfaqësuesit të kësaj shoqërie, shtetasi R. K., shumë e cila ishte pjesë e fondeve të disbursuara për këtë qëllim nga kredia bankare e marrë prej subjektit dhe personit të lidhur në “Tirana Bank”.

Si rrjedhim, Komisioni arrin në përfundimin se shuma e përfituar nga kredia e marrë nga subjekti dhe personi i lidhur në “Tirana Bank” ka shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

b) Të ardhurat e personit të lidhur nga puna në emigracion në shtetin grek

Komisioni konstaton se në deklaratën *Vetting* subjekti dhe/apo personi i lidhur/bashkëshorti nuk kanë deklaruar të ardhura nga emigracioni në shtetin grek.

E pyetur gjatë hetimit administrativ¹⁰ në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit me burim punën e tij në emigracion, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të detajuara¹¹, si vijon:

Për sa më sipër, subjekti ka kërkuar nga Komisioni që të ardhurat e deklaruara nga bashkëshorti në shumën 35,000 euro duhet të përllogariten në analizën financiare, bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të kohës së hershme të krijimit të tyre, përpara dy dekadave nga miratimi i paketës së reformës në drejtësi, mungesës së detyrimit të kohës për të ruajtur dokumentacionin provues, realitetit historik të emigrantëve shqiptarë (të detyruar të ndërrojnë edhe emrat), mosdepozitimit të dokumentacionit nga shoqëria diskografike etj.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji në rastet kur ka konstatuar rrethana të tilla të jashtëzakonshme si në rastin e bashkëshortit¹², në kushtet kur marrëdhënia e punësimit dhe shërbimi/puna e kryer është vërtetuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

¹⁰Pyetjet e dërguara me pyetësorin nr. ***.

¹¹Shihni rezultatet e hetimit, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konkluzionet e Komisionit në faqen 40-45 të vendimit e në vazhdim.

¹²P.sh. vendimi nr. 06, datë 17.3.2022.

Në këto kushte, në përgjigje të shpjegimit të kërkuar nga Komisioni, nuk ka mospërputhje në deklaratimet për përdorimin e këtyre të ardhurave sepse ato kanë shërbyer si burim për krijimin e gjendje cash në deklaratimin për herë të parë në vitin 2012.

Si rrjedhojë, rezultoi se bashkëshorti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e pjesës së tij të pagesës prej 5,000 euro për blerjen e kësaj pasurie.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

Komisioni, pasi shqyrtoi deklaratimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pasi analizoi dokumentacionin justifikues ligjor të depozituar në mbështetje të tyre, arrin në përfundimin se subjekti shpjegoi dhe vërtetoi bindshëm se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumës 5,000 euro, deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të ndodhur në Lagjen ***, ***, Durrës.

c) Kontributi i dhënë nga familja e origjinës së subjektit

*Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se gjatë periudhës së bashkëjetesës me prindërit dorëzonte çdo muaj tek ata pjesën më të madhe të pagës mujore (si çdo familje shqiptare). Në momentin e ndarjes nga prindërit ka qenë dëshira e babait të saj për të kontribuar me ndihmë financiare në blerjen e shtëpisë dhe mobilimit të saj. Kontributi i saj dhe i bashkëshortit ka qenë i barabartë për krijimin e shumës 10,000 euro. Gjatë periudhës së bashkëjetesës me prindërit e saj, të ardhurat e familjes kanë qenë: babai i saj E. M. ka përfituar të ardhura nga kontrata e punës me ‘***’ sh.p.k., në shumën 50,000 lekë/muaj.*

Në mbështetje të deklaratime të dhëna subjekti ka depozituar si prova të reja, ndër të tjera, dokumentacionin si vijon: (i) vërtetimin datë 29.9.2021, të shoqërisë ‘****’ sh.p.k., bashkëlidhur të cilit janë evidentuar pagesat e kryera nga kjo shoqëri në favor të shtetasit E. M. për periudhën shkurt 2001 – dhjetor 2005; (ii) licencën për drejtim punimesh (kolaudim dhe supervizion) etj., lëshuar në emër të inxhinierit E. M. (babai i subjektit); (iii) licencat e lëshuara nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për shoqërinë ‘****’ sh.p.k., ku referohet si drejtues teknik babai i subjektit E. M.; (iv) vërtetimin nr. *** prot, datë 1.10.2021, nga DRSSH Durrës, për të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit E. M.; (v) kontratën e punës të datës 1.1.2003, lidhur mes shoqërisë ‘****’ sh.p.k. dhe babait të subjektit E. M., si dhe disa kontrata shërbimi; dhe (vi) shkresën nr. *** prot., datë 29.9.2021, të DRSSH-së Durrës për të ardhurat e përfituara nga nëna e subjektit Sh. M.

Nga hetimi administrativ¹³ i kryer rezultoi se në periudhën shtator 2002 – dhjetor 2003, z. E. M. (babai i subjektit) ka kryer rikonstruksion të katit të parë dhe shtesë në 2 kate, në banesën e tij (të familjes), ndodhur në Lagjen ***, rruga ‘****’, Durrës, me vlerë të preventivit 3,673,464 lekë.

Nga ana tjetër, Komisioni konstaton se në deklaratën fillestare të pasurisë (deklarata e interesave privatë e vitit 2003, periudhë në të cilën subjekti mbante funksionin e oficerit të policisë gjyqësore), subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh cash.

Në vlerësim të rrethanave të mësipërme, sa i përket krijimit të shumës prej 5,000 euro, Komisioni paraprakisht vlerësoi që përlllogaritja e të ardhurave të subjektit dhe familjarëve të saj (prindërve) të nisë nga data 1.1.2004 deri në momentin e kryerjes së pagesës për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi (në këtë rast në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes apo një ditë para nënshkrimit të saj).

¹³Aktkolaudimi objekti “rikonstruksion banese 1 kat dhe shtesë 2 kate”, pjesë e shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.5.2020, e ASHK Drejtoria Vendore Durrës.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga DRSSH Durrës¹⁴ rezulton se të ardhurat nga pensioni i pleqërisë për prindërit e subjektit për periudhën 1.1.2004 – 28.6.2005 llogariten në vlerat përkatësisht 205,036 lekë për babain dhe 154,285 lekë për nënën.

Ndërsa, për sa i përket të ardhurave të pretenduara nga marrëdhëniet e punësimit/shërbimit të z. E. M. (babai i subjektit) me shoqërinë “****” sh.p.k., duket se nuk është vërtetuar shuma e saktë e përfituar dhe shlyerja e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga këto marrëdhënie.

Nga analiza paraprake financiare e kryer nga Komisioni duket se prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumës 5,000 euro, të pretenduara si të dhëna në favor të subjektit të rivlerësimit, të deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të japë shpjegime shtesë, si dhe të depozitojë prova të reja të mundshme në funksion të provueshmërisë së ligjshmërisë së të ardhurave të familjarëve të saj, të deklaruar si burim krijimi të shumës 5,000 euro, referuar si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna më parë gjatë hetimit administrativ, duke parashtruar, ndër të tjera, se *në deklaratën për herë të parë në vitin 2004 (për periudhën 1.1.2003 – 31.12.2003) nuk ka deklaruar likuiditete (cash dhe/ose në bankë) për vete, por pjesëtarët e tjerë të familjes nuk kanë qenë subjekt deklarues dhe për këtë arsye për vlerësimin e burimit të shumës 5,000 euro për blerjen e apartamentit në ***, llogaritja e të ardhurave të familjarëve të saj nuk mund të nisë nga data 1.1.2004. Por, pavarësisht nga sa më sipër, sipas subjektit, konkluzioni i Komisionit se “nga analiza financiare (të ardhura shpenzime) për periudhën 1.1.2004 – 28.6.2005 prindërit e subjektit nuk kanë pasur mundësi të kursenin shumën 5,000 euro në datën 28.6.2005” është i gabuar.*

Gjithsesi, subjekti ka argumentuar se edhe nëse merren në analizë të ardhurat e familjes së saj (prindërve), përfshirë edhe të ardhurat e saj të përfituara nga puna si oficerë e policisë gjyqësore nga data 1.1.2004 deri në momentin e kryerjes së pagesës në favor të shoqërisë ndërtuese, do të rezultonte se ata do të kishin mundësi për krijimin e shumës 5,000 euro për këtë periudhë¹⁵. Lidhur me këtë citon: “*Audituesja ligjore ka përllogaritur mundësinë e kursimit të prindërve të mi si më poshtë vijon:*

- *Në analizën financiare, të ardhurat nga pensioni për prindërit e subjektit E. dhe Sh. M. janë njohur sipas shkresave nr. *** prot. dhe nr. *** prot., të datës 21.12.2021, dërguar Komisionit.*
- *Në analizën financiare për vitin 2004 janë përfshirë edhe të ardhurat nga paga e subjektit Edina Maliqati, për sa kohë subjekti ka qëndruar me prindërit dhe ekonomia familjare është administruar nga babai i saj. Fakti që subjekti nuk ka deklaruar gjendje cash në vitet 2003 dhe 2004 tregon që nuk dispononte të ardhurat nga paga, pjesa më e madhe e pagës është dorëzuar në familje dhe babai ka qenë përgjegjës për administrimin e ekonomisë familjare.*
- *Dhurimi në shumën 5,000 euro në vitin 2005 duket si kompensim të kontributit të dhënë nga subjekti për atë periudhë kohore.*
- *Shpenzimet jetike janë njohur për 3 persona gjatë vitit 2004 dhe 2 persona gjatë vitit 2005. Në vitin 2005 e në vazhdim është bërë analizë financiare e veçantë për të vërtetuar*

¹⁴Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.12.2021.

¹⁵Subjekti ka paraqitur tabelën e analizës financiare, në referim të së cilës rezulton se familja e saj ka pasur mundësi financiare për krijimin e shumës 5,000 euro për periudhën janar 2004 – qershor 2005.

mundësinë financiare të krijimit të pasurive me të ardhura të ligjshme”.

	2004	Jun-05	TOTAL
Sh. M., të ardhura nga pensioni	92,748	48,811	141,559
E. M., të ardhura nga pensioni	133,038	70,998	204,036
E. M., të ardhura nga puna	600,000	300,000	900,000
Edina Maliqati, të ardhura nga paga	547,532		547,532
Shpenzime jetike 3 (2004) dhe 2 (2005)	281,892	109,557	391,449
Mundësia për kursim	1,091,426	310,252	1,401,678
Shuma e dhuruar 5,000 euro në datë KK: 123.86			619,300
Balanca			782,378

Si konkluzion, referuar analizës financiare për periudhën 1.1.2004 – 27.6.2005, rezulton se babai i subjektit ka pasur një balancë pozitive prej 782,378 lekësh, në të cilën është zbritur më parë edhe shuma të cilën i ka dhuruar subjektit.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

Pasi shqyrtoi me objektivitet dhe paanësi provat e depozituara dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet kur rezulton se para fillimit të bashkëjetesës subjekti i rivlerësimit ka banuar me prindërit e saj, Komisioni gjen me vend pretendimin e saj se ata kanë funksionuar si një ekonomi e përbashkët familjare, e në këtë kontekst vlerëson se edhe të ardhurat e subjektit të përfituara nga puna e saj për këtë periudhë mund të kenë shërbyer si burim krijimi i shumës 5,000 euro. Gjithashtu, pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* gjendje në fund të vitit 2004, trupi gjykues çmon se kjo nuk do të thotë se një pjesë e të ardhurave të përfituara nga puna e saj të mos jenë ruajtur nga prindërit, pasi më parë janë dorëzuar nga subjekti tek ata në kuadër të ekonomisë së përbashkët familjare. Në këtë kuptim duket i besueshëm deklarimi i bërë nga subjekti se prej familjes së saj i është dhënë shuma prej 5,000 euro në momentin që ajo dhe i fejuari (sot bashkëshorti) vendosën të blinin një apartament banimi.

Gjithashtu, pavarësisht se rezulton se disa të ardhura të pretenduara si të përfituara nga puna e kryer prej babait të saj nuk janë të dokumentuara në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerëson se bazuar në nenin 246 të Kodit të Procedurës Civile shkresa e shoqërisë “****” sh.p.k. merr fuqi provuese për efekt të këtij procesi, për sa kohë gjen mbështetje dhe harmonizohet me provat, të dhënat dhe informacionet e tjera të grumbulluara në kuadër të hetimit administrativ të kryer (si kontrata e punës e vitit 2003, licencat e lëshuara në emër të shoqërisë ku evidentohet si drejtues teknik babai i subjektit, si dhe licencat me anë të të cilave provohet se z. E. M. mban titullin inxhinier). Kjo situatë duhet parë edhe në këndvështrim të informalitetit të kohës, si dhe të faktit se legjislacioni fiskal në Shqipëri ngarkon punëdhënësin të kryejë rolin e agentit tatimor për mbajtjen dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga pagat. Në këtë kontekst, Komisioni vlerëson edhe përpjekjen e bërë nga subjekti për disponimin e informacionit nga organi tatimor, sa i përket marrëdhënies së punësimi të babait të saj me shoqërinë e sipërcituar. Mund të supozohet se nga tërësia e të ardhurave të pretenduara dhe/apo të dokumentuara si të përfituara nga subjekti dhe prindërit e saj për periudhën objekt analize, të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga puna e babait të subjektit në shoqërinë “****” sh.p.k. mund të kenë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve familjare, duke mos cenuar në vetvete ligjshmërinë e të ardhurave të tjera të cilat mund të kenë shërbyer për krijimin e shumës 5,000 euro.

Referuar analizës së kryer dhe vlerësimit të të gjitha rrethanave dhe fakteve të pasqyruara si më sipër, bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, Komisioni krijoi bindjen se subjekti dhe familja e saj (prindërit) kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të

cilat mundësonin plotësisht krijimin e shumës 5,000 euro, të deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, të përfituar me kontratën e shitblerjes së datës 28.6.2005.

Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se janë deklaruar saktë të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi, si dhe se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të cilat mundësojnë plotësisht kryerjen e pagesës për likuidimin e çmimit të blerjes së saj.

2. Pasuria e llojit “automjet”, tip “**”, blerë në tetor të vitit 2010, me vlerë 8,000 euro (duke përfshirë edhe pagesën e detyrimeve doganore). Automjeti mban targën *** dhe është i regjistruar në emër të personit të lidhur, bashkëshortit I. K.**

Burimi i krijimit: kredi e marrë tek institucioni financiar NOA, në shumën 1,200,000 lekë.

Komisioni konstaton se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.9.2012) subjekti ka deklaruar këtë pasuri, të dhënat dhe vlerën e saj, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Gjithashtu, rezulton se në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate subjekti ka deklaruar kredinë e marrë tek “****” (sot NOA), në shumën 1,200,000 lekë.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

2.1 Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja¹⁶, konfirmohet se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka pasur të regjistruar në emrin e tij automjetin tip “****”, me targa ***, i cili aktualisht mban targën ***.

2.2 Nga verifikimi i dosjes, Komisioni konstaton se: (i) në datën 30.9.2010 bashkëshorti i subjektit e ka blerë këtë automjet në Gjermani në shumën 6,100 euro; (ii) në datën 8.10.2010 janë paguar detyrimet doganore në shumën 287,800 lekë; dhe (iii) në datën 7.7.2017 personi i lidhur ia shet këtë automjet shtetasit I. C. për shumën 8,000 euro, konfirmuar si e likuiduar nga blerësi në llogarinë bankare të shitësit në “Credins Bank” (deklaruar në DIPP/2017).

Analizë e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi të kësaj pasurie

2.3 E pyetur më parë nga ILDKPKI-ja¹⁷ lidhur me këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për blerjen e këtij automjeti ka shërbyer si burim kredia e marrë tek institucioni financiar NOA në shumën 1,200,000 lekë.

2.4 Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga institucioni financiar NOA¹⁸ rezulton se në datën 6.8.2010 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti I. K. kanë nënshkruar kontratën e huas me shoqërinë “****” sh.a. (sot NOA) për shumën 1,200,000 lekë, me objekt blerjen e një apartamenti banimi, kredi e cila figuron të jetë likuiduar plotësisht në datën 6.8.2015.

2.5 Më konkretisht, nga verifikimi i dokumentacionit, pjesë e dosjes së kredisë, rezulton se me kontratën e huas të lidhur në datën 6.8.2010, me palë Edina Kurti dhe I. K., në cilësinë e huamarrësve, shoqëria “****” sh.a. në cilësinë e huadhënësit dhe z. I. M. në cilësinë e dorëzanësit, kanë marrë kredi në vlerën 1,200,000 lekë nga ky institucion financiar, siguruar me barrë sigurorese.

2.6 Në nenin 1.2 të kësaj kontrate është parashikuar se huaja do të përdoret për financimin e nevojave për blerje apartamenti, ndërsa në nenin 9.1 është përcaktuar se për të siguruar shlyerjen e huas janë vendosur si barrë sigurorese pasuritë: (i) pajisje shtëpie; (ii) pajisje biznesi

¹⁶Shkresë nr. *** prot., datë 23.1.2020, e DPSHTRR-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 24.1.2020.

¹⁷Referohuni procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 11.2.2016, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2020, të ILDKPKI-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.1.2020.

¹⁸Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020, e institucionit financiar NOA, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 29.1.2020; shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2022, e institucionit financiar NOA, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 23.2.2022; shkresë nr. *** prot., datë 15.3.2022, e institucionit financiar NOA, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.3.2022.

(pajisje të ndryshme elektronike për riparim TV-je; si dhe (iii) automjet i vlerësuar në shumën 1,200,000 lekë sipas formularit të vlerësimit të kolateralit.

2.7 Referuara informacionit të dërguar nga institucioni financiar NOA, duket se vlera e përfituar nga kredia prej 1,200,000 lekësh në datën 9.8.2010 është disbursuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit dhe se po në këtë datë duket se është transferuar nga personi i lidhur “pa përshkrim”, shuma prej 1,176,000 lekësh.

2.8 E pyetur nga Komisioni lidhur me qëllimin e marrjes së kredisë dhe destinacionin dhe/apo përfituesin e shumës prej 1,176,000 lekësh të transferuar nga personi i lidhur në datën 9.8.2010, subjekti ka shpjeguar se *destinacioni i shumës së tërhequr nga bashkëshorti ka qenë për blerjen e mjetit. Tërheqja e shumës prej 1,176,000 lekësh është kryer në datën 6.8.2010 në formën e çekut bankar dhe nuk është kryer asnjë transaksion apo transfertë e kësaj shume nga bashkëshorti I. K.*

2.9 Në vijim, e pyetur mbi marrëdhënien e huamarrjes me shoqërinë “***”, mospërputhjet e konstatuara mbi qëllimin e marrjes së kredisë, si dhe mbi pasuritë e deklaruara për të siguruar shlyerjen e saj, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se *në diskutim për mënyrën e financimit për blerjen e makinës me kolegun e tij të punës, shtetasin Y. Ç., ky i fundit i tregoi bashkëshortit të saj, se kishte marrë një kredi pranë institucionit financiar “***” sh.a. dhe ishte shumë e thjeshtë si aprovimi ashtu edhe dokumentet që kërkonin. Nga eksperiencia që ky shtetas kishte me këtë institucion, i sqaroi bashkëshortit që duhej një person dorëzanës dhe shprehu vullnetin që do t’i dilte ai, meqenëse kishte edhe një kredi pranë këtij institucioni.*

Objekti i kredisë është vendosur nga vetë oficeri i kredisë. Të gjitha procedurat dhe diskutimet me këtë institucion financiar janë ndjekur nga bashkëshorti. Nuk ka treguar vëmendje në dokumentacionin e përpiluar nga shoqëria, por nga sa kujton, kur kanë shkuar të firmosin kredinë dhe janë njohur me planin e amortizimit, ka vënë re që interesat që duhet të paguanim kanë qenë shumë të larta.

Në lidhje me vlerën e automjetit të pretenduar të lënë kolateral, sqaron Komisionin se kjo vlerë është e njëjta me vlerën që ata kërkuan të financoheshin me kredi për blerje automjeti. Në formularët e kredisë rezulton se automjeti kolateral ishte i padokumentuar, bashkëshorti në informacionin e dhënë oficerit të kredisë i shprehu idenë se automjeti që kërkonte të blinte mund të kushtonte maksimalisht 9,000 euro. Për këtë arsye, oficeri i kredisë vendos si kolateral, por të padokumentuar, automjetin që do të blihej nga bashkëshorti. Të gjithë formularët e plotësuar pjesë të dosjes, përcaktojnë se automjeti është i padokumentuar.

Nëse objekti i kontratës së kredisë do të kishte qenë vërtet me qëllim “pagesën e këstit të apartamentit”, do të thotë që duhet të kishte ekzistuar më parë një kontratë porosie ose kontratë shitjeje me kusht. Gjithashtu, në dokumentin “Check List dokumentacion për dosjen e kredisë” do të ishte pjesë e dokumentacionit përshkrimi dhe referimi i kontratës së porosisë si dhe datës përkatëse. Në dosjen e kredisë nuk ka asnjë informacion që lidhet me identifikimin e pasurisë për të cilën do të paguhej kësti i financiar nëpërmjet kredisë.

Informacioni në lidhje me pasurinë e luajtshme të bashkëshortit është vetëm vlera e automjetit të padokumentuar në shumën 1,200,000 lekë, që përputhet me shumën e kredisë së marrë dhe destinacionin real të përdorimit të saj.

*Në deklaratën Vetting është deklaruar si burim për likuidimin e çmimit të blerjes së automjetit kredia e marrë nga institucioni financiar “***” sh.a., bazuar në parashikimet e nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe të pikës 7 të udhëzimit nr. ***, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, duke deklaruar në këtë mënyrë burimin e përdorur prej tij për këtë pasuri, në momentin e krijimit/fitimit të saj.*

2.10 Komisioni paraprakisht vlerësoi se nga institucioni financiar nuk mund të merrej si kolateral i ardhshëm një automjet i cili do të blihej në të ardhmen nga kredimarrësi. Gjithashtu, megjithëse në kreditë konsumatore për arsye të shpejtësisë së miratimit të saj dhe normave të

larta të interesave nuk kërkohet dokumentacion i plotë për dosjen e kreditimit, nga ana tjetër arsytet e këtij financimi janë deklaruar nga vetë kredimarrësit për blerje apartamenti.

2.11 Për sa më sipër, duket se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kredia e marrë në institucionin financiar “***” të ketë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi. Me dërgimin e rezultateve të hetimit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

2.12 Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit lidhur me konstatimet e bëra nga Komisioni për pasurinë e llojit “automjet” dhe burimin e deklaruar për krijimin e saj, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar duke argumentuar si vijon:

- *Në lidhje me kredinë konsumatore të marrë pranë institucionit financiar NOA sh.a. nuk ka deklaruar se automjeti që do të blinin është lënë kolateral në institucionin financiar, por oficeri i kredisë në listën e asetëve të lëna si kolateral në seksionin B ka përfshirë edhe automjetin 1,200,000 lekë si pajisje e padokumentuar.*

- *Vetë oficeri i kredisë së institucionit financiar NOA¹⁹, në përshkrimin e pasurisë ka deklaruar “pajisje e padokumentuar e tashme dhe e ardhme. Përshkrimi “automjet, pronari I. K.”. Në përgjigje të pyetësorit i është referuar këtij përshkrimi për të dhënë shpjegimet e saj dhe për të vërtetuar faktin se bashkëshorti i ka deklaruar oficerit të kredisë se qëllimi i marrjes së kredisë ka qenë për blerje automjeti në shumën që kërkonte financimin, pra 1,200,000 lekë.*

- *Në asnjë rast nuk mund të shërbente kredia e marrë pranë institucionit financiar NOA si burim për blerje apartamenti. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk rezulton që ajo apo bashkëshorti të kenë nënshkruar ndonjë kontratë për blerje apartamenti në vitin 2010. Komisioni i referohet kësaj kredie si kredi konsumatore, në të cilën nuk kërkohet që objekti i kredisë të përputhet me veprimin dhe domosdoshmërinë e përdorimit të kredisë.*

- *Vlerëson se është tashmë fakt i njohur se këto institucione financiare kanë plotësuar praktikën e kredisë sipas produkteve financiare që vetë këto institucione kanë patur. Vlera e blerjes së një apartamenti është disa herë më e lartë se shuma 1,200,000 lekë që bashkëshorti ka kërkuar të financohej.*

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se sikurse e ka deklaruar edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, nevoja e familjes për blerjen e këtij automjeti erdhi si rezultat i ndryshimit të punëdhënësit të bashkëshortit dhe rrethanave të reja të kushteve të punës.

Vlerësimi përfundimtar i bërë nga Komisioni/analiza e shpjegimeve dhe provave

2.13 Nga verifikimi i dokumentacionit, pjesë e dosjes së kredisë të marrë në “***” sh.a. (sot NOA), Komisioni vëren se kërkesën për marrjen e kësaj huaje e ka bërë bashkëshorti i subjektivit të rivlerësimit, z. I. K. Në dokumentet e aplikimit duket se qëllimi i përdorimit ka qenë i shënuar për rikonstruksion apartamenti, shtëpie banimi, ndërsa në kontratën e kredisë është shënuar për blerje apartamenti. Në këtë kontekst duket i besueshëm deklarimi i bërë nga subjekti se mund të ketë qenë vetë institucioni financiar/përfaqësuesit e tij që kanë plotësuar praktikën e kredisë sipas produkteve financiare që këto institucione kanë pasur. Gjithashtu, referuar formularit të mbajtur nga oficeri i kredisë me subjektivin e rivlerësimit konstatohet se ajo ka deklaruar se është në dijeni të plotë për kërkesën e bërë nga klienti I. K. për shumën 1,200,000 lekë, duke provuar faktin se kërkesa për marrjen e kredisë është bërë nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektivit.

2.14 Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se në nenin 2 të kontratës së huas, me titull “Mënyra e lëvrimit të huas”, është përcaktuar se palët bien dakord që huaja të jepet me çek në emër të

¹⁹Referohuni f. 6 të përgjigjes së dhënë nga institucioni financiar NOA me shkresës nr. *** prot., datë 21.2.2022.

huamarrësit, me transfertë bankare ose me çdo mënyrë tjetër për të cilën palët bien dakord midis tyre.

2.15 Nga verifikimi dhe analizimi në mënyrë të detajuar i të gjithë informacionit dhe dokumentacionit të administruar nga institucioni financiar NOA lidhur me disbursimin e fondeve të kredisë dhe mënyrën e përfitimit të tyre, Komisioni konstaton se në datën 6.8.2010, pasi është miratuar dhënia e kredisë në shumën prej 1,200,000 lekësh, si dhe pasi janë mbajtur komisionet përkatëse të kredisë në shumën 24,000 lekë, institucioni financiar NOA ka lëshuar çekun bankar në emër të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, në referim të të cilit ai autorizohet të tërheqë pranë “Raiffeisen Bank” shumën prej 1,176,000 lekësh.

2.16 Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se shuma 1,176,000 lekë, pjesë e fondeve të përfituara nga huaja e marrë në institucionin financiar, është tërhequr *cash* nga bashkëshorti i subjektit në “Raiffeisen Bank”, pasi nuk rezulton të jetë kryer transferim i kësaj shume nga personi i lidhur në favor të ndonjë pale të tretë.

2.17 Për sa u arsyetua më sipër, duket qartë që kërkesën për marrjen e kësaj kredie e ka bërë personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit I. K. dhe se për më tepër të gjitha fondet e përfituara nga kjo kredi janë tërhequr prej tij nëpërmjet çekut bankar.

2.18 Nga ana tjetër rezulton e provuar se automjeti objekt vlerësimi është blerë në shtetin gjerman nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe se ka qenë ky i fundit i cili në datën 6.10.2010 e ka futur këtë automjet në territorin shqiptar nëpërmjet pikës kufitare të Hanit të Hotit²⁰. Komisioni sjell në vëmendje këtu se edhe kjo pasuri është krijuar përpara se subjekti të emërohej në funksionin e prokurorit.

2.19 Gjithashtu, nga hetimi administrativ i kryer nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur të kenë porositur apo blerë ndonjë pasuri të paluajtshme përgjatë vitit 2010 apo të kenë kryer investime dhe/apo shpenzime të tjera të qenësishme/rëndësishme, përveçse blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

2.20 Rezulton se pasuria objekt vlerësimi është blerë vetëm rreth 25 ditë pas disbursimit të kredisë nga institucioni financiar “***”. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues krijoi bindjen se fondet e përfituara nga kredia kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi, përlllogaritur nga subjekti vlera totale e saj (çmimi i blerjes + pagesa e detyrimeve doganore) në shumën rreth 8,000 euro.

2.21 Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se janë deklaruar saktë të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi, si dhe subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të cilat mundësojnë plotësisht kryerjen e pagesës për likuidimin e çmimit të blerjes së këtij automjeti dhe për shlyerjen e detyrimeve doganore.

3. Pasuria apartament me sip. 127 m², ndodhur në Lagjen *, Durrës, përfituar me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 5.12.2014, me vlerë 9,784,982 lekë.** Subjekti deklaron se zotëron 1/3 pjesë takuese të saj.

3.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) vlerën 2,486,400 lekë të paguar nga znj. V. K. (nëna e bashkëshortit), të përfituar nga kredia e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare si e pastrehë, miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB), pasi kishin dorëzuar vullnetarisht banesën e jetuar prej 32 vitesh në Lagjen ***, Durrës, si ish-pronë e subjekteve të shpronësuara; (ii) shumën 5,298,582 lekë, të paguar nga znj. V. K. sipas kontratës së sipërmarrjes datë 25.2.2011, por pa specifikuar të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj shume; si dhe (iii) shumën 2,000,000 lekë, të paguar nga subjekti dhe bashkëshorti nga gjendja *cash*

²⁰Referohuni dokumentit hyrje - leje qarkullimi provizor të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Shkodër, me nr. *** prot., datë 6.10.2010, pjesë e dokumentacionit të dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2021, të DPSHTRR-së.

që disponohet në banesë, me burim të ardhurat familjare të mbledhura ndër vite dhe ato të përfituara nga puna e bashkëshortit në emigracion.

3.2 Në seksionin “deklarim të detyrimeve financiare”, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar se me kontratën e datës 19.12.2014, me nr. ***, është marrë kredi bankare në BKT, dega Durrës, në shumën 2,486,400 lekë, që është përcaktuar nga EKB-ja, interesi aktual zero, për znj. V. K., e cila gëzon statusin e të pastrehut. Kjo kredi, sipas kushteve të kontratës, është me kredimarrës V. K. dhe I. K. dhe dorëzanës M. K. dhe E. K., me kësht mujor 13,813 lekë. Data e fillimit 19.12.2014 deri më 28.12.2029. Gjithashtu, ka deklaruar detyrimin e mbetur pa shlyer në shumën 2,141,066 lekë.

3.3 Komisioni konstaton se në DIPP/2014 subjekti ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes datë 5.12.2014 (nr. ***), me palë sipërmarrëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë porositëse V. K., I. K. dhe Edina Kurti, për prenotimin e apartamentit me sip. 127 m², me vlerë 9,784,982 lekë. Subjekti ka deklaruar se zotëron 1/3 pjesë takuese të kësaj pasurie, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj – duke referuar se çdo e dhënë ndihmëse ndodhet në kontratën e sipërmarrjes. Ndërsa, në seksionin “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar kredinë bankare të marrë nga bashkëshorti dhe nëna e tij në BKT (kontratë kredie bankare me nr. ***, datë 19.12.2014), në shumën 2,486,400 lekë, përfituar nga EKB-ja për shkak të statusit të të pastrehut, i cili gëzohej nga shtetasja V. K., nëna e bashkëshortit të subjektit.

Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

3.4 Pasi Komisioni verifikoi dhe analizoi informacionin dhe dokumentacionin e administruar në dosjen hetimit administrativ²¹ lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, apartamentin e banimit të ndodhur në Durrës, me sip. 127 m², rezulton se:

i. Në datën 25.2.2011 shtetasja V. K. (nëna e bashkëshortit të subjektit) ka porositur²² nga shoqëria “****” sh.p.k. pasurinë e llojit “apartament” me sipërfaqe të përgjithshme 127 m², nga të cilat sipërfaqe ndërtimi 119.3 m² dhe sipërfaqe e përbashkët 7.7 m², shkalla nr. 1, kati i 6 banim të objektit që po ndërtohej/do të ndërtohej nga kjo shoqëri në Lagjen ***, Durrës, për çmimin 800 euro/m².

Pra, duket se çmimi total për blerjen e kësaj pasurie, i përcaktuar sipas kontratës së sipërmarrjes datë 25.2.2012, është në vlerën 101,600 euro (127 m² x 800 euro/m²). Por, nga ana tjetër, rezulton se në këtë kontratë nuk është përcaktuar plani i pagesave për likuidimin e çmimit të blerjes së këtij apartamenti.

ii. Në datën 5.12.2014 subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti i saj I. K. dhe nëna e tij V. K., në cilësinë e palës porositëse, kanë nënshkruar kontratën e sipërmarrjes²³ me shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt shitjen e po të njëjtit apartament, objekt i kontratës së sipërmarrës së datës 25.2.2011.

Në nenin 2 të kësaj kontrate, me titull “Çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës”, ndër të tjera, është përcaktuar çmimi total i shitjes së kësaj pasurie në shumën 9,784,982 lekë.

Ndërsa plani i pagesave është përcaktuar si vijon: (a) kësti i parë prej 5,298,583 lekësh është likuiduar menjëherë në momentin e nënshkrimit të kontratës paraprake të sipërmarrjes lidhur mes porositëses V. K. në ambientet e shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. (mandatet bashkëlidhur) e datës 25.2.2011, shumë e cila është likuiduar nga kjo shtetase; (b) kësti i dytë

²¹Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës *Vetting*, ndodhur aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; dokumentacioni i përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2020, të ILDKPKI-së; informacioni dhe dokumentacioni i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2020, të ASHK Drejtoria Vendore Durrës; informacioni dhe dokumentacioni i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 20.6.2022, të ASHK Drejtoria Vendore Durrës; dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorëve të dërguara nga Komisioni.

²²Kontratë sipërmarrjeje në ndërtim e datës 25.2.2011 (shkresë e thjeshtë).

²³Dokumenti kontratë “sipërmarrje prenotim apartament banimi” me nr. ***, datë 5.12.2014, redaktuar nga noteri publik A. H..

prej 2,000,000 lekësh është likuiduar në ambientet e shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. (mandatet bashkëlidhur) e datës 25.2.2011, shumë e cila është likuiduar nga znj. Edina Kurti dhe z. I. K.; (c) kësti i tretë prej 2,486,400 lekësh është likuiduar nga pala porositëse V. K. në ambientet e shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. (mandatet bashkëlidhur), shumë të cilën e ka marrë hua në bazë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 14.11.20014, nga znj. Sh. M., së cilës do t’i kthehet me kredinë që do të merret në BKT nga znj. V. K. si e pastrehë.

Bashkëlidhur kontratës së sipërmarrjes evidentohen tri mandatarkëtimi të shoqërisë “****” sh.p.k., me të dhënat, si vijon: (a) mandatarkëtimi nr. ***, datë 25.2.2011, në referim të të cilit znj. V. K. ka paguar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 5,298,583 lekë, me përshkrimin “apartamenti nr. *** (sip. 127 m²), shkalla ***, kt * (***) pranë ****”; (b) mandatarkëtimi nr. ***, datë 14.11.2014, në referim të të cilit znj. V. K. ka paguar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 2,486,400 lekë; (c) mandatarkëtimi nr. ***, datë 5.12.2014, në referim të të cilit subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj I. K. kanë paguar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. shumën prej 2,000,000 lekësh, me përshkrimin për “apartamenti nr. *** (sip. 127 m²), kati ****”.

iii. Po në datën 5.12.2014 rezulton se është nënshkruar edhe deklarata noteriale nr. *** midis shtetasve R. K. dhe V. K., sipas së cilës kjo e fundit i njihte shtetasit R. K. një shumë hua prej 38,600 euro.

Komisioni konstaton se veprimi noterial i nënshkruar ndërmjet shtetasve V. K. dhe shtetasit R. K. është regjistruar në regjistrin noterial me një numër regjistri përpara nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.

iv. Pas padisë së bërë nga nëna e bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., me objekt: (i) detyrimin e palës së paditur të përmbushë detyrimet kontraktore që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 5.12.2014; (ii) detyrimin e palës së paditur të paguajë të gjitha shpenzimet për përfundimin e apartamentit sipas të gjitha cilësive të cituara në kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 5.12.2014, për punimet e papërfunduara në shumën 1,031,905 lekë; (iii) detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të paditësve penalitetin e përcaktuar në nenin VI të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 5.12.2014, për mosdorëzimin e apartamentit në afatin e caktuar në shumën 6,197.64 euro deri në datë 12.4.2018, plus nga kjo ditë e në vazhdim deri në ekzekutimin e vendimit në shumën 8.47 euro/dita – në datën 15.10.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur²⁴: (a) pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së palës paditëse V. K., I. K. dhe Edina Kurti; (b) detyrimin e palës së paditur, shoqëria “****” sh.p.k., të përmbushë detyrimet kontraktore që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 5.12.2014; (c) detyrimin e palës së paditur, shoqëria “****” sh.p.k., të dorëzojë apartamentin e banimit me sipërfaqe totale 127 m², me nr. ***, të ndodhur në katin e *** të banimit në objektin e emërtuar “Godinë banimi dhe shërbimi 12 kate mbi tokë, 1 kat parkimi nën tokë”, në Lagjen ***, rruga “****”, Durrës; (ç) detyrimin e palës së paditur, shoqëria “****” sh.p.k., të paguajë në favor të palës paditëse shumën prej 1,031,905 lekësh për punimet e papërfunduara sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 5.12.2014; (d) rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të objektit të saj²⁵.

v. Në datën 4.12.2018 subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti dhe nëna e tij kanë lidhur aktmarrëveshje²⁶ me shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori R. K., në referim të së cilës, ndër të tjera, është përcaktuar se: (i) shoqëria “****” sh.p.k. njeh vendimin e gjykatës, është dakord me të, nuk bën kërkesë ankimore në Gjykatën e Apelit apo në një gjykatë më të lartë dhe nuk ka pretendime për objektin e kësaj padie; (ii) shtetasi R. K. bie dakord të shuajë plotësisht detyrimin që ka me shtetasen V. K. në shumën prej 38,600 euro dhe revokon deklaratën noteriale me nr. ***, datë 5.12.2014; (iii) palët në marrëveshje V. K., I. K. dhe Edina

²⁴Vendim nr. ***, datë 15.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

²⁵Rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka marrë formë të prerë në datën 11.12.2018.

²⁶Konfirmuar me dokumentin noterial “vërtetim nënshkrimi” me nr. ***, datë 4.12.2018, redaktuar nga noteri publik.

Kurti pranojnë apartamentin në gjendjen e cila është përshkruar në aktekspertimin dhe në vendimin nr. ***, datë 15.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe reciprokisht shuajnë çdo detyrim në të holla me shoqërinë “***” sh.p.k. që rrjedhin nga padia, vendimi i gjykatës, shpenzimet gjyqësore, gjendja e papërfunduar e apartamentit dhe deklarata noteriale mes shtetasve V. K. dhe R. K.; (iv) shtetasit V. K., I. K. dhe Edina Kurti bien dakord që të regjistrojnë vendimin e gjykatës ashtu siç është vendosur dhe nuk do ta ankimojnë në gjykatat më të larta. Ata heqin dorë përfundimisht nga pika e tretë e kërimit të padisë.

vi. Kjo pasuri është regjistruar në emër të nënës së bashkëshortit, subjektit dhe bashkëshortit të saj bazuar në vendimin e gjykatës (të referuar si më sipër), në datën 8.2.2019. Po në të njëjtën datë është lëshuar edhe certifikata për vërtetim pronësie.

Verifikimet e kryera nga Komisioni mbi pagesën e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit me sip. 127 m², të ndodhur në Durrës

3.5 E pyetur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ mbi ekzistencën e dy kontratave të ndryshme për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi dhe e përcaktimit të dy çmimeve të ndryshme për blerjen e saj, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se:

- *Kontrata e sipërmarrjes datë 25.2.2011, me palë sipërmarrëse shoqërinë “***” sh.p.k. dhe palë porositëse V. K., është lidhur në zyrën e shoqërisë “***” sh.p.k. dhe ka përcaktuar në lidhje me blerjen e apartamentit të banimit me sip. 127 m² se çmimi i shitjes është 800 euro/m².*

- *Vjehri dhe vjehrra e saj gëzonin statusin e të pastrehut për arsye se banonin në shtëpinë e një ish-pronari dhe për këtë arsye vjehrra e saj hyri në këtë marrëdhënie për blerjen e këtij apartamenti banimi.*

- *Në vitin 2013 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur pranimi i kërkesës së kërkuarit EKB, Drejtoria Rajonale Durrës, duke u lëshuar urdhri i ekzekutimit për ekzekutimin e detyruar të titullit ekzekutiv, datë 27.2.2013, detyrimin e shtetasit M. K. dhe familjes së tij të lirojë e t'i dorëzojë pronares A. Z. apartamentin e ndodhur në qendër të qytetit të Durrësit.*

- *Në datën 24.3.2013 është mbajtur procesverbali i veprimeve përmbartimore gjatë ekzekutimit, ku shtëpia i është dorëzuar kreditorëve (ish-pronarëve) nga bashkëshorti I. K., sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 16.11.2012, lëshuar nga prindërit e tij, pasi ata ndodheshin në Kanada tek vajza e tyre A. H.*

- *Në vijim, me shkresën e datës 19.8.2014, Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave i është drejtuar Bankës Kombëtare Tregtare mbi përcaktimin e masës së kredisë që përfitojnë qytetarët qiramarrës në banesat ish-pronë private që përfitojnë kredi të subvencionuar nga shteti nga EKB. Me këtë shkresë i ka dërguar edhe Bashkisë Durrës listën me 3 emra, ku është përfituese edhe shtetasja V. K., në shumën 2,486,400 lekë.*

- *Gjatë kësaj periudhe nga shoqëria “***” sh.p.k. nuk ishte përmbushur detyrimi ligjor për mbarimin e afatit të punimeve sipas lejes së ndërtimit datë 30.6.2012. Cilësia e punimeve të kryera ishte e ulët në krahasim me projektin e prezantuar... Shoqëria kishte filluar të shfaqte probleme financiare që prej vitit 2012... dhe i ishin pezulluar punimet nga pronarët e truallit...*

- *Mbasi vjehrrës i ishte aprovuar kredia dhe banka kërkonte persona garantues për të lëvruar atë, duke qenë se prindërit e bashkëshortit ishin pensionistë dhe banka nuk jepte kredi për këtë fashë, sepse nuk u garantohej pagesa e kredisë, ajo dhe bashkëshorti vendosën të dilnin garantorë në lidhje me marrjen e kredisë...*

- *Banka ndërkohë kërkonte që për lëvrimin e kredisë pala kredimarrëse të duhet të paraqiste një kontratë sipërmarrjeje për blerje apartamenti banimi, e cila ishte në fakt vetë qëllimi i marrjes së kredisë, në të kundërt nuk e lëvronte kredinë edhe pse vjehrra ishte e pastrehë...*

- *Gjatë kësaj periudhe ndërmjet vjehrrës dhe shtetasit R. K. kishin filluar mosmarrëveshjet për ndërtimin dhe përfundimin e objektit. Shoqëria në realizimin e punimeve ishte shumë larg*

projektit të prezantuar dhe problemet e shoqërisë ishin aq të mëdha sa dukej e pamundur që ky objekt të mbaronte...

- Për shkak të shqetësimit të vjehrrës, por edhe kunatës e cila shprehte vazhdimisht dëshirën për të parë prindërit me një banesë të tyre të re, duke i ndihmuar ndër vite edhe financiarisht, ajo dhe bashkëshorti vendosën të interesoheshin në lidhje me apartamentin dhe gjetjen e një zgjidhjeje. Kështu u interesuan për çmimet e ndërtimit në atë zonë dhe çmimi i dhënë nga shoqëria “***” 800 euro/m² ishte shumë i lartë në raport me cilësinë e punimeve që ishin kryer, problematikat që vetë shoqëria e ndërtimit kishte si pezullim punimesh nga pronarët e truallit, bllokim në banka nga kreditorët, ku ishte debitor dhe si subjekt dhe si individ... Diskutuan me shoqërinë që për shkak të kësaj problematike shtetasi R. K. ose t’i rikthente paratë V. ose të ulte çmimin për metër katror. Por, shoqëria pretendonte se shumë nuk mund ta kthente (në fakt nuk kishte mundësi financiare ta kthente, madje kërkonte prej vjehrrës pagesën e kësteve të tjera), duke këmbëngulur se nuk do shkaktonte më vonesa, se punimet do të kryheshin sipas parametrave të përcaktuara në kontratë me gjithë elementet teknike të ambienteve të banimit, duke marrë kështu përsipër zbatimin e të gjitha detyrimeve në këtë kontratë...

- Të ndodhur në këto kushte lidhën kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 5.12.2014..., nga ku çmimi i dakordësuar në kontratë ishte 9,784,793 lekë dhe nuk ishte 800 euro/m² ose 101,600 euro, pasi nuk përfaqësonte në fakt cilësinë e punimeve të kryera... edhe për shkak të pezullimit të punimeve dhe problematikave të tjera që kishte shoqëria në atë kohë...

- Por, për shkak se përfaqësuesi i shoqërisë, shtetasi R. K., vazhdonte të këmbëngulte tek çmimi i dakordësuar në vitin 2011 me vjehrrën e tij nga njëra anë dhe ata nga ana tjetër nuk mendonin se ky çmim përfaqësonte kundërvlerën e pasurisë që do blinin, ndërmjet shtetasit R. K. dhe vjehrrës së saj u dakordësua që V. K. do t’i njihje një shumë borxhi të barabartë me vlerën 38,600 euro sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 5.12.2014, veprim noterial ky i nënshkruar dhe regjistruar në regjistrin noterial, një numër regjistri para nënshkrimit dhe regjistrimit në po këtë regjistër të kontratës së sipërmarrjes... Verbalisht mes vjehrrës së saj dhe shtetasit R. K. u ra dakord që në rast se do përfundonin punimet sipas deklarimeve të tij dhe se cilësia e punimeve do ishte ajo sipas projektit të prezantuar në vitin 2011, atëherë shtetasi R. K. i lindte e drejta e ekzekutimit të shumës së deklaruar marrë hua.

3.6 Sa më sipër, në përfundim të shpjegimeve të dhëna, subjekti ka deklaruar se kanë qenë pikërisht këto fakte të cilat ndryshuan çmimin në kontratën e sipërmarrjes së datës 5.12.2014.

3.7 Gjithsesi, në kushtet e ekzistencës së dy kontratave me objekt të njëjtë, por me ndryshime sa i përket palëve dhe çmimit të dakordësuar mbi pasurinë objekt vlerësimi, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën provës për të dhënë shpjegimet e saj përfundimtare dhe për të depozituara prova të reja të mundshme shtesë në lidhje me deklarimin e bërë mbi çmimin e kësaj pasurie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

3.8 Sa i përket çmimit të deklaruar të kësaj pasurie, Komisioni vëren se edhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke argumentuar se shuma 38,600 euro u njoh si detyrim ndaj ndërtuesit nga nëna e bashkëshortit dhe palët ranë verbalisht dakord që do mund të zgjidhnin mosmarrëveshjen për çmimin e apartamentit në varësi edhe se si do të realizoheshin punimet dhe nëse mosmarrëveshja nuk do të zgjidhej me mirëkuptim do t’i drejtoheshin gjykatës, fakt i cili ka ndodhur. Pretendimet e ndërtuesit se pallati do të ndërtohej me cilësi dhe se apartamentet brenda do të përfundonin sa më shpejt të ishte e mundur, nuk u realizuan asnjëherë. Madje, gjatë procesit gjyqësor evidentohet qartësisht nga fotot pjesë e dosjes gjendja në të cilën ndodhej apartamenti objekt vlerësimi. Mjafton ky fakt për të vërtetuar tërësisht se çmimi që ai pretendonte me 800 euro/m² nuk përfaqësonte çmimin e drejtë të tregut. Sipas udhëzimit nr. ***, datë 23.11.2011, të EKB-së, çmimi mesatar i shitblerjeve në tregun e lirë

për qytetin e Durrës ka qenë 74,540 lekë/m², ndërsa sipas udhëzimit nr. ***, datë 6.8.2014, çmimi mesatar i shitjes për qytetin e Durrësit ka qenë 70,093 lekë/m². Kontrata e sipërmarrjes nr. *** e vitit 2014 parashikon një çmimi që është 77,047/m² lekë, duke marrë parasysh gjendjen në të cilën është marrë ky apartament. Nisur nga këto kushte subjekti shprehet se është e bindur që çmimi që ajo, bashkëshorti dhe vjehrra kanë paguar për këtë apartament është më i larti i mundshëm për qytetin e Durrësit.

3.9 Në këtë kontekst, subjekti ka parashtruar se shuma prej 38,600 euro, që nëna e bashkëshortit të saj e njohu si detyrim monetar, nuk është deklaruar dhe nuk ka pasur detyrim për deklarim në deklaratën *Vetting*, pasi nuk është burim krijimi dhe as pjesë e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, sipas kontratës së vitit 2014, referuar edhe cilësisë së punimeve dhe problematikave të shoqërisë²⁷.

3.10 Në vijim të parashtrimeve të bëra, subjekti ka arsyetuar se nëse vjehrra e saj nuk do të kishte nënshkruar kontratën e sipërmarrjes të vitit 2011 dhe nuk do të kishte paguar shumën prej 5,298,583 lekësh, nuk do të kishte logjikë/kuptim që ata në vitin 2014 të lidhnin kontratën noteriale të porosisë. Problematikat financiare dhe teknike të shoqërisë “****” në vitin 2014 ishin evidente edhe të mëdha, por pagesa e kryer në vitin 2011 dhe paaftësia e kësaj shoqërie për t’i kthyer nënës së bashkëshortit pagesën e kryer prej saj në vitin 2011 (në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve financiare) i detyruan të nënshkruanin një kontratë noteriale sipërmarrjeje, por duke dakordësuar një çmim në përputhje me cilësinë e punimeve dhe duke marrë për bazë problematikat që shfaqte shoqëria. Sikundër e vërtetoi edhe fakti, apartamenti është porositur nga nëna e bashkëshortit në vitin 2011 dhe është bërë i banuar në vitin 2020. Janë dashur plot 9 vjet që ata të fillonin të banonin në këtë apartament. Pra, paguan 6 vjet kredi, pastaj nisën të banonin në këtë apartament. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ju drejtuan Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me padi në shtator të vitit 2017, gjykim i cili zgjati mbi një vit.

3.11 Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se njohja e detyrimit nga vjehrra e saj ka lidhje me kontratën e sipërmarrjes të vitit 2011, por se ajo dhe bashkëshorti nuk janë palë as e kësaj kontrate dhe as e deklaratës së njohjes së detyrimit. Sipas subjektit, deklaratat noteriale, kontrata e sipërmarrjes datë 25.2.2011, urdhërekzekutimi, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe vendimi i gjykatës provojnë tej çdo dyshimi këtë fakt.

Vlerësimi përfundimtar i bërë nga Komisioni/analiza e shpjegimeve dhe provave

3.12 Komisioni vëren se me deklaratën noteriale të datës 5.12.2014, e cila i paraprin nënshkrimin të kontratës së sipërmarrjes të po kësaj date për porositjen e apartamentit objekt vlerësimit, nëna e bashkëshortit të subjektit, znj. V. K., ka deklaruar se ka marrë në formë huaje shumën 38,600 euro nga shtetasi R. K., për blerjen e apartamentit nga shoqëria “****” sh.p.k., në Lagjen ***, rruga “****”, Durrës.

3.13 Nga ana tjetër, rezulton se shtetasi R. K. (në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “****” sh.p.k.) po në të njëjtën datë ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes me subjektin e rivlerësimit, bashkëshortin dhe nënën e bashkëshortit, në referim të së cilës është deklaruar likuidimi i çmimit të plotë të referuar në kontratë, por në dukje jo me burim huan e deklaruar si të dhënë në emër të shtetasës V. K.

3.14 Komisioni vëren se kontrata e sipërmarrjes e datës 5.12.2014 referon planin e pagesave të kryera në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. Kështu, në këtë kontratë referohet se: (i) kësti i parë në shumën 5,298,583 lekë është likuiduar nga shtetasja V. K., me nënshkrimin e kontratës paraprake të sipërmarrjes datë 25.2.2011, duke depozituar bashkëlidhur dokumentin mandatarkëtimi nr. ***, datë 25.2.2011; (ii) kësti i dytë në shumën 2,000,000 lekë është likuiduar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, duke depozituar bashkëlidhur dokumentin mandatarkëtimi nr. ***, datë 5.12.2014; dhe (iii) kësti i tretë në shumën 2,480,600 lekë është

²⁷Subjekti bën referim edhe tek vendimi nr. 14/2021, i Kolegjit.

likuiduar nga pala porositië V. K., duke depozituar bashkëlidhur dokumentin mandatarkëtimi nr. ***, datë 14.11.2014.

3.15 Përpos faktit se në referim të mandatpagesave duket se kësti i tretë dhe i fundit është likuiduar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ, nga hetimi i kryer Komisioni evidentoi se mandatarkëtimet e depozituara si dokument provues për kryerjen e pagesave për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi kanë renditje të parregullt, sipas parashikimit të bërë në kontratën e sipërmarrjes së datës 5.12.2014.

3.16 Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se në momentin që kanë nënshkruar kontratën e sipërmarrjes së datës 5.12.2014 nga ana e noterit është kërkuar jo vetëm kontrata e sipërmarrjes e datës 25.2.2011, por edhe mandatet e paguara për këtë pasuri. Në këtë moment, shtetasi R. K. ka dorëzuar si kontratën e sipërmarrjes, ashtu edhe mandatet e paguara në shkurt 2011, nëntor 2014 dhe dhjetor 2014. Sa i përket mandatarkëtimeve dhe dyshimit të ngritur nga Komisioni mbi kryerjen e pagesës në vitin 2011, subjekti ka parashtruar se mandatarkëtimet shkëputen nga blloqe të blera në çdo librari apo kancelari dhe janë dokumente të thjeshta dore, nuk janë të miratuara nga ndonjë autoritet shtetëror dhe nuk kanë as barkod, duke argumentuar se në rastin konkret të dhënat që janë shënuar në një akt zyrtar me fuqi të plotë provuese, si kontrata noteriale e sipërmarrjes, mbështeten nga të dhënat e pasqyruara në mandatarkëtimet, por edhe nga të dhëna të tjera.

3.17 Në shqyrtim dhe analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri, në konsideratë të faktit se mandatpagesat nuk përbëjnë dokumente zyrtare të parashypura nga shtypshkronja e letrave me vlerë dhe, si të tilla, nuk janë dokumente të njohura nga organet tatimore apo nga institucione të tjera publike, si dhe duke u mbështetur në parashikimin e bërë në nenin 690 të Kodit Civil, i cili përcakton: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”*, i lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton: *“Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”*, trupi gjykues çmon se kontrata noteriale e sipërmarrjes, e datës 5.12.2014, përbën akt me fuqi të plotë provuese sa i përket momentit të kryerjes së pagesave për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, duke prevaluar dhe mbi çdo dokument tjetër.

3.18 Për sa u analizua më sipër, Komisionin vëren se në dukje shuma 38,600 euro, e njohur si detyrim ndaj shtetasit R. K. (identifikuar si përfaqësues ligjor dhe ortak i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k.) përbën diferencën e çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2011 me atë të vitit 2014.

3.19 Parë në këtë optikë, si dhe në konsideratë të faktit të provuar mbi vonesat në kryerjen e ndërtimit²⁸ dhe cilësinë e dobët të punimeve të kryera nga ndërtuesi së paku deri në fund të vitit 2014, por edhe më vonë²⁹, duket i besueshëm deklarimi i bërë nga subjekti se kjo shumë është deklaruar si njohje detyrimi nga nëna e bashkëshortit të saj dhe se kjo situatë do të vlerësohej në varësi nëse ndërtuesi do të realizonte punimet sipas cilësisë dhe kohës së premtuar.

3.20 Komisioni vëren se në deklaratën noteriale nëna e bashkëshortit të subjektit ka referuar se do t’ia kthejë këtë shumë shtetasit R. K. brenda datës 31.12.2016. Por, nga hetimi i kryer nuk

²⁸Ndër të tjera, subjekti ka depozituar edhe dokumentin “aktдорëzim për ashensorë” të shoqërisë “****”, nga ku duket se ashensori në pallatin e ndërtuar nga subjekti “****” sh.p.k., ku ndodhet pasuria objekt vlerësimi, është vendosur në gusht të vitit 2017.

²⁹Referohuni materialeve të fashikullit të dosjes gjyqësore me paditës subjektin e rivlerësimit, bashkëshortin dhe nënën e tij dhe palë të paditur shoqërinë “****” sh.p.k.

u konstatua ndonjë deklaratë për kthimin e huas dhe as ndonjë përpjekje e bërë nga huadhënësi për kërkimin e kësaj shume. Përkundrazi, rezulton se pas procesit gjyqësor të kryer, në marrëveshjen e nënshkruar me subjektin, bashkëshortin dhe nënën e bashkëshortit, ndërtuesi ka pranuar faktin se shuma 38,600 euro përbënte njohje detyrimi ndaj tij, në rast se do të kryheshin punimet në kohë dhe sipas cilësisë së prezantuar më parë.

3.21 Pra, në kushtet kur rezultoi e provuar se në datën 31.12.2016 shoqëria ndërtuese nuk kishte përfunduar plotësisht ndërtimin e këtij objekti dhe se nuk kishte kryer punimet me cilësinë e prezantuar, trupi gjykues krijoi bindjen se shuma 38,600 euro, e deklaruar si njohje detyrimi ndaj shoqërisë “***” sh.p.k., nuk është paguar nga nëna e subjektit dhe, për rrjedhojë, nuk është pjesë përbërëse e çmimit të blerjes së kësaj pasurie. Ky përfundim përforcohet edhe nga fakti se palët kanë hyrë në një konflikt gjyqësor për shkak të mosmarrëveshjeve që kanë pasur lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, duke arritur një marrëveshje mes tyre pas gjykimit në shkallë të parë.

3.22 Si konkluzion, trupi gjykues çmon se subjekti ka deklaruar saktësisht çmimin e blerjes së kësaj pasurie, bazuar në pagesat e kryera në favor të shoqërisë ndërtuese, sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 5.12.2014, të analizuar në harmoni me shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, përfshirë edhe vendimin nr. ***, datë 15.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili i jep vlerë të plotë faktike dhe ligjore kontratës së sipërmarrjes datë 5.12.2014, si dhe çmimit të shitblerjes së apartamentit prej 9,784,982 lekësh.

3.23 Gjithashtu, Komisioni arrin në përfundimin se kontrata e sipërmarrjes datë 5.12.2014 përbën vazhdim dhe zhvillim të mëtejshëm të marrëdhënies juridike civile të lidhur mes nënës së bashkëshortit dhe shoqërisë “***” sh.p.k., sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 25.2.2011, për sa kohë ka për objekt shitblerje të njëjtën pasuri dhe se në planin e pagesave e referon këtë kontratë si kontratën paraprake të sipërmarrjes.

Lidhur me deklarimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

3.24 Siç u evidentua më sipër, subjekti ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* se si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer: (i) shuma 2,486,400 lekë, paguar nga znj. V. K. (nëna e bashkëshortit), përfituar nga kredia e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare; (ii) shuma 5,298,582 lekë e paguar nga znj. V. K., por pa specifikuar të ardhurat që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj shume; si dhe (iii) shuma 2,000,000 lekë e paguar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj nga gjendja *cash* që disponohej në banesë, me burim të ardhurat familjare të mbledhura ndër vite dhe ato të përfituara nga puna e bashkëshortit në emigracion.

3.25 E pyetur më parë nga ILDKPKI-ja³⁰ në lidhje me burimin e të ardhurave të nënës së bashkëshortit V. K., subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se *një pjesë e shumës prej 5,298,582 lekësh e ka nga të ardhurat e punës që vjehri dhe vjehrra kanë bërë në Greqi në vitet 1993 - 2003. Gjithashtu, sqaron se vjehri i saj M. K. prej vitit 2001 ka punuar në detyrën e drejtorit të Agjencisë Detare Shtetërore Taulantia sh.a., si dhe M. dhe V. K. kanë bërë bashkim familjar në Kanada me vajzën e tyre që jeton prej shumë vitesh në atë shtet, ku janë pajisur edhe me karta qëndrimi dhe marrin një suplement pagesë mujore...*

3.26 Ndërsa e pyetur gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se *në lidhje me burimin e krijimit të shumës 5,298,583 lekë, pjesa më e madhe është nga kontributi i vajzës së tyre A. H. që jeton dhe punon në Kanada nga viti 2002 dhe aktualisht.*

3.27 Gjithashtu, Komisioni konstaton se si burim për pagesën e shumës prej 2,486,400 lekësh në favor të shoqërisë ndërtuese nga znj. V. K. ka shërbyer huaja e marrë nga nëna e subjektit

³⁰Referohuni procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 11.2.2016, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2020, të ILDKPKI-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.1.2020).

dhe jo kredia e marrë në BKT, pavarësisht se është deklaruar se shuma e kredisë ka shlyer detyrimin e marrë.

3.28 Sa më sipër, duket se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të kësaj pasurie, e konkretisht të ardhurat të cilat ka shërbyer në momentin e kryerjes së pagesave për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit mbi këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

3.29 Nëpërmjet prapësimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore të datës 28.10.2022, subjekti ka argumentuar se *sipas konceptit të saj nuk ka pasur detyrim të deklaronte në mënyrë specifike burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë për apartamentin në bashkëpronësi, pasi në kuptim të ligjit nr. 84/2016 bashkëpronarët nuk kategorizohen në cilësinë e personave të lidhur dhe as në cilësinë e personave të tjerë të lidhur (sipas nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016).*

Në vijim subjekti ka parashtruar se *pavarësisht deklarimit si 1/3 pjesë takuese, meqenëse bashkëpronësia është në tërësi, është e qartë se ajo dhe bashkëshorti nuk kanë kontribuar në pagesën e shumës 5,298,583 lekë. Sipas subjektivit, në jurisprudencën e Komisionit dhe të Kolegjit është konsoliduar qëndrimi se pasaktësia në deklarimin e pjesës takuese nuk përbën shkak për marrjen e ndonjë mase disiplinore ndaj subjekteve, si dhe nuk përbën shkak për rëndimin e analizës financiare³¹.*

3.30 Në këtë kontekst subjekti ka pretenduar se në deklaratën *Vetting* subjektet e rivlerësimit për pasurinë në bashkëpronësi kanë detyrim të deklarojnë burimin e krijimit të pjesës së tyre takuese dhe jo të bashkëpronarëve, dhe aq më pak detyrimet apo huat e këtyre të fundit, duke deklaruar se është i vërtetë fakti që huaja e marrë nga nëna e bashkëshortit V. K. prej nënës së saj Sh. M. nuk është deklaruar si burim, por në deklaratën *Vetting* është bashkëlidhur kontrata e sipërmarrjes e vitit 2014, në të cilën përcaktohej ekzaktësisht se znj. V. K., për pagesën e një kësti për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, ka marrë hua nga znj. Sh. M. shumën 2,486,400 lekë. Në këto kushte, sipas subjektivit, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë që u është fshehur organeve verifikuese të pasurisë.

Vlerësimi përfundimtar i bërë nga Komisioni/analiza e shpjegimeve dhe provave

3.31 Fillimisht Komisioni u ndal në vlerësimin e statusit ligjor të nënës së bashkëshortit të subjektivit të rivlerësimit. Kështu, rezulton se nëna e bashkëshortit të subjektivit nuk bën pjesë në rrethin e personave të lidhur, të cilët mbartin detyrimin për deklarimin e pasurive për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

3.32 Por, në kushtet kur nëna e bashkëshortit të subjektivit V. K. ka pasur lidhje të vazhdueshme interesi me subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur, sa i përket pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit me sip. 127 m², të ndodhur në Durrës, Komisioni vlerëson se në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 ajo kategorizohet në cilësinë e “personit tjetër të lidhur”, kjo edhe në funksion të deklarimit dhe verifikimit të çdo shtate të mundshme të konfliktit të interesit.

3.33 Nga ana tjetër, referuar ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit³², interesi pasuror që i vendos personat e tjerë të lidhur në kushtet e detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë është përcaktuar në pikën 4 të nenit 32 të tij, pra duhet të jetë një marrëdhënie dhurimi, huamarrje ose huadhënie me subjektin e rivlerësimit.

³¹Ka referuar vendimin nr. 19/2022(JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

³²Shihni paragrafin 74, në faqet 29 dhe 30 të vendimit nr. 21/2020(JR), datë 10.9.2020, të Kolegjit.

3.34 Bazuar në pikën 7 të udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI, me nr. ***, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj. nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”, për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojë burimin në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri në momentin e fitimit të tyre.

3.35 Në referim të kuadrit ligjor të evidentuar si më sipër, Komisioni vlerëson se krahas subjektit të rivlerësimit janë personat e lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, të cilët mbartin detyrimin për deklarimin e pasurive, si dhe të burimit në momentin e krijimit të tyre. Ndërsa, personat e tjerë të lidhur nuk mbartin detyrimin për deklarim, por nga ana tjetër kur ata ndodhen në një marrëdhënie dhurimi, huamarrje ose huadhënie me subjektin e rivlerësimit kanë detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Pra, nëse subjekti i rivlerësimit deklaron marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit (marrëdhënie e cila duhet të konfirmohet nga personat e tjerë të lidhur) detyrohet të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit, të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë subjektit të rivlerësimit.

3.36 Komisioni vëren se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka deklaruar specifikisht burimin e krijimit të shumës së paguar nga ana e saj dhe personi i lidhur për likuidimit e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, si dhe kredinë e marrë në BKT, me bashkëkredimarrës personin e lidhur dhe nënën e tij, kjo në dukje nisur edhe nga fakti se kjo kredi po shlyhet tërësisht nga subjekti dhe bashkëshorti i saj³³ me të ardhurat e tyre.

3.37 Në vijim të arsyetimit, trupi gjykues çmon se pavarësisht se subjekti ka deklaruar se zotëron 1/3 e kësaj pasurie, duket se në këtë rast kemi të bëjmë me bashkëpronësi në tërësi mbi apartamentin objekt vlerësimi, konfirmuar si e regjistruar kjo pasuri në regjistrat hipotekorë në emër të subjektit, bashkëshortit dhe nënës së tij, bazuar në kontratën e sipërmarrjes të vitit 2014, vendimit datë 15.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe aktmarrëveshjen e nënshkruar mes palëve në datën 4.12.2018³⁴. Kjo situatë vlerësohet nga Komisioni edhe në kushtet e marrëdhënies së posaçme të subjektit dhe personit të lidhur me bashkëpronarin tjetër, rrethanën e evidentuar më sipër mbi ndërhyrjen e bërë nga këta të fundit në vitin 2014, me nënshkrimin e kontratës noteriale të sipërmarrjes, e në vijim ngritjen e padisë në gjykatë për përmbushjen e detyrimeve nga ana e ndërtuesit sipas parashikimeve të bëra në kontratë, e cila duket se ka qenë thelbësore për marrjen në dorëzim dhe shuarjen përfundimtare të detyrimit të cilin kishte marrë përsipër nëna e bashkëshortit, si dhe në konsideratë të faktit se kredia e marrë në BKT, me bashkëkredimarrës personin e lidhur dhe nënën e tij, po shlyhet tërësisht me të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit të saj.

3.38 Kështu, rezultoi e provuar se nëna e subjektit të rivlerësimit në bazë të kontratës paraprahe të sipërmarrjes, datë 25.2.2011, ka paguar në favor të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. shumën prej rreth 5,300,000 lekësh.

3.39 Për sa i takon investimit të kryer nga bashkëpronarja tjetër, nëna e bashkëshortit të subjektit, Komisioni vlerëson se nuk mund të bëhet trajtimi i saj në cilësinë e personit tjetër të lidhur e cila ka detyrimin për justifikimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë, e në këtë rast të pagesave të kryera për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, për sa kohë

³³Sipas deklarimeve të bëra nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

³⁴Referohuni dokumentacionit të dërguar me shkresat e ASHK Drejtoria Vendore Durrës.

marrëdhënia e interesit pasuror nuk përfshihet në gamën e marrëdhënies të përcaktuara shprehimisht në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016³⁵.

3.40 Por, gjithsesi, në këtë kuadër, në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit³⁶, për kryerjen e një analize të plotë dhe gjithëpërfshirëse, Komisioni vendosi të thellojë hetimet dhe të evidentojë, krahas mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për investimet e vetëdeklaruara prej saj mbi këtë pasuri, edhe mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur (nënës së bashkëshortit të subjektit) sa i përket kryerjes në tërësi të pagesave që lidhen me pasurinë objekt vlerësimi.

3.41 Nga ana tjetër, duke qenë se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, ka qenë bashkëkredimarrës me nënën e tij për kredinë e marrë në vitin 2014 në BKT, shumë e cila është deklaruar se ka shërbyer për shlyerjen e një prej kësteve të pasurisë objekt vlerësimi, Komisioni vlerëson se subjekti duhet të kishte treguar kujdesin e duhur që në deklaratën *Vetting* të kishte referuar faktin se pagesa e kryer në datën 14.11.2014 (sipas mandatarkëtimit të depozituar) në shumën 2,486,400 lekë ka pasur si burim huan e marrë prej nënës së bashkëshortit tek nëna e subjektit, kjo në vlerësim edhe të faktit se kjo hua është shlyer me fondet e kredisë së marrë në BKT.

3.42 Gjithsesi, për sa kohë rezulton se subjekti ka depozituar si dokumentacion provues bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting* dokumentin kontratë sipërmarrjeje të datës 5.12.2014, në të cilën evidentohet fakti se pagesa e datës 14.11.2014 është kryer nga znj. V. K., me burim fondet e marra hua nga nëna e subjektit, si dhe se kjo shumë do t'i shlyhet me fondet e marra nga kredia në BKT (fakt i cili evidentohet se ka ndodhur)³⁷, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur si qëllim fshehjen e rrethanave mbi mënyrën dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie.

3.43 Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se ky deklaram i subjektit nuk është i plotë, në përputhje me kërkesat e formularit të deklaramit, megjithatë në konsideratë të faktit që ky deklaram është shoqëruar me kontratën e sipërmarrjes datë 5.12.2014, në cilësinë e dokumentit justifikues në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se mosdeklarami i këtyre të dhënave nuk ka pasur për qëllim mosrespektimin e ligjit për deklaram të saktë dhe të plotë³⁸.

Verifikimi dhe analiza e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit me sip. 127 m², ndodhur në Durrës

i. Pagesa e kryer nga nëna e bashkëshortit të subjektit, znj. V. K., në datën 25.2.2011, në shumën 5,292,582 lekë

Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti, duket se si burim të ardhurash të cilat kanë shërbyer për kryerjen e kësaj pagese janë referuar: (i) të ardhurat e përfituara nga prindërit e bashkëshortit nga puna në emigracion në shtetin grek; (ii) të ardhurat e përfituara ndër vite nga puna e babait të bashkëshortit, z. M. K.; dhe (iii) kontributi i vajzës së tyre A. H., e cila jeton dhe punon në Kanada që prej vitit 2002 dhe aktualisht.

Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se vlera kryesore monetare e cila ka mundësuar pagesën e kështit të parë të pasurisë objekt vlerësimi i është dhënë prindërve të bashkëshortit të saj nga vajza e tyre A. H., me burim të ardhurat e saj nga puna në shtetin kanadez. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më parë në ILDKPKI se prindërit e bashkëshortit kanë bërë bashkim familjar me vajzën e tyre në Kanada.

³⁵Shihni vendimin nr. 14/2021(JR), të Kolegjit.

³⁶Shihni paragrafët 109 dhe 110, në faqet 34 dhe 35 të vendimit nr. 15/2019(JR), datë 17.7.2019, të Kolegjit.

³⁷Me anë të transfertës bankare të datës 9.1.2015.

³⁸Qëndrim i mbajtur edhe nga Kolegji. Shihni vendimin nr. 14/2021(JR).

Pasi u pyet nga Komisioni, subjekti ka konfirmuar se³⁹ në vitin 2012 prindërit e bashkëshortit kanë bërë bashkim familjar me vajzën e tyre A. H., sipas kartave të qëndrimit të lëshuara nga shteti kanadez, por se prej vitit 2013 prindërit e bashkëshortit nuk kanë udhëtuar më për në shtetin kanadez dhe se nuk i kanë rinovuar kartat e qëndrimit. Bashkëlidhur përgjigjeve subjekti ka depozituar dy deklarata noteriale të motrës së bashkëshortit, znj. A. H.⁴⁰ mbi faktin e qëndrimit të prindërve të saj në shtetin kanadez për periudha të ndryshme gjatë viteve 2006 – 2012, përfitimt prej tyre nga bashkimi familjar në vitin 2012, si dhe ajo ka mbështetur dhe vazhdon të mbështesë financiarisht prindërit e saj, duke specifikuar se mbështetja më e madhe financiare që u ka dhënë ka qenë shuma prej 40,000 dollarë kanadezë, në mënyrë që ata të blinin një apartament banimi në Durrës, pasi ishin të pastrehë. Në vijim, ka deklaruar se kjo shumë u është sjellë deri në vitin 2010 prej saj dhe bashkëshortit, sa herë që ata vinin në Shqipëri, si dhe nga prindërit sa herë që ktheheshin në shtetin shqiptar.

Gjithashtu, në mbështetje të deklaramëve të saj, subjekti ka depozituar kopje të pasaportave kanadeze të motrës së bashkëshortit dhe bashkëshortit të saj, si dhe dokumentacion mbi të ardhurat e përfituara prej tyre nga puna në shtetin kanadez përgjatë viteve 2002 – 2011.

Në verifikimet e kryera, në kushtet kur të ardhurat e motrës së bashkëshortit të subjektit janë referuar si burim kryesor për kryerjen e pagesës së këstit të parë për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, Komisioni konstatoi se referuar të dhënave të sistemit *TIMS* nuk rezulton që shtetasja A. H. të ketë hyrje-dalje në territorin shqiptar për vitet 2003 – 2008. Ndërsa, për sa i përket viteve 2009 – 2011, rezulton se kjo shtetase ka vetëm një hyrje-dalje në territorin shqiptar për vitin 2009 (hyrje në datën 26.6.2009, dalje në datën 10.8.2009) dhe një hyrje-dalje për vitin 2010 (hyrje në datën 20.6.2010, dalje në datën 19.7.2010).

Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë transferimin e shumës 40,000 dollarë kanadez, të pretenduar si të dhënë nga motra e bashkëshortit në favor të prindërve të saj, për sa kohë në referim të hyrje-daljeve të evidentuara kjo shumë është mbi vlerën e detyrueshme për deklarim gjatë hyrjes në shtetin shqiptar (pra nuk mund të kalohej me dy hyrje në shtetin shqiptar) dhe nuk evidentohen deklarime të vlerave monetare *cash* në dy hyrjet e evidentuara prej saj në shtetin shqiptar. Pra, duket se subjekti nuk provon pretendimin e saj mbi burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për likuidimin e këstit të parë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

Në vijim të sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti, pas përgjigjeve në pyetësor, duket se ka shtuar burimin e deklaruar në vitin 2016 mbi të ardhurat e prindërve të bashkëshortit për krijimin e shumës 5,298,583 lekë (duke shtuar të ardhura nga kontributi i znj. A. H. në shumën 40,000 CAD), për të cilat trupi gjykues vlerëson se mbështetur në vendimmarrjen e Kolegjit⁴¹ ky deklarim i kryer gjatë procesit të rivlerësimit nuk mund të merret në konsideratë.

Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit:

- nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues kohën e pagesës së këstit të parë të apartamentit nga prindërit e bashkëshortit në shumën 5,298,582.8 lekë;
- nuk ka provuar burimin e ligjshëm të shumës 5,298,582.8 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

³⁹Shihni përgjigjen e pyetjes nr. 3 të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

⁴⁰Dy deklarata noteriale të datës 8.11.2021, të nënshkuara para noterit publik në shtetin kanadez (zyra e noterisë ****, Kanada), vërtetuar me origjinalin me dokumentin noterial nr. *** rep., datë 12.11.2021, redaktuar nga noteri publik D. B., të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes i autorizuar, konfirmuar me dokumentin noterial “vërtetim përkthimi” nr. *** rep., datë 12.11.2021, redaktuar nga noteri publik D. B..

⁴¹Vendimet nr. 34/2019, datë 2.12.2019, nr. 2/2020, datë 27.2.2020, ku Kolegji arsyeton se: “[...] referuar jurisprudencës së tij, deklarata noteriale të tilla merren me rezervë në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe për shkak të tij, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklaramëve të subjektit të rivlerësimit. Marrja me rezervë e deklaramëve noteriale forcohet sidomos kur nuk mbështeten dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit [...]”.

Me dërgimin e prapësimeve, në përgjigje të barrës së provës të kaluar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, në lidhje me verifikimin e sistemit *TIMS* për shtetasen A. H., subjekti ka sqaruar se *vetëm pas njohjes me rezultatin e hetimit ka konstatuar problematikën e regjistrimit të kumatës së saj, shtetasen A. H., në sistemin TIMS. Vetë ajo e ka informuar tashmë, pas konstatimit të bërë nga Komisioni, se të dhënat e saj në sistemin TIMS para vitit 2009 janë hedhur gabim, e konkretisht emri është shkruar gabim në sistem para vitit 2009 jo A. por A.. Këtë gjë kumatës ia kishte bërë prezent në vitin 2006 kontrollori në pikën e kalimit kufitar në Rinas, por nuk kishte paraqitur ndonjë problematikë gabimi në një të dhënë të emrit, pasi të dhënat e tjera ishin të gjitha në rregull.*

Ndodhur në këto kushte, subjekti referon se i është drejtuar Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin në Tiranë, ku kjo e fundit, me shkresën datë 3.10.2022, i ka vënë në dispozicion lëvizjet (hyrje-daljet) e shtetasve A. H., A. H., I. H. (bashkëshorti), M. dhe V. K..

Sipas informacionit të administruar⁴², subjekti ka parashtruar se nga të dhënat e sistemit *TIMS* vetëm pas vitit 2004 rezulton se shtetasit A. H., I. H., M. K. dhe V. K. për vitet 2004 – 2010 kanë hyrë/dalë 14 herë nga territori i Republikës së Shqipërisë për në Kanada dhe anasjelltas. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se shtetasit I. dhe A. H. kanë hyrë edhe para vitit 2004 në Shqipëri, por të dhënat e sistemit *TIMS* gjenerojnë pas vitit 2004.

Gjithashtu, me dërgimin e prapësimeve, subjekti ka paraqitur analizën financiare të motrës së bashkëshortit për krijimin e shumës 40,000 dollarë kanadezë deri në vitin 2010, si dhe analizën financiare të prindërve të bashkëshortit për mundësinë e kryerjes së pagesës së këstit të parë për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, edhe kjo analizë e kryer mbi mundësinë e kursimit të tyre deri në fund të vitit 2010. Në referim të analizave financiare të paraqitura me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti pretendon se prindërit e bashkëshortit kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të paguar shumën e këstit të parë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi në datën 25.2.2011.

Si konkluzion, subjekti parashtron se ka provuar tej çdo dyshimi burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 5,298,583 lekë të paguar nga nëna e bashkëshortit në vitin 2011, si dhe provueshmërisë së kryerjes së 14 hyrjeve në territorin shqiptar nga shteti kanadez prej familjarëve të bashkëshortit⁴³, pavarësisht faktit se sipas ligjit nr. 84/2016 nuk ka detyrimin të provojë këtë burim për bashkëpronarët, të cilët nuk janë persona të lidhur.

Vlerësimi përfundimtar i bërë nga Komisioni/analiza e shpjegimeve dhe provave

Pas analizimit të shpjegimeve të bëra nga subjekti gjatë hetimit administrativ, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe ato të dhëna gjatë seancës dëgjimore publike, si dhe pas verifikimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni vëren se: (i) subjekti ka provuar se motra e bashkëshortit prej vitesh jeton dhe punon në shtetin kanadez dhe se ajo dhe bashkëshorti i saj kanë përfituar të ardhura të konsiderueshme nga puna e tyre, të cilat mundësojnë plotësisht krijimin e shumës 40,000 dollarë kanadez, të referuar si kontribut i dhënë nga znj. A. H. për blerjen e një apartamenti banimi nga prindërit e saj; si dhe (ii) subjekti ka provuar se familjarët e bashkëshortit të saj, përfshirë këtu edhe bashkëshortin e motrës, për vitet 2004 – 2010 kanë kryer 14 herë hyrje-dalje nga shteti kanadez për në Shqipëri dhe anasjelltas, lëvizje të cilat mundësojnë plotësisht kalimin *cash* në kufi, pjesë - pjesë të shumës 40,000 dollarë kanadez, të referuar si të dërguar ndër vite.

Gjithashtu, Komisioni konstatoi se me dërgimin e prapësimeve subjekti ka depozituar dokumentacion në lidhje me jetesën/qëndrimin e prindërve të bashkëshortit të saj në shtetin grek, vlerësuar kjo rrethanë si përpjekje për të mbështetur deklaratimet e dhëna më parë prej saj në ILDKPKI.

⁴²Shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2022, e Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Tiranë, depozituar si provë e re nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit.

⁴³Shihni prapësimet e subjektit të rivlerësimit nga pika 62 deri në pikën 77.

Sa më sipër, bazuar në analizën dhe vlerësimin e kryer si më sipër mbi deklarin e burimeve të të ardhurave të pasurisë objekt vlerësimi, në shqyrtim të dokumentacionit justifikues ligjor mbi të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit dhe motrës së tij, në referim të faktit se motra e subjekti ka pranuar dhënien e shumës prej 40,000 dollarë kanadez dhe qëllimin e dhënies së kësaj shume, si dhe provueshmërisë së kryerjes së 14 hyrjeve në territorin shqiptar nga shteti kanadez prej familjarëve të bashkëshortit, Komisioni krijoi bindjen se prindërit e bashkëshortit (nëna e subjektit) kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në datën 25.2.2011 në shumën rreth 5,300,000 lekë, për pagesën e kështit të parë për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi.

Sigurisht që në këtë rast vlerësimi përfundimtar i kësaj situatë është kryer për një nivel më të ulët provueshmërie, për shkak se prindërit e bashkëshortit të subjektit nuk përfshihen në rrethin e personave të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, por as në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 32 të këtij ligji të vendoseshin në kushtet e detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, për sa kohë nuk ndodheshin në një marrëdhënie dhurimi, huamarrje ose huadhënie me subjektin e rivlerësimit.

ii. Paguesa e kryer në datën 11.11.2014 nga nëna e bashkëshortit të subjektit, znj. V. K., në shumën 2,486,400 lekë, me burim huan e marrë nga nëna e subjektit, znj. Sh. M., deklaruar si e likuiduar kjo hua me fondet e marra nga kredia në BKT

Siç u evidentua më sipër, konstatohet se në kontratën e sipërmarrjes datë 5.12.2014 është përcaktuar se shuma 2,486,400 lekë, referuar si e paguar nga znj. V. K. në favor të shoqërisë ndërtuese, i është marrë hua znj. Sh. M. nga znj. V. K., me deklaratën noteriale të datës 14.11.2014, pasqyruar ky fakt edhe në aneksin, pjesë të kontratës së kredisë datë 19.12.2014, të lidhur me BKT-në⁴⁴, me bashkëkredimarrës bashkëshortin dhe nënën e bashkëshortit të subjektit.

Në deklaratën noteriale, pjesë e dosjes së kredisë, znj. V. K. ka konfirmuar marrjen e një huaje nga znj. Sh. M. në shumën 2,486,400 lekë, e cila referohet se do të shlyhet brenda datës 13.1.2015 nga një kredi bankare marrë nga deklaruesja si e pastrehë.

E pyetur më parë nga ILDKPKI-ja⁴⁵ në lidhje me këtë deklaratë noteriale dhe marrjen e kësaj shume hua nga nëna e bashkëshortit te nëna e saj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “...meqenëse kontrata e sipërmarrjes së V. K. ishte lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k., me administrator R. K., BKT i informoi se R. K. ishte debitor në bankë si individ edhe si shoqëri dhe si rrjedhojë kredia nuk kalonte si pagesë për blerjen e apartamentit, por bllokohej automatikisht nga banka për shkak të debive të individit dhe subjektit ***. Në këtë situatë banka u sugjeroi nëse ishte e mundur që V. K. të siguronte hua sipas shumës së kredisë. Meqenëse nëna e saj Sh. M. dhe babai kishin llogari rrjedhëse prej vitesh në BKT, i dha shumën hua prej 2,486,400 lekësh V. K. me deklaratën noteriale datë 14.11.2014 dhe po në këtë datë është bërë pagesa prej 2,486,400 lekësh te shoqëria “***” sh.p.k. Pas miratimit të kredisë shuma prej 2,486,400 lekësh i është kthyer Sh. M. po nga BKT-ja nëpërmjet llogarisë bankare që ajo kishte prej vitesh në bankë...”.

Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë në monedhën euro të nënës së subjektit në BKT, znj. Sh. M., ndër të tjerat, rezulton se: (i) në datën 12.8.2014 në llogarinë e saj është kredituar shuma 8,036 euro, transferuar nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit I. K., me përshkrimin “kalim për Sh. ose E. M.”; (ii) po në datën 12.8.2014 është depozituar *cash* në këtë llogari nga znj. Sh. M. shuma 12,000 euro. Në datën 13.11.2014 nëna e subjektit ka krijuar depozitën në shumën 20,035 euro dhe se në vijim të verifikimit të kësaj llogarie rezulton se në datën 14.11.2014 znj. Sh. M. ka tërhequr shumën 18,000 euro nga vlera e kësaj depozite, e cila duket

⁴⁴Kontratë kredie bankare nr. ***, datë 19.12.2014, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2020, të BKT-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.2.2020).

⁴⁵Referohuni procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarin të pasurive”, datë 11.2.2016, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2020, të ILDKPKI-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.1.2020).

se po në këtë datë i është dhënë hua nënës së bashkëshortit V. K., e deklaruar nga subjekti si burim për pagesën e kështit të dytë për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi.

Sa më sipër, duket se për plotësimin e shumës prej 18,000 euro, e tërhequr *cash* në datën 14.11.2014 nga znj. Sh. M. (e cila është deklaruar dhënë hua), ka shërbyer edhe shuma 8,000 euro, e transferuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

E pyetur nga Komisioni mbi qëllimin e transferimit të shumës nga bashkëshorti i saj në llogarinë e nënës së saj, si dhe mbi burimin e krijimit të kësaj shume, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se⁴⁶ *në dhjetor të vitit babai i saj u diagnostikua me një sëmundje të rëndë dhe duhej ndërhyrje urgjente. Në këto kushte, me ndihmën e kushërirës së mamasë, shtetases F. B., e cila jetonte/jeton në Bari, Itali, u mundësua ndjekja dhe kurimi i tij në Bari. Për këtë u kërkua edhe një shumë prej 5,000 euro për t'u bllokuar në bankë si garanci për mjekim. Veprimi duhet të kryhej sa më shpejt dhe ndërkohë që vëllai i saj merrej me dokumentacionin mjekësor dhe procedurat e vajtjes në Itali, bashkëshorti I. K. ka hapur një llogari rrjedhëse në BKT në datën 17.12.2012 në shumën 5,000 euro, si garanci për operacionin e babait të saj. Kjo shumë disponohej në shtëpi prej tyre. Në datën 8.1.2013 është tërhequr shuma prej 4,800 euro nga bashkëshorti i saj në BKT, pasi babai i saj shkoi në Itali dhe iu nënshtrua ndërhyrjes kirurgjikale... Në datën 1.11.2013 bashkëshorti I. K. ka derdhur në BKT shumën 7,826 euro dhe në datën 4.11.2013 është bërë depozitë shuma prej 8,000 euro. Kjo shumë disponohej prej tyre në gjendje në shtëpi, deklaruar që në vitin 2012 si pjesë e shumës 25,000 euro, me burim të ardhurash nga puna e saj ndër vite dhe kryesisht nga emigracioni i bashkëshortit në shtetin grek.*

Në vijim të deklarimeve të dhëna, subjekti ka deklaruar se *gjendja e shëndetësore e babait të saj ka qenë e stabilizuar deri në korrik të vitit 2014, kur edhe u diagnostikua sërish me sëmundje... Në këtë koha babai kërkoi të bënte sërish një ndërhyrje apo trajtim tjetër, këtë herë në Turqi, dhe se për këtë ndërhyrje duhej një garanci prej 20,000 euro. Më këto procedura dokumentare është marrë vëllai i saj E. M., nëpërmjet të njohurve të tij jashtë Shqipërisë, duke i kërkuar nënës depozitim të shumës 12,000 euro, pasi më parë ajo e kishte informuar se bashkëshorti I. K. kishte një depozitë në valutën euro në shumën 8,000 euro, dhe dakordësuar ta transferonin këtë shumë në llogarinë e nënës, duke plotësuar shumën prej 20,000 euro.*

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se shuma 8,000 euro i është kthyer *cash* pas disa ditësh nga vëllai i saj E. M.. Ndërsa, për burimin e të ardhurave të prindërve të saj, për depozitim të shumës 12,000 euro, ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat nga puna e babait të saj ndër vite, si edhe të ardhurat si kontribut i vëllezërve të saj, duke specifikuar se vëllai i saj i madh I. M. është shtetas amerikan dhe se jeton e punon në New York prej 20 vitesh.

Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti ka depozituar: (a) kopje të dokumenteve të babait të saj për periudhën janar 2013, të spitalit “****”, Bari dhe vërtetim nga QSUT-ja; (b) deklaratë noteriale të vëllait të saj E. M. (nr. ***, datë 7.10.2022, si dhe bashkëlidhur saj dokumentacion mbi provueshmërinë e përfitimit të të ardhurave të tij nga ushtrimi i aktivitetit privat, si ekstrakt historik të regjistrit tregtar, shkresë nr. *** prot., datë 29.12.2021, e DRT-së Durrës, në lidhje me pagesën e tatimit mbi dividendit, vërtetim për bazën e vlerësuar për periudhën 2010 e në vijim; (c) deklaratë noteriale të vëllait të saj I. M., bashkëlidhur saj vërtetimi i Nëpunësit të Kontesë, i përkthyer, si dhe dy ekstrakte mbi të ardhurat për vitet 2011 dhe 2012.

Nga analizimi paraprak i shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe dokumentacionit të administruar në dosje, duket se: (a) deklarimi i bërë nga subjekti mbi arsyet e transferimit të shumës 8,000 euro (datë 12.8.2014) nga personi i lidhur në llogarinë e nënës së saj nuk mbështetet në rrethanat e evidentuara nga hetimi administrativ i kryer, pasi nuk rezulton që babai i subjektit të ketë udhëtuar për në shtetin turk në periudhën pas kryerjes së kësaj

⁴⁶Referohuni përgjigjeve të pyetjes nr. 5 të pyetësorit nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

transferte⁴⁷; (b) nuk qëndrojnë pretendimet e bëra nga subjekti mbi nevojën emergjente të familjarëve të saj në korrik të vitit 2014 dhe, si rrjedhim, mbi transferimin e shumës 8,000 euro nga bashkëshorti i saj në llogarinë e nënës së saj, për sa kohë ka rezultuar se prindërit e saj e dispononin këtë vlerë në llogaritë e tyre bankare në atë periudhë.

Sa më sipër, në analizën financiare paraprake Komisioni ka reflektuar si shpenzim të kryer nga personi i lidhur të shumës 8,036 euro, kaluar me transfertë në llogarinë bankare të nënës së subjektit, e cila duket se në vijim është përdorur për pagesën e kështit të dytë për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi.

Gjithashtu, duket se nuk provohet kthimi i shumës 8,000 euro prej vëllait të saj, si dhe burimi i të ardhurave të familjarëve të saj të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 12,000 euro, të depozituar *cash* nga nëna e subjektit në datën 12.8.2014.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të japë shpjegimet/argumentet e saj përfundimtare dhe të depozitojë prova të reja të mundshme mbi konstatimet e mësipërme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna më parë në ILDKPKI dhe gjatë hetimit administrativ mbi arsyet dhe rrethanat që e çuan nënën e bashkëshortit të merrte hua nga nëna e saj, duke sqaruar se ky veprim është bërë për një kohë të shkurtër, pasi kjo shumë i është kthyer nënës së saj menjëherë me disbursimin e fondeve të përfituara nga personi i lidhur dhe nëna e tij nga kredia bankare në BKT.

Në vijim të prapësimeve, subjekti ka dhënë shpjegimet e saj mbi arsyet e transferimit në datën 12.8.2014 të shumës 8,000 euro nga llogaria e bashkëshortit në llogarinë e nënës së saj, mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shumë, mbi kthimin e kësaj shume nga vëllai i saj dhe burimin e të ardhurave të tij, si dhe mbi të ardhurat e prindërve të saj, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 12,000 euro, të depozituar nga nëna e saj në datën 12.8.2014 në llogarinë e saj në BKT, duke depozituar edhe prova të reja në mbështetje të parashtrimeve të saj.

Së pari, në lidhje me depozitimin e shumës 8,000 euro për arsye shëndetësore të babait të saj, subjekti ka paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. *** të gjithë dokumentacionin e nevojshëm shëndetësor për të provuar sëmundjen e tij, e cila filloi që në vitin 2012 me shfaqjen e saj, dhe më tej në vitet 2013 - 2014 (dhe aktualisht). Ajo sqaron se nuk ka deklaruar asnjëherë që babai E. M. ka udhëtuar drejt Turqisë për arsye shëndetësore, duke sqaruar së në vitin 2014 është kuruar në QSUT. Gjithashtu, ka parashtruar se bashkëshorti i saj edhe në deklarinimin DIPP-së së vitit 2012 ka deklaruar në lidhje me depozitimin e shumës 5,000 euro në BKT “Hapur llogari rrjedhëse në BKT në datën 17.12.2012, shuma 5,000 euro si garanci për një operacion të vjehrrit”.

Së dyti, me qëllim provueshmërinë e krijimit të shumës 12,000 euro, depozituar nga nëna e subjektit në datën 12.8.2014, ka evidentuar dhe analizuar në mënyrë të detajuar të ardhurat e prindërve të saj për periudhën para depozitimit të kësaj shume. Më konkretisht, subjekti ka analizuar të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 1.1.2011 – 31.7.2014⁴⁸, për evidentimin e mundësisë së krijimit të kësaj shume.

Lidhur me të ardhurat e përfituara nga puna e babait të saj për shërbimet e kryera ndaj shoqërisë “***” sh.p.k. (***), duke iu referuar kontratave të shërbimit për vitet 2008, 2009 dhe 2010, ka pretenduar se në këtë rast ka qenë detyrimi i shoqërisë, në rolin e agjentit tatimor, të deklaronte

⁴⁷Nga verifikimi i të dhënave të sistemit *TIMS* për shtetasin E. M. evidentohet udhëtimi i kryej prej tij në datat 20.8.2014 – 28.8.2014, udhëtim me linjën Sarandë-Korfuz.

⁴⁸Sipas shpjegimeve të bëra nga subjekti, analiza financiare është shtrirë vetëm në këtë periudhë, duke mbajtur parasysh që për periudhën përpara vitit 2011 prindërit e saj kanë depozituar shuma të tjera monetare në bankë, të cilat kanë burim krijimi kursimet nga të ardhurat e tyre familjare.

dhe paguante detyrimet tatimore⁴⁹. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar dhe paraqitur kontratat e shërbimit të lidhura midis tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k. Nëse i referohemi kontratave për vitet 2008, 2009 dhe 2010, në secilën prej tyre përcaktohet se kontraktori për kryerjen e shërbimeve ndaj kompanisë në bazë të kësaj kontrate do të paguhet nga kompania me gjithsej 888,880 lekë (viti 2008), 722,222 lekë (viti 2009) dhe 805,556 lekë (viti 2010), nga të cilat 88,880 lekë (viti 2008), 72,222 lekë (viti 2009) dhe 80,556 lekë (viti 2010) janë taksat kundrejt shtetit shqiptar të cilat paguhet nga kompania dhe diferenca i jepet në dorë kontraktorit. Gjithashtu, subjekti referon se janë vënë në dispozicion edhe “kartelat e llogarisë” së shoqërisë “****” sh.p.k., ku evidentohet se pagesat janë dhënë çdo muaj sipas dokumentacionit kontabël të cilës i referohen kartelat. Për vitet 2012 dhe 2013 transfertat janë kryer me bankë dhe shuma e të ardhurave nga shërbimi ka kaluar në llogarinë e babait të subjektit pranë “Tirana Bank”. Në këtë llogari kanë kaluar edhe shumat që shoqëria ka rimbursuar babain për blerjen e materialeve të cilat kanë qenë të nevojshme për punën e kryer prej tij.

Si përfundim, subjekti arsyeton se, për sa kohë që ekziston kontrata e shërbimit e lidhur midis palëve, si dhe vërtetohet pagesa e të ardhurave nëpërmjet llogarisë bankare, këto të ardhura plotësojnë kushtin për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme dhe duhen përfshirë në analizën financiare.

Së treti, ka parashtuar faktin se vëllai i saj E. M. është ortak me pjesë takuese 25% të kapitalit themeltar në shoqërinë “****” sh.p.k., duke evidentuar se në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 29.12.202, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, në të cilën konfirmohet fakti se për vitin 2013 janë shpërndarë dividendë në shumën 16,020,000 lekë dhe është paguar tatimi mbi dividendin në shumën 1,780,000 lekë. Me dërgimin e prapësimeve ka depozituar dokumentet kartelë ortaku dhe *statement* bankar të vëllait, ku evidentohet fakti se në datën 11.8.2014 ka tërhequr shumën 1,000,000 lekë dhe se sipas subjektit, shuma e tërhequr prej tij në këtë datë i referohet faktit se vëllai kishte ardhur në dijeni të shumës 20,000 euro, që duhej lenë si garanci në bankë me qëllim vazhdimin e procedurave për kryerjen e ndërhyrjes kirurgjikale.

Në vijim subjekti ka shpjeguar se në kushtet kur në datën 12.8.2014 vëllai i saj nuk ka pasur mundësi të takohej me nënën dhe t’i dorëzonte shumën 1,000,000 lekë që do të konvertohej rreth 7,200 euro dhe do të plotësonte diferencën me gjendjen *cash* që dispononte, i ka kërkuar me urgjencë që ta ndihmonte duke transferuar shumën 8,000 euro. Ka qenë ko incidencë që shuma që bashkëshorti dispononte në llogarinë bankare në BKT korrespondonte me gjendjen e të hollave që kishte nevojë nëna e subjektit për plotësimin e shumës 20,000 euro.

Si përfundim, subjekti kërkon që të mos përfshihet si shpenzim në analizën financiare shuma 8,036 euro, e transferuar nga bashkëshorti i saj në datën 12.8.2014 në llogarinë e nënës së subjektit, pasi pretendon se kjo shumë i është kthyer menjëherë nga vëllai i saj dhe se nuk është pjesë e fondeve të dhëna hua nga nëna e saj në favor të nënës së bashkëshortit. Gjithashtu, subjekti pretendon se pavarësisht se prindërit e saj edhe në këtë rast nuk mund të kategorizohen në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, të cilët mbartin detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, gjithsesi ajo ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e tyre të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës 12,000 euro, të depozituara nga nëna e saj në datën 12.8.2014 në BKT.

Vlerësimi përfundimtar i bërë nga Komisioni/analiza e shpjegimeve dhe provave

Nga verifikimi dhe analizimi i kontratës së kredisë bankare të datës 19.12.2014, lidhur bashkëshortit të subjektit, nënës së tij, në cilësinë e kredimarrësve, dhe BKT-së, në cilësinë e kredidhënësit (si dorëzanës paraqiten subjekti i rivlerësimit dhe babai i bashkëshortit), konstatohet se në nenin 3, me titull “Çelja e kredisë”, e më konkretisht në pikën 3.4 të këtij

⁴⁹Shihni paragrafin nr. 70 të vendimit nr. 14/2021 dhe nr. 14/2021 të Kolegjit.

neni, është përcaktuar se disbursimi i kredisë do të bëhet siç përshkruhet në Aneksin e Çeljes dhe Përdorimit të Kredisë dhe në një nga mënyrat: me anë të tërheqjes në të holla; me anë të tërheqjes me mjete elektronike; me anë të një çeku të lëshuar nga ai vetë mbi bankën; me anë të urdhërpagesës të dhënë me shkrim në favor të të tretëve.

Rezulton se në dokumentin “Aneks i elementeve specifike të kredisë” është përcaktuar se shuma e kredisë prej 2,486,400 lekësh do të përdoret për likuidimin e pjesës së mbetur të çmimit të apartamentit (duke iu referuar pasurisë objekt vlerësimit) dhe kjo shumë do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të znj. Sh. M. me transfertë bankare në BKT.

Në analizë të të dhënave të referuara si më sipër, duken të besueshme deklaratimet e dhëna nga subjekti mbi orientimin e bërë nga banka për marrjen e shumës hua para disbursimit të kredisë për shkak se nuk mund të kaloreshin fondet në llogarinë e shoqërisë. Kjo situatë vlerësohet në analizë dhe shqyrtim të praktikës së zakonshme që mbahet nga bankat për dhënien e shumës së kredisë në këto raste, ku në kontratën e kredisë, krahas evidentimit të objektit të kredisë, përcaktohet se shuma e disbursuar do të transferohet në favor të shitësit. Por, në këtë rast duket se në kushtet kur banka dispononte kontratën e sipërmarrjes të datës 5.12.2014 (e cila referohet edhe në dokumentin “Aneks i elementeve specifike të kredisë”), ku specifikohet se një kështë likuidimi të çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, që i përgjigjet shumës së kredisë së miratuar, është paguar me shumën e marrë hua nga shtetasja Sh. M. dhe se do të paguhej me fondet e kredisë bankare që znj. V. K. do të merrte në këtë bankë, ka përcaktuar në aneks-kontratë se vlera e disbursuar e kredisë do të transferohet nga llogaria e kredisë në favor të znj. Sh. M. me transfertë bankare në BKT.

Në vijim të analizimit të provave të administruara në dosje, Komisioni vëren se në datën 19.8.2014 Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar të Banesave i është drejtuar Bankës Kombëtare Tregtare mbi përcaktimin e masës së kredisë që përfitojnë qytetarët qiramarrës në banesat ish-pronë private që përfitojnë kredi të subvencionuar nga EKB-ja, duke listuar edhe emrin e nënës së bashkëshortit në listën e përfituesve. Nga ana tjetër, rezulton se shumat 8,000 euro dhe 12,000 euro janë transferuar/depozituar në llogarinë e nënës së subjektit Sh. M. në datën 12.8.2014. Pra, duket se përjashtohet mundësia se transferimi/depozitimi i këtyre shumave të jetë bërë nga personi i lidhur apo nëna e tij, për shkak të kushteve të kredisë apo për qëllime të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

Nga ana tjetër, rezulton e provuar se vëllai i subjektit, në datën 11.8.2014, vetëm një ditë para transferimit/depozitimit të këtyre shumave, ka tërhequr *cash* shumën prej 1,000,000 lekësh, pjesë e fitimeve të tij (pas pagimit të tatimit mbi dividendin) si aksioner i shoqërisë “****” sh.p.k. Si rrjedhim duket i besueshëm deklarami i bërë nga subjekti mbi emergjencën e krijuar në datën 12.8.2014 për depozitimin e një shume bankare në llogari në euro, si garanci për ndërhyrje mjekësore të babait në Turqi dhe mbi faktin e kthimit nga i vëllai të kësaj shume brenda një kohe të shkurtër.

Komisioni konstaton se në deklaratën para fillimit të detyrës (deklaratë e dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.9.2012) subjekti ka deklaruar se disponon gjendjen e likuiditeteve *cash* në vlerën 25,000 euro, me burim të ardhurat nga puna e bashkëshortit në emigracion (vitet 1993 – 2003), puna e tij në Shqipëri dhe puna e saj. Ndërsa në DIPP/2012 personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, në deklaramin e bërë veçmas në seksionin “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, ka deklaruar: *“Hapur llogari rrjedhëse pranë BKT-së në datën 17.12.2012 shuma 5,000 euro, si garanci për një operacion të vjehrrit E. M., kryer në Itali në janar 2013, kur edhe është tërhequr nga banka kjo shumë. Kjo shumë disponohej në shtëpi nga kursimet ndër vite, sikurse është deklaruar edhe në deklaratën e mëparshme para fillimit të detyrës”*. Ndërsa, në DIPP/2013 nuk ka deklaruar pakësime apo shtesa të gjendjes së likuiditeteve *cash*. Pra, rezulton se referuar deklaramëve të bëra, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë disponuar gjendje likuiditetesh *cash* të mjaftueshme për të kryer depozitimin e në vijim transferimin e shumës 8,000 euro në datën 12.8.2014 në llogarinë e nënës së subjektit.

Gjithsesi, në kushtet kur duket i besueshëm deklarimi i bërë nga subjekti se kjo shumë i është kthyer për një kohë të shkurtër nga vëllai i saj, Komisioni nuk u ndal në këtë moment në verifikimin e ligjshmërisë së saj, duke vlerësuar se si burim tjetër për krijimin i shumës prej 20,000 euro, mbetur gjendje në llogarinë e nënës së subjektit deri në momentin e dhënies së huas në datën 14.11.2014, kanë shërbyer të ardhurat e vëllait të saj, kjo edhe në konsideratë të deklarimeve të bëra nga subjekti se kjo shumë, pasi i është kthyer nga i vëllai, i është bashkuar likuiditeteve *cash*, të cilat ajo dhe personi i lidhur dispononin në banesë dhe që kanë shërbyer si burim për pagesën e këstit të fundit të pasurisë objekt vlerësimi, e kryer prej tyre po gjatë vitit 2014⁵⁰, e konkretisht në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes për pasurinë objekt vlerësimi, datë 5.12.2014.

Gjithashtu, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të shumës 12,000 euro, të depozituar nga nëna e saj në datën 12.8.2014, duke depozituar dokumentacion justifikues për krijimin e të ardhurave të prindërve të saj. Kështu, trupi gjykues vlerëson se analiza financiare e kryer nga subjekti për mundësinë e kursimit të prindërve të saj për periudhën 1.1.2011 – 31.7.2014 është e mbështetur në dokumente dhe e kryer kryesisht sipas metodologjisë së ndjekur nga Komisioni për raste të ngjashme.

Duke u ndalur në analizën e të ardhurave, trupi gjykues e gjen bindës pretendimin e bërë nga subjekti mbi përfitimin e të ardhurave nga puna e babait të saj në shoqërinë “****” sh.p.k., kjo në kushtet kur është evidentuar dokumentacion i mjaftueshëm mbi marrëdhënien dhe punën e kryer prej tij në këtë shoqëri, duke filluar që nga licencat e z. M., të cilat e lidhin me shoqërinë, transaksionet bankare me shoqërinë, si dhe kontratat e punës/shërbimit të lidhura mes kësaj shoqërie dhe babait të subjektit. Në këtë këndvështrim, Komisioni arriti në përfundimin se rezultoni e provuar se babai i subjektit ka përfituar të ardhura nga puna e tij në shoqërinë “****” sh.p.k.

Në këtë kuptim, Komisioni vlerëson se bazuar në nenin 246 të Kodit të Procedurës Civile, kontratat e shërbimit/punës së lidhur mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shkresat e depozituara nga kjo shoqëri mbi të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit si rezultat i marrëdhënies së punësimit, marrin fuqi provuese për efekt të këtij procesi, për sa kohë që gjejnë mbështetje dhe harmonizohen me të dhënat dhe informacionet e grumbulluara nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ të kryer.

Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti ka deklaruar me vërtetësi mbi shumën e transferuara/depozituara në llogarinë e nënës së saj në datën 12.8.2014 dhe mbi burimin e krijimit të shumës 18,000 euro apo vlerës së konvertuar të saj në lekë⁵¹, të marrë hua nga nëna e bashkëshortit.

Në vijim të verifikimit të informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga BKT-ja konfirmohet se në datën 30.12.2014, në llogarinë e nënës së bashkëshortit të subjektit V. K. janë disbursuar fondet e përfituara nga kredia e EKB-së, në shumën 2,486,400 lekë. Rezultoni se në datën 9.1.2015 nga llogaria e znj. V. K. është transferuar në llogarinë e nënës së subjektit Sh. M. shuma e plotë e disbursuar nga kredia bankare prej 2,486,400 lekësh, me përshkrimin “kredi në favor të Sh. Y. M. kthim borxhi sipas deklaratës nr. ***, datë 14.11.2014”.

Si konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur me to kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të cilat mundësojnë plotësisht pagesën e kryer për likuidimin e këstit të dytë të pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit me sip. 127 m², të ndodhur në Durrës.

Lidhur me kredinë me kushte lehtësuese të marrë në BKT

⁵⁰Në vijim, në këtë vendim është analizuar ligjshmëria e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash*, të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, si dhe ecuria e deklarimit të shtesave/pakësimeve dhe mënyra e përdorimit të këtyre likuiditeteve.

⁵¹Konvertuar me kursin e kohës, në vlerën prej rreth 2,50,000 lekësh.

Referuar dokumentacionit të praktikës së Entit Kombëtar të Banesave dhe dosjes së kredisë të marrë në BKT, rezulton se në vitin 2013 është lëshuar urdhër ekzekutimi për ekzekutimin e detyruar të titullit ekzekutiv (nr. ***, datë 27.2.2013), të EKB Durrës për detyrimin e shtetasit M. K. dhe familjes së tij të lirojë e dorëzojë banesën e ndodhur në qendër të qytetit të Durrësit. Sipas përmbajtjes së urdhërekzekutimit, familja e shtetasit M. K. ka statusin e të pastrehut në shtëpi pronari dhe duhet të trajtohet sipas udhëzimit nr. ***, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”.

Me deklaratën noteriale nr. ***, në datën 19.12.2014, shtetasit M., V., I. dhe Edina Kurti kanë deklaruar se në cilësinë e përfituesve të kredisë me kushte të lehtësuara, sipas nenit 25 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar dhe bazuar në pikat 3 dhe 16 të VKM-së Nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve publike”, deklarojnë se në mbështetje të udhëzimit nr. ***, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, kanë përfituar nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave të drejtën që të trajtohen me kredi të lehtësuar nga shteti, nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare dhe referuar pikës 7/7 deklarojnë se janë të gatshëm dhe pranojnë se 30 ditë pas përfitimit të kredisë nga Banka Kombëtare Tregtare të lirojnë dhe dorëzojnë shtëpinë pronarit të ligjshëm, në të cilën kanë jetuar.

Nga verifikimi i informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga EKB-ja⁵² konfirmohet se familja e shtetasit M. K. ka aplikuar për t’u trajtuar me kredi me kushte lehtësuese nga shteti (me 0% interes) si familje me statusin e “të pastrehut në ish-pronë private”, në zbatim të udhëzimit nr. ***, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar).

Referuar këtij udhëzimi, të drejtën e përfitimit e kishin të gjithë pjesëtarët që rezultonin në gjendjen familjare të datës 1.12.1992 dhe që nuk dispononin banesë të regjistruar ose në proces regjistrimi (pika 7/1 e udhëzimit nr. ***). Ky parashikim konfirmohet edhe më tej nëpërmjet pikës 7/2/2 të udhëzimit, sipas së cilës për familjarët qiramarrës në ish-pronë private, në të cilat njëri nga pjesëtarët e familjes të certifikatës së vitit 1992 është shkëputur nga trangu familjar dhe ka përfituar pronë, struktura që do të përfitojë kjo familje të llogaritet vetëm për pjesëtarët e tjerë që mbeten në certifikatën e vitit 1992.

Rezulton se Enti Kombëtar i Banesave ka dërguar në BKT emrat e qytetarëve të pastrehë, me qëllim trajtimin e tyre sipas programit social të trajtimit me kredi të lehtësuar nga shteti, në zbatim të udhëzimit nr. ***, datë 2.9.2008, të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti” (i ndryshuar), nga ku evidentohet se është përcjellë edhe emri i nënës së bashkëshortit të subjektit, znj. V. K..

Në momentin që i është përcjellë shkresa e BKT-së, ku evidentohet shtetasja V. K., si një nga personat është përfituese e kredisë me kushte lehtësuese nga EKB-ja, konstatohet se familja e saj përbëhet nga 6 anëtarë⁵³, ku përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti i saj, si edhe dy fëmijët e tyre.

Referuar vërtetimeve të ZRPP-së Durrës, të depozituara gjatë aplikimit, rezulton se shtetasi Myftar Kurti kishte të regjistruar në regjistrin hipotekor në bashkëpronësi pasurinë truall me sip. 1850 m², Lagjja ***, Durrës. Gjithashtu, rezulton se znj. V. K. kishte lidhur një kontratë sipërmarrjeje për një apartament për të cilin kishte paguar edhe shumën rreth 5,000,000 lekë, sipas deklarimeve të subjektit dhe fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kishin të regjistruar në emrin e tyre pasurinë apartament, me sip. 66 m², të ndodhur në Lagjen ***, Durrës.

⁵²Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.2.2022, nga EKB-ja.

⁵³Sipas certifikatës familjare të depozituar gjatë aplikimit në EKB.

Sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 2 të VKM-së Nr. 814, datë 3.12.2004, “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit” të zbatueshme në kohën e aplikimit dhe trajtimit me kredi, rezulton se: “1. Normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit, përfshijnë: (a) sipërfaqen minimale të banimit që i takon një personi; (b) numrin e personave për çdo dhomë të banuar; 2. Sipërfaqja minimale e banimit, që i takon një personi të vetëm, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi është 12.5 m². Çdo personi tjetër shtesë mbi të parin, me moshë mbi 10 vjeç, i takon 7.5 m² sipërfaqe banimi, ndërsa çdo personi tjetër shtesë me moshë nga 5 vjeç deri në 10 vjeç i takon 3.75 m² sipërfaqe banimi. Fëmijët nën moshën 5 vjeç nuk llogariten për efekt të përfitimit të sipërfaqes së banimit”.

Formulari për llogaritjen e përfitimit i datës 13.11.2014, pjesë e dosjes së EKB-së, specifikon se përlllogaritja e normave të strehimit që i takon familjes sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 3.12.2004, “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit” është ‘G’/garsoniere”, me 1 fëmijë mbi moshën 10 vjeç.

Në rastin konkret, në analizë të parashikimeve të cituara më sipër, si dhe akteve të ndodhura në dosjen e përcjellë nga EKB-ja dhe sipas vërtetimeve të ZVRPP-së Durrës, të administruara gjatë aplikimit, rezulton se anëtarët e familjes⁵⁴ sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.12.1992, disponojnë një pasuri truall me sip.1850 m², në bashkëpronësi një apartament të regjistruar me sip. 66 m² dhe se kanë porositur edhe një apartament tjetër.

Sa më sipër, duket se nuk përmbushen kërkesat ligjore të VKM-së Nr. 814, datë 3.12.2004, “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit” për të përfituar statusin e familjes së pastrehë, pasi sipërfaqja e apartamentit prej 66 m² që disponojnë është mbi normat e nevojshme të strehimit që i takon familjes.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës duke i kërkuar të japë shpjegimet/argumentet e saj përfundimtare dhe të depozitojë mbi konstatimin e mësipërm mbi ligjshmërinë e përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese, si dhe të deklarojë mbi konfliktin e mundshëm të interesit me institucionin e Bashkisë Durrës, duke i kërkuar të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor në mbështetje të deklarimeve të saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Në lidhje me kredinë me kushte lehtësuese të marrë në BKT, subjekti ka sqaruar se ajo është marrë nga shtetasja V. K., sipas të gjitha dispozitave ligjore, ligjit për miratimin e aktit normativ të kohës dhe të gjitha programeve të strehimit për personat e pastrehë. E gjithë praktika që është dërguar nga EKB-ja Tiranë pasqyron ligjërisht të gjithë mënyrën e përfitimit të kredisë si e pastrehë për znj. V. K.. Familja K., referuar përbërjes familjare të vitit 1992, përbëhej nga shtetasit M., V. dhe I. K.. Certifikata e përbërjes familjare për vitet 2013 apo 2014 nuk ka të bëjë me personat apo normën e strehimit. Familja K. është trajtuar sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.12.1992.

Në vijim ka argumentuar se referuar statusit të të pastrehut në ish-pronë private edhe z. M. K. e gëzonte këtë status edhe pse kishte një tokë të trashëguar nga babai. Në konceptin juridik toka nuk është strehë. Referuar të dhënave që i janë vënë në dispozicion nga Komisioni, nga ZVRPP-ja Durrës është vërtetuar se z. M. K. ka të regjistruar në regjistrin hipotekor në bashkëpronësi pasurinë me nr. ***, truall me sip. 1850 m², në Lagjen ***, ***, Durrës. Kjo tokë është në bashkëpronësi me 10 persona/trashëgimtarë, ku z. M. K., sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës, datë 19.11.2014, ka të regjistruar në emër të tij sipërfaqen 390 m², truall, në Lagjen ***, Durrës. EKB Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2022, ka informuar Komisionin se: “Familja e qytetarit M. K. ka aplikuar për t’u trajtuar me kredi me kushte lehtësuese nga shteti (kredi me 0% interes) si familje me statusin e të pastrehut në ish pronë private, në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe

⁵⁴Sipas certifikatës familjare datë 19.8.2014 nuk rezultojnë pjesëtarë të familjes të shkëputur nga trangu familjar.

*Ministrisë së Zhvillimit Urban, nr. ***, datë 2.9.2008, 'Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti', i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar)'. Referuar këtij udhëzimi, të drejtën e përfitimit e kishin të gjithë pjesëtarët që rezultonin në gjendjen familjare të datës 1.12.1992 dhe që nuk dispononin banesë të regjistruar ose në proces regjistrimi (pika 7/1,a e udhëzimit nr. ***). Sipas dokumentacionit të depozituar pranë EKB-së rezultoi se familja K., në datën 1.12.1992, ka pasur në përbërjen e saj 3 pjesëtarë dhe sipas udhëzimit të sipërcituar duhet të përfitonte kredi për një apartament me strukturë 1+1, por duke qenë se një pjesëtar i familjes ka rezultuar me banesë, familja është trajtuar me kredi për një apartament me strukturë "garsonierë".*

Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se, në vijim, kontrata për përfitimin e kësaj kredie është lidhur ndërmjet familjes K. dhe BKT-së në datën 19.12.2014, me një afat shlyerje prej 30-vitesh. Prej tyre është plotësuar dhe dërguar i gjithë dokumentacioni dhe EKB-ja ka vendosur në lidhje me kredinë se cili nga anëtarët e familjes, sipas certifikatës së gjendjes familjare datë 1.12.1992, e përfitonte atë dhe masën. Konkretisht, bashkëshorti i saj, kishte në bashkëpronësi apartamentin me sip. 66 m² në Lagjen ***, Plazh, Durrës, ku aty jetonin ajo me bashkëshortin dhe dy fëmijët dhe pavarësisht këtij fakti ata kurrë nuk kanë menduar se janë persona përfitues të ndonjë kredie nga shteti. Subjekti dhe bashkëshorti nuk gëzonin statusin e të pastrehut. Znj. V. K. kishte paguar në vitin 2011 shumën 5,298,583 lekë dhe referuar të gjithë praktikës së EKB-së dhe praktikës së BKT-së rezultoi se në Aneksin e Elementëve Specifikë të Kredisë datë 19.12.2014, është cilësuar se shuma e kredisë prej 2,486,400 lekësh do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit. Në këto rrethana, nëse ajo dhe bashkëshorti nuk do të hynin garantorë në BKT për marrjen e kësaj kredie, BKT-ja jo vetëm nuk do të jepte kredinë, por vjehrra do të vazhdonte të mbante statusin e të pastrehut pavarësisht pagesës së një kësti për blerje shtëpie në vitin 2011, kredi për të cilën deklaroi se vazhdojnë të paguajnë ata (ajo dhe bashkëshorti) rregullisht nga viti 2015 dhe aktualisht.

Subjekti referon se edhe në shkresën nr. *** prot., datë 30.12.2021, të dërguar nga EKB Drejtoria Rajonale Durrës, është cilësuar se në lidhje me këtë praktikë EKB-ja nuk ka pasur asnjë problematikë apo pretendim në lidhje me anën ligjore të miratimit të saj konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi.

Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjëherë çështje në hetim me Bashkinë Durrës, qoftë gjatë punës si oficer e policisë gjyqësore dhe as gjatë ushtrimit të detyrës si prokurore as në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe as në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Në përfundim të prapësimeve të saj, subjekti ka parashtruar se kredia me kushte lehtësuese është përfituar nga nëna e bashkëshortit të saj në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, por në kushtet kur nuk është konstatuar asnjë konflikt interesi, ligjshmëria e marrjes së kësaj kredie nuk mund të ndikojë në procesin e saj të rivlerësimit sepse nuk është veprim i kryer nga ana e saj dhe, si rrjedhojë, asnjë subjekt nuk mund të mbajë përgjegjësi pa faj.

Vlerësimi përfundimtar i bërë nga Komisioni/analiza e shpjegimeve dhe provave

Pas analizimit të parashtrimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në harmoni me dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me kredinë me kushte lehtësuese me përfituese nënën e bashkëshortit të saj, për shkak të statusit si e "pastrehë".

Kështu, trupi gjykues vlerëson se palët, kreditor dhe debitor, janë subjektet e marrëdhënies juridike që lind gjatë procesit të kreditimit dhe se pala aplikuese dhe përfituese e statusit të të pastrehut dhe, për rrjedhojë, edhe e kredisë ka qenë nëna e bashkëshortit dhe jo vetë subjekti i rivlerësimit.

Trupi gjykues, pas shqyrtimit/analizimit tërësor dhe individual të akteve shkresore dhe shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me

marrëdhënien e kreditimit, në BKT, vlerësoi se kjo kredi është marrë nga nëna e bashkëshortit të subjektit si përfituese e saj, jo me statusin e një të pastrehu klasik, por të një kategorie të veçantë, atë të “të pastrehut në ish-pronë private”, kategori për të cilën shteti ka qenë i detyruar për të garantuar dhe siguruar strehim (edhe në formën e sigurimit të një kredie me kushte lehtësuese) duke arritur në konkluzionin se mungon përgjegjësia konkrete e subjektit të rivlerësimit, lidhur me mënyrën e përfitimit të kredisë.

Më pas, nëna e bashkëshortit ka nënshkruar kontratën e kredisë me BKT-në, ku si bashkëkredimarrës shfaqet bashkëshorti i subjektit dhe si garantore vetë subjekti i rivlerësimit, për shkak të faktit se ata kishin të ardhura të dokumentuara (pagë të deklaruara), të cilat do të mund të shërbenin si një garanci për vetë bankën.

Për sa më sipërrasyetuar, trupi gjykues vlerëson se nuk ka shkaqe ligjore për të ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit për efekt të këtij procesi.

iii. Pagesa e shumës 2,000,000 lekë, në datën 5.12.2014, e kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti, deklaruar me burim nga gjendja e likuiditeteve cash

Siç u evidentua më sipër, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, subjekti ka deklaruar se për kryerjen e pagesave për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi ka shërbyer edhe shuma prej 2,000,000 lekësh, të paguar prej saj dhe bashkëshortit, nga gjendja *cash* që dispononin në shtëpi, me burim të ardhurat familjare të mbledhura ndër vite dhe ato të përfituara nga puna e bashkëshortit në emigracion.

Komisioni konstaton se në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.9.2012) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash* në vlerën 25,000 euro me burim të ardhurat nga puna e bashkëshortit në emigracion (vitet 1993 – 2003), puna e tij në Shqipëri dhe puna e saj ndër vite.

E pyetur më parë nga ILDKPKI-ja⁵⁵ mbi burimin e krijimit të shumës 25,000 euro, të deklaruar si gjendje likuiditetesh *cash* në deklaratën para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *bashkëshorti i saj ka jetuar e punuar në Greqi në vitet 1993 – 2003, së bashku me familjen e tij. Duke u nisur nga kushtet e asaj kohe nuk disponojnë dokumente ligjore mbi këto të ardhura, por thekson së kjo shumë është burim i punës së vazhdueshme të bashkëshortit dhe familjes së tij. Sqaron se ajo ka jetuar dhe jeton së bashku me bashkëshortin dhe prindërit e tij dhe kjo shumë ka burim të ardhurat e gjithë familjes.*

Gjithashtu, në deklarimet e dhëna në ILDKPKI (datë 11.2.2016) subjekti ka sqaruar se së bashku me bashkëshortin, për këtë banesë (i referohet pasurisë objekt vlerësimi), kanë paguar shumën 2,000,000 lekë, me burim gjendjen *cash* të deklaruar prej saj.

Komisioni konstaton se në DIPP/2014 subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar pakësim të gjendjes së likuiditeteve *cash* të deklaruara më parë.

Sa më sipër, duket se gjendja e likuiditeteve *cash*, e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, nuk mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

Lidhur me këtë konstatim, me anë të prapësimeve të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se në deklaratën *Vetting* ka deklaruar qartësisht se shuma prej 2.000.000 lekësh është paguar prej saj dhe bashkëshortit, e cila është e disponuar prej tyre si gjendje *cash* në atë kohë në shtëpi dhe ka pasur si burim të ardhurat familjare të mbledhura ndër vite, si dhe të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit në emigracion.

⁵⁵Referohuni procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 11.2.2016, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2020, të ILDKPKI-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.1.2020).

Në vijim të prapësimeve, subjekti ka shpjeguar se në datën 5.12.2014, kur është paguar shuma 2,000,000 lekë, sikundër rezulton e provuar nga deklarimi i burimit në deklaratën *Vetting*, kjo shumë është krijuar nga gjendja *cash*, e disponuar prej tyre nga të ardhurat nga emigracioni dhe kursimet ndër vite. Subjekti deklaron se bashkëshorti nuk ka dashur asnjëherë të përdorë dhe shpenzojë këto kursime të tij (të ardhurat nga emigracioni që jetonte së bashku me prindërit në Greqi) deri në momentin që kanë krijuar një stabilitet financiar dhe prindërit e bashkëshortit përfitonin të ardhura edhe nga pensioni në Shqipëri dhe nga ndihma në Kanada.

Komisioni konstaton se subjekti ka pranuar pasaktësinë në deklaram, në DIPP/2014, kur ka përshkruar kontratën e sipërmarrjes për pasurinë objekt vlerësimi dhe ka deklaruar se *çdo e dhënë ndihmëse ndodhet në kopjen e kontratës së sipërmarrjes*, në të cilën përshkruheshin kështu e paguara dhe momenti i pagesës së tyre.

Si përfundim, subjekti thekson faktin se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* ka deklaruar qartësisht burimin për pagesën e kështit të tretë, në shumën prej 2,000,000 lekësh dhe se, gjithashtu, në këtë deklaratë nuk ka deklaruar gjendje likuiditeti *cash*, fakt i cili tregon se gjendja *cash*, e deklaruar para fillimit të detyrës, ka qenë e pakësuar plotësisht në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Në këtë kontekst edhe nëpërmjet prapësimeve dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka kërkuar që të prevalojë deklarimi i bërë në deklaratën *Vetting*.

Vlerësimi përfundimtar i bërë nga Komisioni/analiza e shpjegimeve dhe provave

Në shqyrtim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, kuadrit ligjor që lidhet me procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, si dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁵⁶, Komisioni çmon se sa i përket vlerësimit të pasurisë, procesi nis me verifikimin dhe kontrollin e deklarimeve të bëra nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit *Vetting*, e më tej me krahasimin dhe analizimin e saj në raport me deklaramet periodike të interesave, kjo në këndvështrim edhe të vlerës së provës që marrin këto deklarata, në kuptim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuadër, trupi gjykues vlerëson se fillesa e kontrollit nga deklarata e pasurisë së rivlerësimit merr rëndësi në përcaktimin e përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në kontekst dhe për qëllim të këtij procesi.

Siç u evidentua më sipër, rezulton se në deklarimin e bërë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* për pasurinë objekt vlerësimi, subjekti ka referuar si një nga burimet e krijimit të saj shumën 2,000,000 lekë, të paguar prej saj dhe bashkëshortit nga gjendja *cash* që disponohej prej tyre në shtëpi, me burim të ardhurat familjare të mbledhura ndër vite dhe ato të përfituara nga puna e bashkëshortit në emigracion. Por, rezulton se në rubrikën e të ardhurave të kësaj deklarate subjekti nuk ka referuar të ardhura të krijuara me burim punën e bashkëshortit në emigracion në shtetin grek.

Nëpërmjet prapësimeve të depozituara dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka sqaruar se në deklaratën *Vetting* nuk ka deklaruar të ardhura nga puna e bashkëshortit në emigracion në shtetin grek, për shkak se deri në atë moment nuk ka disponuar dokumentacion mbi këto të ardhura. Por, megjithatë subjekti referon se i ka deklaruar këto të ardhura si burim krijimi të pasurisë.

Komisioni konstaton se në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (depozituar në ILDKPKI në datën 28.9.2012) subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit likuiditete në gjendje *cash*, në vlerën prej 25,000 euro, me burim krijimi të ardhurat e bashkëshortit nga puna e tij në emigracion dhe në Shqipëri, por edhe nga puna e saj.

Në vijim të verifikimit të deklaratave periodike vjetore të depozituara ndër vite në ILDKPKI, mbi deklarimin e bërë për shtesat/pakësimet/gjendjet e likuiditeteve *cash*, Komisioni konstaton

⁵⁶Shihni vendimin nr. 33, datë 3.11.2021, të Kolegjit (faqet 13-14).

se, referuar deklaramit të bërë veçmas në DIPP/2012, nga bashkëshorti i subjektit, si person i lidhur që mbart detyrimin për deklaram, rezulton se për krijimin e depozitës në datë 17.12.2012, në vlerën prej 5,000 euro, ka deklaruar si burim të ardhurat nga gjendja e likuiditeteve *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë. Pra, pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar specifikisht pakësimin e gjendjes *cash* në DIPP/2012, nisur nga logjika e deklaramit, Komisioni vlerëson se në fund të vitit 2012, subjekti dhe personi i lidhur, bazuar në vetëdeklaramet e bëra, dispononin gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën prej 20,000 euro.

Ndërsa, në DIPP/2013, bashkëshorti i subjektit, si person i lidhur që mbart detyrimin për deklaram, ka deklaruar pasurinë e llojit “likuiditet”, llogari rrjedhëse në BKT, në shumën prej 8,000 euro, sipas deklaramit të mëparshëm. Duke iu referuar deklaramit të mëparshëm të shumës 5,000 euro, depozitë në BKT, Komisioni vëren se si burim i saj janë referuar të ardhurat nga gjendja e likuiditeteve *cash* të deklaruara nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë. Pra, edhe në këtë rast, Komisioni vlerëson se pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar specifikisht pakësimin e gjendjes *cash* në DIPP/2013, nisur nga logjika e deklaramit, në fund të vitit 2013, subjekti dhe personi i lidhur bazuar në vetëdeklaramet e bëra, dispononin gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 17,000 euro.

Komisioni konstatoi se shuma 8,000 euro, e deklaruar si gjendje në llogari bankare në fund të vitit 2013, në datën 12.8.2014, është transferuar nga llogaria e bashkëshortit në llogarinë e nënës së subjektit. Nga analizimi i shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit, Komisioni krijoi bindjen se kjo shumë i është kthyer bashkëshortit të subjektit nga vëllai i saj, përpara se të bëhej pagesa e këstit të fundit të pasurisë objekt vlerësimi. Në këtë kuptim, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, krahas gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën 17,000 euro, të vlerësuara si të disponuara në fund të vitit 2013, përpara pagesës së këstit të fundit për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, kanë pasur edhe shumën 8,000 euro si gjendje likuiditetesh *cash*, e cila vlerësohet si vlerë e mundshme që mund të ketë shërbyer për pagesën e kryer në datën 5.12.2014, në favor të shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k.

Në DIPP/2014, subjekti ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes për apartamentin e banimit, të datës 5.12.2014, të lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k., duke referuar se çdo e dhënë ndihmëse ndodhet në kontratën e sipërmarrjes. Nga verifikimi i kontratës së sipërmarrjes rezulton se në të është përcaktuar se një nga këstet e likuidimit të çmimit të blerjes, në shumën 2,000,000 lekë, është paguar në ambientet e shoqërisë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

Komisioni konstaton se në DIPP-të e viteve 2014, 2015 dhe 2016, subjekti nuk ka deklaruar mbi shtesa/pakësime të likuiditeteve *cash*. Gjithashtu, konstatohet se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, e cila në fakt rezulton se është depozituar përpara DIPP/2016, subjekti nuk ka deklaruar pasuri të llojit “likuiditete *cash*”, madje as likuiditete gjendje në llogari bankare.

Në këtë kuadër, në kuptim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerësoi fuqinë provuese të deklaratave periodike vjetore – në raport me deklaramin e bërë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, në referim të së cilës rezulton se nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash*, por nga ana tjetër ka referuar si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi gjendjen e likuiditeteve *cash* të deklaruara më parë, duke i dhënë, sigurisht, prioritet deklaramit të bërë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, bazuar kjo në logjikën e deklaramit të subjektit, si dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit⁵⁷.

Për sa më sipër, për sa kohë në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar specifikisht se shuma prej 2,000,000 lekësh, e paguar prej saj dhe bashkëshortit në datën 5.12.2014, ka si burim gjendjen e likuiditeteve *cash* të deklaruara më parë prej tyre, Komisioni arrin në përfundimin se kjo vlerë ka si burim gjendjen e likuiditeteve të disponuara *cash* nga subjekti dhe personi i

⁵⁷Referohuni edhe vendimit nr. 28/2022, datë 14.7.2022, të Kolegjit.

lidhur sipas deklarimit të bërë prej tyre në deklaratat e mëparshme të interesave privatë, pavarësisht mosdeklarimit prej tyre të pakësimit të gjendjes së likuiditeteve *cash* në DIPP/2014. Kjo situatë vlerësohet sigurisht edhe në konsideratë të fakteve se: (i) nga hetimi i kryer nuk rezultoi që subjekti të ketë krijuar pasuri të tjera (të paluajtshme/apo të luajtshme) përgjatë viteve 2015 dhe 2016; (ii) subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash* në deklaratën e rivlerësimit kalimtar; (iii) subjekti ka saktësuar deklarimin e tij – edhe në shpjegimet e dhëna më parë në ILDKPKI, para dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

Si konkluzion, në lidhje me këtë çështje, bazuar edhe në qëndrimin e konsoliduar të mbajtur nga Kolegji⁵⁸, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklarimet periodike për sa kohë nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

Në këtë këndvështrim, Komisioni verifikoi dhe analizoi ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara si burim për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash*, në shumën prej 25,000 euro, në deklaratën fillestare të interesave private.

Analiza e burimit të krijimit të të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i gjendjes së likuiditeteve *cash* në deklaratën fillestare të pasurisë

Komisioni vlerëson se, pavarësisht se kjo pasuri është krijuar përpara fillimit të detyrës së prokurorit, ajo duhet të jetë objekt verifikimi në kuadër të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë çmohet se nëpërmjet procesit të rivlerësimit shqyrtohet edhe e shkuara e subjekteve të rivlerësimit.

Në vijim të arsytimit, trupi gjykues vlerëson se procesi i rivlerësimit është analizë edhe e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe, për këtë shkak, institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin në të shkuarën, për të cilin është krijuar kjo pasuri dhe rivlerësimi *Vetting* mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike.

Në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ka arritur në konkluzionin se nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj.

Në këtë këndvështrim, për efekt të këtij procesi, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ka pasur detyrimin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe të mos fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij dhe organet e rivlerësimit kanë si qëllim që të identifikojnë ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

Komisioni vëren se gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim kryesor për krijimin e shumës 25,000 euro, të deklaruar si gjendje likuiditetesh *cash* në deklaratën para fillimit të detyrës, kanë shërbyer të ardhurat nga puna e bashkëshortit në emigracion (në shtetin grek) për periudhën 1993 – 2003.

⁵⁸Shihni vendimet e Kolegjit: nr. 24/2021 (JR), datë 28.7.2021; nr. 28/2020 (JR), datë 23.10.2020; nr. 25/2021 (JR), datë 29.7.2021.

Analiza mbi shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti mbi të ardhurat e bashkëshortit nga puna e kryer në emigracion në shtetin grek

Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i saj nga emigracioni në shtetin grek, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka parashtruar se:

- Në vitin 1991 bashkëshorti I. K., në moshën 16-vjeçare, ka shkuar në Greqi tek teza e tij, znj. N. Sh., e cila jetonte/jeton në Athinë me familjen. Nga bashkëshorti ka mësuar se atje është pagëzuar me emrin Dh.⁵⁹. Pas pak muajsh (po në vitin 1991) është kthyer në Shqipëri dhe në shtator ka vijuar shkollën e mesme të muzikës “****”, Durrës. Në vitin 1993 është rikthyer në Greqi ku ka qëndruar për 10 vjet, deri në vitin 2003.

- Nga viti 1994 deri në korrik të vitit 1995 ka punuar në ndërtim (por për këto të ardhura nuk disponojmë dokumentacion).

- Sipas dokumentit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (IKA) rezulton se në shtator të vitit 1995 deri në maj të vitit 1998, shtetasi Dh. K., i vitlindjes 1975, ka qenë në marrëdhënie pune sipas dokumentacionit të të ardhurave dhe kontributeve që disponojnë në origjinal.

- Sipas dokumentit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (IKA) rezulton se nga janari i vitit 2001 deri në qershor të vitit 2001, shtetasi Dh. K., i vitlindjes 1975, ka qenë në marrëdhënie pune sipas dokumentacionit të të ardhurave dhe kontributeve që disponojnë në origjinal.

- Deklaron se për periudhën korrik-dhjetor 2001, bashkëshorti i saj nuk disponon fletën e pullave me pagat e marra në këtë periudhë, por ajo pretendon se nëse i referohet marrëdhënies së punës më poshtë, vërtetohet se punëdhënësi është i njëjtë në vitin 2002, çka tregon se marrëdhënia e punës ka vazhduar edhe për periudhën që nuk disponohet ky dokumentacion. Në këtë kontekst, kërkon nga Komisioni që për këtë periudhë të ardhurat nga paga të njihen në të njëjtën masë sa ato të përlllogaritura për periudhën janar - qershor, duke i shtuar edhe pagën shpërblim të marrë në muajin dhjetor, si çdo vit.

- Sipas dokumentit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (IKA) rezulton se nga janari i vitit 2002 deri në mars të vitit 2003, shtetasi Dh. K., i vitlindjes 1975, ka qenë në marrëdhënie pune sipas dokumentacionit të të ardhurave dhe kontributeve që disponojnë në origjinal⁶⁰.

- Po ashtu disponojnë dokument në origjinal në emër të shtetasit Dh. K., me fotografi, në lidhje me librezën personale të shëndetit (IKA) të viteve 1999 – 2002. Edhe ky dokument është njësuar me origjinalin dhe përkthyer në gjuhën shqipe.

- Gjithashtu, disponojnë librezë personale të shëndetit, e vlefshme për vitin 2003 (IKA). Dokument i njëjtësuar me origjinalin dhe përkthyer në gjuhën shqipe.

Në vijim të parashtrimeve, subjekti ka shpjeguar se për periudhën 1998 – 2001, bashkëshorti I. K. ka qenë krijues dhe pjesëtar i grupit muzikor “****” së bashku me shtetasin M. D. dhe shtetasen A. M. (Gj.). Gjatë kësaj periudhe bashkëshorti i ka pohuar se kanë marrë pjesë në shumë koncerte në disa qytete të Greqisë, në Qipro dhe në Shqipëri. Po ashtu, kanë lidhur kontratë me shtëpinë diskografike “****”, sipas kontratës datë 19.7.1999, për publikimin, shpërndarjen dhe shitjen e albumit me emrin “****”. Të ardhurat e mbledhura nga koncertet dhe nga shitja e albumit, sipas bashkëshortit, kanë qenë rreth 35,000 euro për secilin pjesëtar të grupit. Kjo është vetëdeklaruar edhe nga dy pjesëtarët e tjerë të grupit, të cilët jetojnë dhe

⁵⁹Në lidhje me ndryshimin e emrit nga I. në Dh. subjekti ka deklaruar se disponon një kopje të certifikatës së pagëzimit të Kishës ***, Mesogeas. Me të dhënat emri i të pagëzuarit Dh. K., i datëlindjes 18.7.1975, data e pagëzimit 8.8.1991, me nr. regjistri pagëzimi ***, duke bashkëlidhur, ndër të tjera, edhe: (i) disa foto në lidhje me momente nga pagëzimi; (ii) deklaratë pagëzimi e përkthyer nga greqishtja në gjuhën shqipe; (iii) vetëdeklarimi/deklaratë personale e shtetasen N. Sh., datë 1.10.2021, me vulë apostile, e përkthyer dhe noterizuar.

⁶⁰Në lidhje me të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit në Athinë, Greqi në vitet 1995 – 2003, subjekti pretendon se të ardhurat janë: (i) për vitin 1995, në shumën 632,917 dhrahmi; (ii) për vitin 1996, në shumën 2,250,300 dhrahmi; (iii) për vitin 1997, në shumën 2,390,600 dhrahmi; (iv) për vitin 1998, në shumën 966,100 dhrahmi; (v) për vitin 2001, në shumën 1,182,559 dhrahmi; (vi) për vitin 2002, në shumën 8,265.12 euro; (vii) për vitin 2003 në shumën 2,528.9 euro.

punojnë në Greqi, shtetasit A. M. dhe M. D.⁶¹.

Gjatë hetimit administrativ subjekti ka dorëzuar në Komision dokumentet, kontratën datë 19.7.1999 me shtëpinë diskografike “****”, deklaratën personale/vetëdeklarim të shtetasit A. M. me vulë apostile të përkthyer dhe noterizuar, deklaratë personale/vetëdeklarim të shtetasit M. D., me vulë elektronike të përkthyer dhe noterizuar.

Subjekti ka sqaruar se nuk disponojnë dokumentacion në lidhje me këto shuma, pasi bashkëshorti i ka pohuar se këto të ardhura merreshin para apo pas çdo koncerti në dorë ose me çek bankar, si dhe në lidhje me publikimin e albumit dhe më pas shitjen e tij të ardhurat i janë dhënë nga shtëpia diskografike.

Subjekti ka referuar se albumi është i publikuar në internet, fakt i cili provon që të ardhurat janë siguruar nga një burim i ligjshëm, duke evidentuar faktin se blerja e albumit me titull “****” nga grupi “****”, është i aksesueshëm edhe sot në rrjetin Amazon.co.uk dhe jo vetëm. Në datën 5.10.2021, bashkëshorti I. K. ka bërë një blerje *online*, në adresën https://www.amazon.co.uk**** duke porositur albumin për çmimin 7.79 GBP.

Në lidhje me dokumentacionin provues për pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga albumi, subjekti pretendon se ka qenë detyrimi i shtëpisë diskografike për llogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen e tatimit. Por, për shkak të kohës së largët që ka kaluar ka qenë e pamundur të sigurohet ky dokumentacion për vetë faktin se edhe në adresën e shtëpisë diskografike për vitet 1998 – 2001, sot nuk ekzistojnë më të dhëna për shoqërinë. Po ashtu, subjekti ka referuar se nga një kërkim *online* në adresën https://www.discogs.com*** për këtë shoqëri rezulton se ka publikuar vetëm 4 produksione muzikore, përfshirë edhe albumin “****”, por nuk ka të dhëna për vitet apo të dhëna të tjera ndihmëse.

Megjithatë, subjekti parashton se bashkëshorti i saj ka kërkuar, verifikuar dhe mbledhur dokumentacion për këtë marrëdhënie dhe, konkretisht:

- Në datën 30.9.2022 ka kontaktuar me të njohurën e tij, znj. N. B., me profesion avokate në Greqi, së cilës i ka kërkuar se si mund të kërkonte dhe merrte informacion në lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k. ose “****”, sh.p.k. Kjo gjë edhe për faktin, pasi bashkëshorti pas vitit 2003 nuk figuron më në Greqi dhe, në këto kushte, nuk ka asnjë lloj akses në kërkime as si Dh. K. Znj. N. B. (e cila është me origjinë shqiptare) duke qenë se punon si avokate në një qytet larg Athinës konkretisht, në Katerini, kontaktoi me një kolegen e saj/avokate në Athinë të quajtur Dh. A. Kjo e fundit është edhe pedagoge e së drejtës administrative në Universitetin e Athinës, e cila na orientoi që t’i drejtoheshim me një kërkesë-*email*, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Athinë, në Departamentin e Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar për të mësuar nëse shoqëria ishte e regjistruar në Regjistrin e Përgjithshëm Tregtar.

- Me *email*-in datë 14.10.2022, nga adresa ***@hotmail.com në adresën info@***.gr bashkëshorti ka kërkuar informacion të detajuar rreth shoqërisë “****” sh.p.k. ose “****” sh.p.k., nëse shoqëria ekzistonte sot, si dhe adresën dhe çdo të dhënë ndihmëse. Në të njëjtën datë edhe avokatja Dh. A. i është drejtuar me shkresë zyrtare Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Athinë, në Departamentin e Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar, për të mësuar nëse shoqëria ishte e regjistruar në Regjistrin e Përgjithshëm Tregtar.

- Në datën 18.10.2022, në adresën e bashkëshortit është dërguar *email* nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Athinë, nga adresa ***@***.gr. Në përgjigjen e kthyer me *email* theksohet: “*Se sa i përket kërkesës tuaj dhe kërkesës paralele të avokates Dh. A., po ju vëmë në dispozicion një kopje të vërtetimit sa i përket mosregjistrimit në Regjistrin e Përgjithshëm Tregtar të shoqërisë ‘****’ sh.p.k. (emri i shoqërisë sipas kontratës datë 19.7.1999 të lidhur mes Dh. K.,*

⁶¹Subjekti ka bashkëlidhur ndër të tjera edhe: kontratë datë 19.7.1999, me shtëpinë diskografike “****”; deklaratë personale/vetëdeklarim të shtetasit A. M. me vulë apostile të përkthyer dhe noterizuar; deklaratë personale/vetëdeklarim të shtetasit M. D., me vulë elektronike të përkthyer dhe noterizuar.

A. Gj. dhe M. D. me shoqërinë diskografike “*** sh.p.k.)”.

- Në datën 19.10.2022 është dërguar edhe fizikisht përgjigja e shkresës e apostiluar, dërguar nga av. Dh. A.. Nga kjo shkresë rezulton se: “Konfirmojmë se siç rezulton nga regjistrat dhe arshiva, në bazë të dispozitave të ligjit nr. 4919/2022, si dhe vendimeve ministrore të nxjerra në varësi të tyre pranë Regjistrat të Përgjithshëm Tregtar dhe të dhënave të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Athinë shoqëria me emrin “***” sh.p.k., e cila është e regjistruar në Protokollin e Emrave të Dhomës sonë me A. M. *** dhe numër ***, nuk është regjistruar dhe nuk ka dorëzuar dokumentet legalizuese dhe dokumentet mbështetëse për regjistrimin e tij (në përputhje me përcaktimet e neneve 1 dhe 2 të vendimit të Ministrisë ***) dhe, për rrjedhojë, nuk ka fituar (pjesë dhe dosje) në Regjistrin e Përgjithshëm Tregtar, për të lëshuar certifikatat dhe kopjet e kërkuara, bazuar në shënimet në të nga data 31.12.2012, sipas nenit 20/4 i ligjit nr.4919/2022. Fletorja Zyrtare 71/2022”.

Bazuar në vërtetimin e mësipërm, rezulton se shoqëria “***” sh.p.k. me të cilën bashkëshorti në vitet 1999 – 2001 ka bashkëpunuar në tregun muzikor, duke krijuar jo vetëm këngë, album, por edhe duke performuar nëpër shumë koncerte, sot nuk ekziston, më saktë nga viti 2012, referuar të dhënave të Regjistrat të Përgjithshëm Tregtar.

Në vijim të prapësimeve të saj, subjekti referon se nga avokatja i është dërguar me *email* edhe një opinion juridik në lidhje me ligjin nr. 4919/2022, “Themelimi i Shoqërive Tregtare”, neni 20/4, i cili përcakton se afati i regjistrimit të kësaj shoqërie ka qenë deri më 31.12.2012, sipas edhe vërtetimit.

Pra, sa më sipër, nisur nga i gjithë kërkimi që kanë bërë dhe dokumentacioni/informacioni që kanë marrë, subjekti ka kërkuar nga Komisioni që të vlerësohet se është në kushtet e aplikimit të nenit 32/2, i cili parashikon se: “Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor”, dhe të vlerësojë deklaratimet e bashkëshortit të saj dhe të anëtarëve të grupit për të provuar realizimin e shumës 35,000 euro.

Në këtë kontekst, subjekti ka ritheksuar faktin se bashkëshorti i saj, për shkak të kthimit të tij në Shqipëri në vitin 2003, ku ka pasur emrin e pagëzimit Dh. K. dhe për shkak të dixhitalizimit të të dhënave në Greqi nuk ka më asnjë akses të kërkojë/marrë/pajiset me dokumentacion ligjor, pasi në shtetin grek pas vitit 2003 nuk figurojnë të dhëna në emër të tij, pasi ai në Greqi siç është theksuar më sipër është regjistruar me emër tjetër. Deklaron se kjo gjë i ka kufizuar në kërkime, nisur edhe nga periudha e gjatë prej rreth 20 vjet. Edhe kërkimet e kryera nga avokatja e kontaktuar prej tyre nuk dhanë rezultat pozitiv për shkak se shoqëria nuk ka dorëzuar dokumentacionin në bazë të ligjit. Në kushtet kur bashkëshorti nuk legjitimohet si palë që mund të kërkojë informacion apo të dhëna në institucionet shtetërore, si dhe në kushtet kur shoqëria nuk ekziston, subjekti pretendon se vërtetohet qartësisht pamundësia objektive në gjetjen e dokumenteve, që pasqyrojnë të ardhurat dhe tatimin e paguar për këto të ardhura.

Subjekti parashtron faktin se gjatë hetimit administrativ kanë paraqitur kontratën e shërbimit, duke pretenduar se ashtu si në legjislacionin shqiptar detyrimin për të mbajtur dhe paguar tatimin në burim e ka pasur shoqëria, e cila vepron si agjente tatimore.

Si konkluzion, subjekti ka pretenduar se në kushtet kur: (i) provohet kontrata me shtëpinë diskografike “***”; (ii) ka të dhëna në internet për ekzistencën e grupit dhe albumin e nxjerrë nga ky grup⁶² (ka depozituar si provë bashkëlidhur prapësimeve edhe CD e blerë në Amazon); (iii) anëtarët e grupit mbështesin deklaratimet e dhëna nga bashkëshorti; (iv) bashkëshorti nuk

⁶²https://www.youtube.com***

legjitimohet të kërkojë të dhëna për shoqërinë në organet tatimore greke edhe për shkak të faktit se ka qenë regjistruar me emrin Dh. dhe jo I.; (v) shoqëria nuk ekziston më dhe në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Greke shoqëria/shtëpia diskografike nuk ka dorëzuar dokumentacion (pra, për shkaqe të pavarura nga ana e bashkëshortit), ashtu siç provohet nga dokumentacioni bashkëlidhur këtyre prapësimeve; (vi) këto të ardhura janë përfituar rreth 21 vjet më parë; (vii) si edhe në konsideratë të faktit që në momentin e realizimit të këtyre të ardhurave bashkëshorti nuk ka qenë subjekt deklarues, ka kërkuar nga Komisioni që të pranojë krijimin e këtyre të ardhurave, sipas vlerës së deklaruar.

Gjithashtu, Komisioni vëren se nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore ka pretenduar se sipas pohimeve të bashkëshortit të saj, të ardhurat totale të krijuara prej tij nga puna në emigracion në shtetin grek, për periudhën 1993 – 2003, kanë qenë në total në shumën 70,000 euro, nga të cilat 28,000 euro janë të provuara sipas dokumentacionit IKA, 35,000 euro të përfituara nga bashkëpunimi me shtëpinë diskografike, koncertet e dhëna në Greqi, Qipro, etj., muzika e bërë *live* me grupin nëpër evente të ndryshme në Greqi dhe publikimi i albumit, ndërsa pjesën tjetër të të ardhurave e ka përfituar nga puna si emigrant i paregjistruar.

Vlerësimi përfundimtar i bërë nga Komisioni/analiza e shpjegimeve dhe provave

Nga analizimi në tërësi i shpjegimeve dhe provave të administruara rezulton e provuar se përgjatë viteve 1993 – 2003, subjekti i rivlerësimit ka qenë emigrant ekonomik në shtetin grek. Gjithashtu, rezulton e provuar me dokumentacion justifikues ligjor përfitimi i shumës prej rreth 28,000 euro, si rezultat i marrëdhënies së punësimit të tij në shtetin grek, për periudha që i përkasin viteve 1995 – 2003.

Siç u evidentua më sipër, subjekti ka pretenduar se bashkëshorti për një periudhë kohe ka punuar si i paregjistruar, punonjës informal dhe në një periudhë tjetër kohore ka përfituar të ardhura sipas marrëveshjes së nënshkruar me një shtëpi diskografike, si dhe nga koncertet, eventet, muzika *live* etj., në të cilën merrte pjesë grupi i tij muzikor.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka depozituar prova të shumta mbi aktivitetin e grupit muzikor të bashkëshortit të saj, në referim të të cilave trupi gjykues krijoi bindjen se ai ka përfituar të ardhura nga bashkëpunimi me shtëpinë diskografike, luajtjen e muzikës *live* nëpër evente dhe nga shitja e albumit. Në këtë kontekst, vlerësohet edhe përpjekja e vazhdueshme dhe në mënyrë shteruese e bërë nga subjekti dhe personi i lidhur për kërkimin e provave për vërtetimin e ekzistencës së vlerave monetare të përfituara prej tij nga marrëdhënia e bashkëpunimit me shtëpinë diskografike dhe pagesa e detyrimeve tatimore mbi to, duke e çuar Komisionin në përfundimin se ata gjenden në kushtet e pamundësisë objektive për sigurimin e informacionit/dokumentacionit shtesë të kërkuar mbi këtë marrëdhënie, sipas parashikimit të bërë në nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, duket i besueshëm dhe i vërtetë deklarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit mbi shumën e të ardhurave të përfituara nga puna e bashkëshortit në emigracion, duke pretenduar në total shumën 70,000 euro, por duke evidentuar faktin se vetëm shuma prej rreth 28,000 euro është e provuar me dokumentacion të plotë justifikues ligjor.

Komisioni sjell në vëmendje këtu se të ardhurat nga puna e bashkëshortit të subjektit nga puna e tij në emigracion janë deklaruar se kanë shërbyer për pagesën e shumës 10,000 euro për likuidimin e kështit të parë për apartamentin e blerë në vitin 2005, të ndodhur në Lagjen ***, Durrës, e konkretisht se vlera 5,000 euro ka pasur burim të ardhurat nga emigracioni, si dhe si burim krijimi i gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën 25,000 euro, deklaruar nga subjekti si gjendje *cash* në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës. Në këtë kontekst, Komisioni evidenton faktin se si burim për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* të deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës janë deklaruar edhe të ardhurat nga puna në Shqipëri e subjektit dhe e bashkëshortit. Rezulton se subjekti, para emërimit në detyrën e prokurores, ka punuar si oficer e policisë gjyqësore, ndërsa bashkëshorti ka qenë i punësuar në shoqëri private.

Parë në këtë këndvështrim, në kushtet kur Komisioni krijoi bindjen se bashkëshorti i subjektit ka përfituar të ardhura nga bashkëpunimi me shtëpinë diskografike, luajtjen e muzikës *live* nëpër evente të ndryshme dhe nga shitja e albumit, por se nga ana tjetër nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor shuma e të ardhurave të përfituara nga ky bashkëpunim, mund të supozohet se këto të ardhura, si dhe ato të përfituara për vitet gjatë të cilave ka punuar në mënyrë informale (i paregjistruar) të kenë mbuluar shpenzimet jetike të personit të lidhur gjatë qëndrimit në Greqi.

Duke mbajtur në konsideratë arsyetimin logjik si më lart, Komisioni çmon se në vetvete vlera prej 28,000 euro, e provuar me dokumentacion justifikues ligjor si e përfituar nga bashkëshorti i subjektit prej punës së tij në emigracion në shtetin grek, duket se është e mjaftueshme për të justifikuar pagesën e shumës 5,000 euro në vitin 2005, si dhe së bashku me të ardhurat e tjera të krijuara prej tij dhe subjektit nga puna e tyre në Shqipëri – për krijimin e shumës 25,000 euro, të deklaruar si gjendje në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (në vitin 2012).

Për sa u analizua më sipër në lidhje me burimet e deklaruara të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur (prindërit e bashkëshortit) kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesat e kryera për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit me sipërfaqe 127 m², të ndodhur në Durrës.

4. Analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën nga momenti i emërimit në detyrë datë 4.6.2012 deri më 31.12.2012, si dhe për vitet 2013 – 2016

4.1 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, për periudhën nga momenti i emërimit në detyrë datë 4.6.2012 deri më 31.12.2012, si dhe për vitet 2013 – 2016, nga ku dukej se për periudhën 4.6.2012 – 31.12.2012, si dhe vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 paraqitet me balancë negative fondesh, e konkretisht: (i) për periudhën 4.6.2012 – 31.12.2012, balanca negative e fondeve -753,758; (ii) për vitin 2013 – balanca negative e fondeve -548,843 lekë; (iii) për vitin 2014 – balanca negative e fondeve -2,328,067 lekë; (iv) për vitin 2015 – balanca negative e fondeve -510,520 lekë; dhe (v) për vitin 2016 – balanca negative e fondeve -558,465 lekë. Totali i balancës negative është në shumën -4,699,653 lekë⁶³.

4.2 Sa më sipër, referuar analizës financiare paraprake duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara nga Komisioni, për periudhën nga momenti i emërimit në detyrë datë 4.6.2012 deri në datën 31.12.2012, si dhe për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

4.3 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti depozitoi shpjegimet dhe argumentet e saj, si dhe prova të reja për të kundërshtuar rezultatet e analizës financiare.

4.4 Komisioni vëren se disa nga pretendimet kryesore të subjektit që lidhen me rezultatet e analizës financiare janë trajtuar si më sipër në këtë vendim. Kështu, pas analizës së kryer, trupi gjykues vlerësoi se shuma prej 8,000 euro, e transferuar nga personi i lidhur në datën 12.8.2014 në llogarinë e nënës së subjektit, nuk përfaqëson pagesë të kryer për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit me sipërfaqe 127 m², të ndodhur në Durrës. Gjithashtu, trupi gjykues vlerësoi se si burim për krijimin e depozitës në shumën 5,000 euro, në BKT, nga bashkëshorti i subjektit në dhjetor të vitit 2012, kanë shërbyer një pjesë e likuiditeteve të deklaruara si gjendje *cash* në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës. Edhe për sa i përket pagesës së kryer në dhjetor të vitit 2014, për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit në

⁶³Shihni tabelën e analizës financiare në faqen 24 të rezultateve të hetimit.

Durrës, trupi gjykues vlerësoi se si burim kanë shërbyer likuiditetet e deklaruara si gjendje *cash* në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës.

4.5 Në vijim të verifikimit të prapësimeve të subjektit Komisioni vëren se ato kanë të bëjnë me pretendime mbi reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit për periudhën objekt analize. Kështu, rezulton se subjekti ka pretenduar se disa shpenzime udhëtimi të bashkëshortit të saj kanë qenë për arsye pune dhe janë përballuar nga punëdhënësit, si dhe ka kërkuar reduktimin e disa shpenzimeve që lidhen me udhëtime familjare, pasi ato janë konfirmuar se janë mbuluar nga palët pritëse – njerëz të afërm dhe të njohur të tyre. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna subjekti ka depozituar dokumentacion justifikues si deklarata të palëve pritëse, si dhe vërtetime/deklarata nga punëdhënësit e bashkëshortit⁶⁴.

4.6 Pas analizimit të shpjegimeve dhe provave të administruara, Komisioni vlerësoi të reduktojë shpenzimet e udhëtimit bazuar në pretendimet e bëra nga subjekti, të cilat i gjeti bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor.

4.7 Pasi reflektoi ndryshimet përkatëse, Komisioni kreu analizën financiare përfundimtare, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit paraqitet me një balancë negative fondesh, në total për vlerën rreth 240,000 lekë, e shpërndarë për vitet 2013 (-41,748 lekë), 2015 (-194,150 lekë) dhe 2016 (-3,450 lekë).

4.8 Si konkluzion, pasi vlerësoi analizën financiare përfundimtare në optikën e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit – bazuar edhe në standardet e vendosura nga jurisprudenca e Kolegjit⁶⁵, trupi gjykues çmon se balanca negative fondeve e rezultuar, e shpërndarë në vite, nuk është në atë nivel sa të passjellë penalizimin e subjektit të rivlerësimit për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5. Gjetje të tjera nga hetimi administrativ

5.1 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni administroi një kontratë porosie me nr. ***, datë 19.12.2014.

5.1.1 Nga analizimi i kontratës së porosisë, datë 19.12.2014, të lidhur përpara noterit F. H. me seli në Durrës, me palë kontraktuese: (i) shoqëria “***” sh.p.k., regjistruar pranë QKR-së me NIPT ***, përfaqësuar nga administratori i saj A. M., në cilësinë e porositësit; dhe (ii) z. I. K., në cilësinë e të porositurit, merr përsipër ndihmën në fushën e menaxhimit, administrimit, reklamimit, kërkimit, gjetjes së tregut të shitjeve brenda dhe jashtë vendit të produkteve që tregton shoqëria dhe realizimin e shitjes së këtyre produkteve duke gjetur pasqyrim në rritjen e performancës së shoqërisë në tregun vendas dhe të huaj dhe zgjerimin e aktivitetit tregtar të saj dhe kontrata do t’i shtrijë efektet për një periudhë 5-vjeçare, pas nënshkrimit të saj nga palët me të drejtë ripërtëritjeje.

5.1.2 Më tej, në kontratë parashikohet se për shërbimin e bërë sipas objektit të kontratës, porositësi do të paguajë çdo muaj në favor të palës së porositur, vlerën prej 10% të fitimit real të ardhur nga aktiviteti i shoqërisë duke përfshirë edhe pagën mujore të tij.

5.1.3 Subjekti, e pyetur për këtë marrëdhënie, ka deklaruar se: *“Në lidhje me këtë kontratë porosie sqaroj Komisionin se bashkëshorti ra dakord me përfaqësuesin ligjor të shoqërisë, z. A. M., të nënshkruante këtë kontratë porosie ose shërbimi me qëllim arritjen e objektivit që synonte përfaqësuesi ligjor, rritja e të ardhurave nga tregtimi i produkteve dhe marrja e përfaqësimit të një brandi të ri pajisjesh elektroshtëpiake. Shoqëria “***” sh.p.k. nuk pati kapacitetet financiare dhe logjistike për rritjen e furnizimeve nga furnitorët e huaj dhe kushteve për të marrë përfaqësimin e këtij brandi të ri. Për këtë arsye, midis palëve, në ambientet e shoqërisë, në datën 30.1.2015, u nënshkrua revokimi i kontratës së porosisë.*

⁶⁴Shihni prapësimet e subjektit të rivlerësimit mbi analizën financiare, faqe 41-50.

⁶⁵Shihni vendimet nr. 31/2020(JR) dhe nr. 19/2022(JR) të Kolegjit.

*Në kushtet kur bashkëshorti i kishte shkëputur marrëdhëniet e punësimit me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë ‘***’ sh.p.k., z. A. M. iu propozua të lidhte një marrëdhënie punësimi me kohë të plotë dhe të fillonin të punonin për arritjen e objektivave të shoqërisë. Në këtë mënyrë bashkëshorti ka pranuar të fillojë punë me kohë të plotë në shoqërinë ‘***’ sh.p.k. Marrëdhënia e punësimit ka filluar në fillim të muajit shkurt 2015 dhe është shkëputur përfundimisht në janar 2018.*

Bashkëshorti nuk përfitoi asnjë të ardhur nga kjo kontratë shërbimi, as për vitin 2014 dhe as për vitin 2015, pasi kjo kontratë nuk filloi të zbatohet asnjëherë. Për këtë arsye nuk është deklaruar prej meje në DPV/2014 apo në periudhat e tjera vijuese. Në rubrikën ‘Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private’ është kërkuar të deklarohet/përshkruhet në lidhje me të ardhurat për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione e çdo angazhim e veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale edhe për bashkëshortin. Përshkrimi i të ardhurave dhe shuma e tyre.

Në DPV/2014 detyrimi ka qenë për të deklaruar të ardhurat e realizuara gjatë këtij viti dhe jo një marrëdhënie shërbimi, e cila nuk u zbatua asnjëherë. Për sa kohë që kjo kontratë nuk gjeneroi asnjë të ardhur apo të drejtë mbi ndonjë shumë, nuk ka qenë detyrim prej meje të deklarohet kjo marrëdhënie”.

5.1.4 Nënshkrimi i kontratës së porosisë nga ana e bashkëshortit të subjektit në vitin 2014 duhet të deklarohet në deklaratën periodike të vitit 2014, sikurse edhe revokimi i kontratës së porosisë qoftë edhe me një dokument, hartuar në zyrat e shoqërisë, duhet deklaruar në vitin 2015.

5.1.5 Referuar të dhënave të QKB-së rezulton se shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur fitime të deklaruara në bilancet kontabël përgjatë këtyre viteve dhe deklarimet e subjektit dhe bashkëshortit se nuk përfitoi asnjë të ardhur nga kjo kontratë porosisë/shërbimi, as për vitin 2014 dhe as për vitin 2015, nuk gjejnë mbështetje në dokumentacionin ligjor provues që rezultoi nga hetimi administrativ, pasi në vitin 2016 në deklarinë në ILDKPKI ka deklaruar vendimin nr. 2, datë 18.2.2018, të ortakut të vetëm të shoqërisë, nëpërmjet të cilit ortaku i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k. ka shpërblyer administratorin I. K. në përqindje me fitimin e realizuar nga shoqëria gjatë vitit 2017 për shumën 7,925 euro.

5.1.6 Sa më sipër, duket se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka shmangur nga detyrimi për deklarim të ardhura të pritshme të dakordësuara apo përfituara bazuar në kontratën e porosisë/shërbimit të lidhur mes palëve.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjekti ka barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

5.1.7 Në përgjigje të barrës së provës, dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me kontratën e porosisë me nr. ***, datë 19.12.2014, i qëndroj tërësisht deklarimeve të mia, të cilat mendoj se kanë qenë shteruese në lidhje me këtë kontratë dhe pavarësisht fitimeve të deklaruara në bilancet kontabël nga shoqëria ‘***’ sh.p.k. për vitet 2014 - 2015, ne nuk kemi përfutur asnjë të ardhur nga kjo kontratë. Bashkëshorti im në nëntor të vitit 2017 ka bërë një ndërhyrje në zemër, gjë e cila u bë edhe shkak për të lënë punën në shoqërinë ‘***’ sh.p.k. dhe vetëm pas largimit nga puna, në shkurt 2018 ortaku i vetëm i shoqërisë, z. A. M., ka shpërblyer administratorin I. K. për shumën 7,925 euro.*

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, ‘Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare’ i ndryshuar, në nenin 81 “Të drejtat dhe detyrimet”, pika d), përcaktohet se për shpërblyerimin e administratorit të shoqërisë është përgjegjëse ‘Asambleja e Përgjithshme’. Në momentin e shkëputjes së marrëdhënies së punës në cilësinë e administratorit të shoqërisë, bashkëshorti është shpërblyer me vendim ortaku sipas përcaktimeve të nenit 81 të ligjit të sipërcituar.

*Dëshiroj të theksoj se pikërisht kjo kontratë tregon se sa përpjekje ka bërë bashkëshorti im gjatë gjithë punës së tij në Shqipëri duke punuar me ndershmëri në shoqëri të ndryshme, duke u vendosur edhe emrin si ‘***’, ‘***’, etj. Në çdo lëvizje që bënte nga njëra shoqëri tek tjetra premtimet ishin shumë të mëdha, por ishin vetëm fjalë dhe i vetmi fitim i tij nga e gjithë puna ndër vite, deri në vitin 2017, ka qenë pikërisht shpërblimi që mori, pas ndërhyrjes në zemër, si administrator i shoqërisë ‘***’ sh.p.k., në shumën 7,925 euro, e cila sipas veprimit bankar rezulton të jetë 6,736 euro, deklaruar nga ana jonë në DPV/2018. Kjo shumë u dha sipas vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë datë 18.2.2018 dhe jo si rrjedhojë e kontratës së porosisë, e cila u lidh në datën 19.12.2014 dhe u revokua në datën 30.1.2015.*

Sa më lart, bashkëshorti nuk përfitoi asnjë të ardhur nga kjo kontratë shërbimi, as për vitin 2014 dhe as për vitin 2015, pasi kjo kontratë nuk filloi të zbatohet asnjëherë. Për këtë arsye nuk është deklaruar prej meje në DPV/2014, apo në periudhat e tjera vijuese. Në DPV/2014 detyrimi ka qenë për të deklaruar të ardhurat e realizuara gjatë këtij viti dhe jo një marrëdhënie shërbimi, e cila nuk u zbatua asnjëherë. Për sa kohë që kjo kontratë nuk gjeneroi asnjë të ardhur apo të drejtë mbi ndonjë shumë, nuk ka qenë detyrim prej meje të deklarohej kjo marrëdhënie.

Konstatimi i Komisionit se bashkëshorti ka shmangur detyrimin për deklarimin e të ardhurave të pritshme të dakordësuara apo përfituara bazuar në kontratën e porosisë/shërbimit të lidhur midis palëve, nuk qëndron.

Në pyetësorë është shpjeguar gjerësisht prej meje se kontrata nuk kishte filluar të zbatohet, çka do të thotë që bashkëshorti nuk kreu ndonjëherë shërbim sipas kësaj kontrate dhe nuk kishte si të deklaronte një të ardhur të pritshme. Në momentin kur kjo kontratë është revokuar, ende prej nesh nuk ishte deklaruar DPV/2014 dhe bashkëshorti ishte i qartë se nuk priste asnjë të ardhur, për sa kohë nuk kishte kryer asnjëherë shërbim bazuar në këtë kontratë. Për më tepër, të deklaronte përfitim nga kjo kontratë kur nuk kishte kryer ndonjëherë shërbim me qëllim që të përfitonte një kundërshpërblim për këtë kontratë të lidhur midis palëve.

Marrëdhënia e vitit 2014 nuk mund të ngatërrohet me përfitimin në vitin 2018, pasi janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme midis tyre, për të gjitha shpjegimet e dhëna më lart”.

5.1.8 Komisioni, pasi mori në analizë dhe vlerësoi provat dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, i konsideroi ato të mjaftueshme dhe bindëse me argumentin se nuk është detyrim ligjor deklarimi i të ardhurave të porealizuara apo i atyre të pritshme për t’u realizuar në të ardhmen. PAGESA E DHËNË NË VITIN 2018 ME VENDIM TË ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË, E DEKLARUAR NË DIPP/2018, NUK ËSHTË NJË PAGESË E KRYER NË RESPEKTIM TË KONTRATËS SË SHËRBIMIT/PUNËSIMIT DHE, PËR MË TEPËR, E KRYER NË KOHË REALE (PËR ÇDO MUAJ) DHE, PËR RRJEDHOJË, AJO NUK KISHTE SI TË DEKLAROHEJ NË DEKLARATAT E PASURISË PËR VITET PËRKATËSE KUR KA QENË NË FUQI KONTRATA E SHËRBIMIT/PUNËSIMIT.

Në lidhje me deklaratën noteriale të nënshkruar nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, z. M. K.

5.2 Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni administroi deklaratën noteriale nr. ***, lidhur në datën 23.10.2015, me deklarues K. Sh. dhe M. K.. Nga analizimi i përmbajtjes së aktit noterial⁶⁶ u konstatua se më 23.10.2015, para noteres M. N., deklaruesit K. Sh.⁶⁷ dhe M. K.⁶⁸ kanë deklaruar se K. Sh. ka në pronësi një apartament me vendndodhje në Durrës, Lagjja ***, rruga “***”, për të cilin ka nënshkruar një kontratë me OSHEE-në për furnizimin me energji elektrike. Meqenëse ky apartament përdoret nga z. M. K., deklaruesi K. Sh. është dakord që për këtë ambient të zgjidhet kontrata e sipërcituar nga emri i tij dhe të lidhet në emër të z. M.

⁶⁶Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.7.2022.

⁶⁷Shtetasi K. Sh. i datëlindjes 13.11.1953, me kartë identiteti nr. ***.

⁶⁸Shtetasi M. K. i datëlindjes 7.8.1943, me kartë identiteti nr. ***.

K. Ndërsa, z. M. K. deklaroi se apartamenti përdoret prej tij dhe familjes së tij dhe është dakord që kontrata me OSHEE/Durrës të lidhet në emrin e tij.

5.3 Ndërkohë që në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti, i pyetur se cila ka qenë adresa e banimit të prindërve të bashkëshortit për periudhën 2011 – 2016, si dhe nëse kanë qenë me qira sa ka qenë shuma e qirasë dhe cili ka qenë burimi i të ardhurave për mbulimin e këtyre shpenzimeve, ka deklaruar se: *“Deri në nëntor të vitit 2012 prindërit e bashkëshortit tim kanë jetuar në adresën L. ***, rr. ***, bulevardi kryesor, nr. ***, Durrës. Nga data 18.11.2012 deri në datën 7.6.2013 kanë qëndruar në Kanada tek vajza A. H.. Pas kthimit nga Kanadaja dhe deri në vitin 2016, sipas pyetjes, kanë jetuar në apartamentin në pronësi të shtetases A. T., të ndodhur në bulevardin kryesor Durrës. Vlera monetare që kanë paguar ka qenë 5.000.lekë/muaj dhe këtë shpenzim e kanë mbuluar me të ardhurat dhe kursimet e tyre”*.

5.4 Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka vendosur në dispozicion: (i) kopje të procesverbalit të veprimeve përmbartimore gjatë ekzekutimit datë 23.4.2013, në lidhje me dorëzimin e banesës së pronarëve; (ii) deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.12.2017 të shtetaseve A. T. dhe V. K..

5.5 Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.12.2017, midis shtetaseve A. T. dhe V. K., A. T. deklaroi se apartamentin me nr. ***, z. k. ***, me sip. 64.5 m², ndodhur në bulevardin kryesor Durrës, në pronësi të saj, ia ka lënë për banim që në muajin maj të vitit 2013 znj. V. K., si e pastrehë, me vlerë 5,000 lekë/muaj, deklarim ky që konfirmohet edhe nga vetë znj. V. K. në po këtë deklaratë.

5.6 Sa më sipër, duket se ka mospërputhje në lidhje me vendbanimin e prindërve të bashkëshortit të subjektit, pasi në përgjigje të pyetësorit nr. ***, si dhe në deklaratën noteriale të vendosur në dispozicion nga subjekti për këtë qëllim, deklarohet se prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë jetuar në apartamentin në pronësi të shtetases A. T., të ndodhur në bulevardin kryesor, Durrës, ndërsa sipas deklaratës noteriale të administruar gjatë hetimit administrativ rezultoi se z. M. K. dhe familja e tij përdorin një apartament me vendndodhje në Durrës, Lagjja Nr. ***, rruga “****”, në pronësi të shtetasit K. Sh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

5.7 Në përgjigje të barrës së provës të kaluar nga Komisioni si më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se për deklaratën e vjehrrit të saj, z. M. K., në datën 23.10.2015, hartuar nga notere M. N., ka ardhur në dijeni vetëm pas konstatimit/hetimit të kryer nga ana e Komisionit: *“Pas këtij konstatimi kam pyetur vjehrrin tim në lidhje me të dhe më ka thënë se kjo deklaratë ishte bërë me kërkesë të bashkëshortit të kunatës, shtetasit K. Sh.. Ky shtetas është bashkëshorti i tezes së bashkëshortit tim, shtetases N. Sh.. Familja Sh. jeton në Greqi, prej vitit 1991 (sipas edhe dokumentacionit që ju kam vënë në dispozicion më parë). Shtetasit K. dhe N. Sh., në qytetin e Durrësit në Lagjen ***, kanë një apartament banimi sipas kontratës së shitjes me kusht datë 20.3.2001, por që nuk e kanë të regjistruar në ASHK. Rreth muajit tetor 2015, prindërit e bashkëshortit tim, për arsye shëndetësore, kanë shkuar të jetojnë pak muaj në këtë banesë.*

*Në deklarimin tim në përgjigje të pyetësorit nr. ***, kam deklaruar se: ‘Pas kthimit nga Kanadaja në qershor 2013 dhe deri në vitin 2016, sipas pyetjes, prindërit e bashkëshortit kanë jetuar në apartamentin në pronësi të shtetases A. T., të ndodhur në bulevardin kryesor, Durrës, kundrejt një vlere monetare prej 5.000.lekë/muaj’. Sqaroj Komisionin se periudha e shkurtër e jetesës/qëndrimit së prindërve të bashkëshortit tim në banesën e motrës/kunatës, nuk është vlerësuar si adresë banimi nga ana ime, referuar pyetjes së Komisionit. Ata jetuan aty për rreth 3-4 muaj për arsye shëndetësore.*

Madje, në lidhje me këtë deklaratë noteriale, vjehrrin im ka bërë edhe një deklaratë në lidhje me motivin e kësaj deklaratë, ku pasi kanë menduar se realisht do të qëndronin aty, të jetonin nga baxhanaku, shtetasi K. Sh., i është sugjeruar vjehrrit bërja e deklaratës për efekt ndryshimi

të abonentit në kontratën me OSHEE-në. Kjo për të përfituar një kompensim që jepte shteti në lidhje me pensionistët për pagesën e energjisë elektrike. Megjithatë, ky ndryshim nuk është bërë asnjëherë për shkak se matësi i energjisë elektrike figuronte në emër të shoqërisë së ndërtimit.

Referuar VKM-së Nr. 8, datë 14.1.2015, pas datës 1.2.2015 nga ISSH-ja ka nisur procesi i kompensimit të energjisë elektrike. Kompensimi ka qenë për një shumë rreth 640 lekë/muaj.

Mosdeklarimi i kësaj adrese nga ana ime ka qenë totalisht i paqëllimtë dhe me arsyen e vetme pasi në këtë apartament kanë jetuar për pak muaj dhe se thelbi i pyetjes nga Komisioni kam menduar se i referohej në fakt banesës ku jetonin që nga viti 2013 dhe pagesës së qirasë, shumës dhe burimit të të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve. Në banesën e motrës së saj vjehrra ime ka qëndruar pak muaj dhe pa qira, pasi vetë familja Sh. jetonte në Greqi, nisur nga gjendja shëndetësore e vjehrrit dhe kushteve të mira akomoduese të kësaj shtëpie”.

Komisioni, pasi mori në analizë dokumentet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, i konsideroi ato të mjaftueshme dhe bindëse duke arritur në përfundimin se nuk ndodhet përpara veprimeve apo mosveprimeve të qëllimta nga ana e subjektit dhe/apo personit të lidhur me të, me qëllim fshehjen e interesave të caktuara pasurore në përgjithësi apo fshehjen e ndonjë pasurie në veçanti.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

6. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht.

6.1 Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ajo ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Edina Kurti nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

6.2 Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike/vjetore dhe në deklaratën e rivlerësimit si dhe balanca financiare negative në total për vlerën prej 240,000 lekë, e shpërndarë për vitet 2013 (-41,748 lekë), 2015 (-194,150 lekë) dhe 2016 (-3,450 lekë), nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

6.3 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta dhe balanca financiare negative, të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësisë.

6.4 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Edina Kurti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

7. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Edina Kurti, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ajo ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

8. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës⁶⁹ së subjektit të rivlerësimit Edina Kurti, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin e organizuar.

9. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Edina Kurti.

10. Komisioni ka kërkuar nga DSIK-ja përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione të reja të mundshme të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit, për subjektin e rivlerësimit Edina Kurti. DSIK-ja ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit shkresat e administruara nga institucionet e verifikimit – pas përpilimit të raportit mbi kontrollin e figurës, për këtë subjekt. Nga verifikimi i tyre nuk rezulton të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi kontakte të papërshtatshme dhe/apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit Edina Kurti, në veprimtari të kundërligjshme.

11. Në këtë kontekst, DSIK-ja nuk ka përpiluar një raport të ri për subjektin e rivlerësimit Edina Kurti, por me vendimin nr. ***, datë 7.7.2020, të KDZH-së ka deklasifikuar plotësisht raportin mbi kontrollin e figurës të dërguar më parë në Komision, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

12. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit Edina Kurti, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Edina Kurti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë

13. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka përpiluar raportin për analizën e aftësive profesionale, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, me short; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore.

Referuar raportit, subjekti i rivlerësimit Edina Kurti tregon korrektësi në zbatim të ligjit, si dhe shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Në vijim konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Edina Kurti, ka përballuar me efikasitet ngarkesën e punës dhe se ajo tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në hetim/gjykim. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të

⁶⁹Raport nr. *** prot., datë 2.11.2017.

dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk janë konstatuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

14. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe dokumentacionit mbi bazën e të cilit është hartuar ky raport; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni – në këtë kuadër; (iii) analizimit dhe vlerësimit të dosjeve të dy çështjeve të tjera penale të hetuara/shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit, evidentuar nga Komisioni pas verifikimit të informacioneve nga burime të hapura; dhe (iv) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni konstatoi se:

TRI DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Dokumenti 1 ligjor – kërkesë për gjykimin e çështjes nr. *** të vitit 2016⁷⁰ në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, datë 4.4.2016, me të pandehur Xh. S., i akuzuar për veprat penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese” dhe “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, të parashikuara nga nenet 79/dh dhe 278/8 të Kodit Penal dhe viktima shtetasit I. (I.) Xh. dhe M. Xh.. Subjekti i rivlerësimit ka bërë ndryshim të kualifikimit gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore nga neni 278/8 i Kodit Penal në nenin 278/2 të Kodit Penal, që ka qenë në fuqi deri para ndryshimeve me ligjin nr. 144/2013, bazuar në ndryshimet që ka pësuar dispozita, konkretisht ndryshimeve pas vitit 2013 dhe vendimit nr. 9, datë 26.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 13.1.2017, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit Xh. S. për të dyja veprat penale të cilësuar, duke e dënuar me 35 vjet burgim. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 17.10.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës. Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, sipas shkresës nr. *** prot., datë 16.4.2018, të Gjykatës së Lartë, nuk rezulton të jetë bërë rekurs.

Dokumenti 2 ligjor – kërkesë për vendosje të sekuestros preventive pranë ZVRPP-së Kavajë për parcelat në z. k. ***, ***, ***, Kavajë, për procedimin penal nr. ***. me të pandehur S. Sh., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, N. L., akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal, M. Xh., akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal, I. Th., akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe F. Gj., akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kallëzimet për këto katër procedime janë dërguar nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë prefektit të qarkut Tiranë, Njesisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit në Kryeministri dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 16.2.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, duke vendosur sekuestron preventive pranë ZVRPP-së Kavajë.

Dokumenti 3 ligjor – kërkesë për vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit (pa datë të pasqyruar) lidhur me procedimin penal nr. *** ndaj të pandehurve V. Gj., B. M., D. V., M. G., A. D. dhe M. Q. për kryerjen e veprës penale “falsifikim i dokumenteve shkollore”, parashikuar nga neni 187/2 i Kodit Penal, regjistruar mbi bazën e kallëzimit të Inspektoratit

⁷⁰Kjo kërkesë rezulton të jetë pa datë të pasqyruar, por referuar vendimit për dërgimin e çështjes për gjykim që është e datës 4.4.2016 dhe shkresës përcjellëse me të cilën është dërguar kërkesa për gjykim e dosja në gjykatë që është e datës 6.4.2016 është brenda periudhës së rivlerësimit.

Shtetëror të Arsimit Tiranë. Në datën 19.5.2016, prokurore Edina Kurti ka urdhëruar regjistrimin e emrit të shtetasit V. Gj. edhe për veprën penale “korrupsion pasiv në sektorin privat”, parashikuar nga neni 164/b i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur pranimin e kërkesave të Prokurorisë, duke vleftësuar si të ligjshme masat e sigurimit ndaj shtetasve V. Gj., B. M. dhe D. V..

Nga analiza e kryer për të tria dokumentet e paraqitura nga subjekti nuk janë konstatuar problematika që kanë të bëjnë me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

PESË DOSJET E PËRZGJEDHURA SIPAS NJË SISTEMI RASTËSOR DHE OBJEKTIV

Dosja 1 – vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, regjistruar mbi bazën e materialeve referuese të Komisarariatit të Policisë Kavajë, për shtetasin F. H., me banim në fshatin ***, për vdekje aksidentale. Në fashikullin penal është administruar edhe aktekspertimi mjeko-ligjor nr. ***, datë 5.1.2015, ku arrihet në konkluzionin se: *“Shkaku i vdekjes ka qenë trauma kafko-trunore e shoqëruar me dëmtime të rënda. Dëmtimet janë shkaktuar me mjet të fortë prerës”*. Vendimi i mosfillimit rezulton të jetë marrë brenda afatit 30-ditor, i caktuar me udhëzimin nr. ***, datë 22.11.2005, i ndryshuar me udhëzimin nr. ***, datë 19.6.2012, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit, që i atribuohet vepra penale” të Prokurorit të Përgjithshëm dhe është miratuar nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Me shkresën nr. *** prot., të datës 7.4.2016, firmosur nga drejtuesi i Prokurorisë, vendimi rezulton t’u jetë dërguar për njoftim subjekteve të interesuara. Ndaj vendimit të mosfillimit sipas shkresës me nr. *** prot., datë 29.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, nuk është ushtruar ankim në Gjykatë.

Pas analizimit të dosjes së fashikullit penal konstatohet se:

Nga analiza e fakteve dhe akteve pjesë e dosjes së hetimit vihet re se subjekti i rivlerësimit në vendimin e marrë i është referuar aktekspertimit mjeko-ligjor nr. ***, datë 5.1.2015, administruar në fashikullin penal, sipas të cilit *shkaku i vdekjes ka qenë trauma kafko-trunore e shoqëruar me dëmtime të rënda. Dëmtimet janë shkaktuar me mjet të fortë prerës* e, për rrjedhojë, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal bazuar në nenin 290, pika 1, germa “c” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas udhëzimit nr. ***, datë 24.1.2001, “Për rregulla të detyrueshme mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, kryerjes së autopsisë, ekzaminimeve dhe analizave”, në rastet e ngjarjeve me viktime të vdekjeve me dhunë të llojeve të ndryshme, si vrasje, vetëvrasje, aksident, lezione mekanike, vdekje të papritura jashtë ose brenda institucioneve shëndetësore etj., organet e Prokurorisë, të Policisë Gjyqësore dhe të ruajtjes së rendit janë të detyruara, krahas këqyrjes së kufomës, të marrin njëkohësisht të gjitha masat për ruajtjen e vendit të ngjarjes, fiksimin e gjurmëve dhe provave materiale.

Në pikën 2 të vendimit të mosfillimit është cituar se vendimi do t’u njoftohet palëve të interesuara, si edhe në përshkrimin më sipër të dosjes, citohet t’i jetë dërguar për njoftim subjekteve të interesuara, por nga aktet e përfshira në fashikull nuk konstatohet dërgimi dhe marrja dijeni nga palët e interesuara të vendimit të mosfillimit sipas nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, duke iu mohuar kësij palëve të drejtën për të realizuar të gjitha kërkesat kushtetuese e ligjore të një procesi të rregullt ligjor.

Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me këto konstatime të Komisionit.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Nga aktet e administruara në fashikull rezulton se në datën 27.2.2016, rreth orës 18:00, salla operative e Komisarariatit të Policisë Kavajë është njoftuar se në *** ka gjetur vdekjen shtetasi F. H., i datëlindjes 3.9.1951, lindur dhe banues në fshatin ***, Kavajë.

Pas kryerjes së veprimeve të para hetimore, policia gjyqësore ka referuar materialin për vlerësim për ngjarjen aksidentale të vdekjes së këtij shtetasi dhe me shkresën nr. ***, datë 2.3.2016, është dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Sipas formularit të Drejtuesit të Prokurorisë, në datën 2.3.2016, është përpiluar urdhri për regjistrimin e procedimit penal ose kryerjen e veprimeve verifikuese, duke u cilësuar se materiali kallëzues me nr. ***, datë 2.3.2016, rezulton se nuk duhet të regjistrohet për vlerësim. Subjekti shprehet se: *“Ky është një material kallëzues, i cili më është caktuar me short duke u njohur me të në datën 2.3.2016 dhe se në rastin konkret të gjitha veprimet e para hetimore janë kryer nga policia gjyqësore ditën e ngjarjes, në datën 27.2.2016”*.

Konkretisht policia gjyqësore ka kryer veprimet e para hetimore si këqyrja e kufomës, vendimi për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, procesverbal deklarimi, raport shërbimi për ngjarjen etj., sipas materialeve të dërguara nga Komisariati i Policisë Kavajë me shkresën nr. ***, datë 2.3.2016. Është pyetur djali i të ndjerit, i cili nuk ka pasur pretendime për ngjarjen, pasi prindërit jetonin vetëm në shtëpi. Po ashtu, edhe nga këqyrja e kufomës nuk janë evidentuar/konstatuar shenja dhune në pjesë të trupit. I vetmi dëmtim ka qenë pas koke, tek baza e kafkës. Gjithashtu është administruar aktekspertimi mjeko-ligjor, i cili është bazik në lidhje me ngjarjen dhe në konkluzion të të cilit ka rezultuar se shkaku i vdekjes së shtetasit F. H. ka qenë trauma kafko-trunore e shoqëruar me dëmtime të rënda të indit trunor me mekanizmin e komës së thellë.

Mbi bazën e këtyre akteve dhe brenda afatit 30-ditor (pasi datat 2 dhe 3 prill 2016 kanë qenë ditë e shtunë dhe e diel), në datën 4.4.2016 është vendosur mosfillimi i procedimit penal nr. ***, bazuar në nenin 290, pika 1, germa “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi i mosfillimit është miratuar nga drejtuesi i Prokurorisë dhe u është dërguar për njoftim familjarëve të të ndjerit me shkresën nr. ***, datë 7.4.2016. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim në gjykatë.

Vlerësimi i kryer nga Komisioni

Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, si dhe vlerësoi provat në dosjen penale, i gjen shpjegimet e subjektit të mjaftueshme dhe bindëse. Komisioni mban në konsideratë edhe faktin se vendimi i mosfillimit i marrë nga subjekti i rivlerësimit është miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe nuk është ankimuar në gjykatë nga familjarët e të ndjerit.

Dosja 2 – vendimi për pushimin e procedimit penal nr. *** i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë për veprën penale “fshehje e të ardhurave”, të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, mbi bazën e materialeve referuese nga Komisariati i Policisë Kavajë, datë 3.3.2015, sipas të cilave shtetasi S. Xh. së bashku me shtetasin Q. K. po transportonin artikuj ushqimorë të pashoqëruar me faturë tatimore përkatëse, për llogari të aktivitetit tregtar të regjistruar në emër të shtetasës Xh. D. Për kryerjen e këtij aktiviteti tregtar nuk administrohej ndonjë faturë tatimore shitjeje dhe as kasë fiskale. Të dy shtetasit S. Xh. dhe Q. K. punonin për shtetasen Xh. D., por vetëm shtetasi Q. K. ishte me kontratë të rregullt punësimi. Për sa më sipër, nga ana e organeve tatimore është vendosur masa administrative e konfiskimit të mallit pa faturën e duhur tatimore, që kapte një vlerë prej 200,000 lekësh dhe e dënimit me gjobë për punonjësën e padeklaruar S. Xh. Policia ka referim të ngjarjes konkrete në prokurori për veprat penale “fshehje e të ardhurave” dhe “punësim i paligjshëm”, të parashikuara nga nenet 180 dhe 170/a të Kodit Penal. Në datën 10.10.2015 është vendosur pushimi i çështjes për veprën penale “fshehje e të ardhurave” të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, bazuar në nenin 328, germa “b”, i Kodit të Procedurës Penale. Vendimi i pushimit të procedimit penal me nr. *** i është dërguar me shkresën me nr. *** prot., datë 29.10.2015, për njoftim shtetasës Xh. D., personi në emër të të cilit është regjistruar aktiviteti tregtar. Ndaj këtij vendimi pushimi, sipas shkresës nr. *** prot., datë 29.3.2018, nuk është bërë ankim në gjykatë.

Pas analizimit të dosjes së fashikullit penal konstatohet se:

i) Sipas urdhrorit mbi regjistrimin e procedimit penal konstatohet se subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale sipas kërkesave të pikës 3 të udhëzimit nr. ***, datë 22.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” i ndryshuar, të Prokurorit të Përgjithshëm, pavarësisht nga fakti që në referimin e policisë gjyqësore është evidentuar emri i personit, i cili mendohet se lidhet me veprën penale. Në rastet kur materiali i referimit të veprës penale nga policia gjyqësore shoqërohet me akte procedurale që përmbajnë atribuime për personin konkret, prokurori urdhëron si regjistrimin e njoftimit të veprës penale, ashtu edhe regjistrimin e emrit të personit.

ii) Rezulton se për një periudhë 4-mujore policia gjyqësore nuk ka realizuar veprimet sipas urdhrorit për delegim dhe, më tej, janë kryer disa prej tyre. Në fashikull është administruar edhe “relacioni mbi përfundimin e procedimit penal”, ku konstatohet se oficeri i policisë gjyqësore ka relatuar, ndër të tjera, se dosja penale është marrë dorazi nga subjekti i rivlerësimit vetëm në muajin gusht të vitit 2015, pavarësisht se urdhri i delegimit mban datën 1.4.2015.

iii) Me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2015, Drejtuesi i Prokurorisë konstaton zvarritje në hetim lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 6.3.2015.

Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me këto konstatime të Komisionit.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka shpjeguar se: “Ky procedim penal është regjistruar në datën 6.3.2015 mbi bazën e materialeve të dërguara nga Komisariati i Policisë Kavajë me shkresën nr. ***, datë 6.3.2015. Sipas formularit të Drejtuesit të Prokurorisë, në datën 6.3.2016 është përpiluar urdhri për regjistrimin e kallëzimit penal me nr. ***, datë 6.3.2015, duke u cilësuar se materiali kallëzues duhet të regjistrohet për veprën penale të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal.

Bazuar në nenin 287/1 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe, në të njëjtën kohë, ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. Gjatë kryerjes së veprimeve të para hetimore dhe nga tërësia e materialit të referuar nga policia gjyqësore, nuk ka pasur indicie për regjistrimin e emrit të personit, që i atribuohet vepra penale, ku në këto kushte është urdhëruar vetëm regjistrimi i procedimit penal.

Me urdhrin e datës 1.4.2015 është deleguar kryerja e veprimeve hetimore tek oficeri i policisë gjyqësore i ngarkuar me hetimin, duke përcaktuar datën 1.7.2015 si afat për kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore. Referuar relacionit shpjegues të oficerit të policisë gjyqësore, datë 9.10.2015, u relatua se dosja penale është marrë dorazi nga prokurorja e çështjes në gusht të vitit 2015 dhe dërgohet me shkresë sipas kërkesës tuaj, me veprimet e kryera të përmendura më lart. Pra, pikërisht kam ushtruar kontrollin periodik të dosjes, pasi, referuar urdhrorit të delegimit, veprimet hetimore duhet të kryheshin deri në datën 1.7.2015. Meqenëse dosja nuk ishte dërguar deri në këtë datë, në muajin gusht i është kërkuar oficerit të policisë gjyqësore të dërgojë dosjen me veprimet e kryera dhe relacionin shpjegues mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve. Pas studimit të dosjes dhe veprimeve të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore, dosja i është deleguar sërish oficerit të policisë gjyqësore, pasi nuk ishin kryer të gjitha veprimet hetimore që do të konkludonin mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve.

Në lidhje me shkresën nr. *** (***) datë 9.10.2015, kjo shkresë është konceptuar dhe hartuar nga ana ime, sipas iniciave në shkresë E. K. (Edina Kurti) dhe është nënshkruar nga Drejtuesi i Prokurorisë, për t’iu dërguar zyrtarisht Komisarariatit të Policisë Kavajë. Në këtë shkresë nga ana ime është kërkuar, ndër të tjera, të dërgohet edhe procedimi penal nr. ***, i shoqëruar me relacionin shpjegues mbi veprimet e kryera, ecurinë e hetimeve dhe sugjerimin mbi mënyrën e përfundimit të hetimit, duke cilësuar që dosja të dërgohet brenda datës 15.10.2015.

Pas kësaj shkresë, me shkresën e datës 14.10.2015, nga Komisariati i Policisë Kavajë është dërguar procedimi penal me veprimet hetimore të kryera dhe relacionin përfundimtar të oficerit të policisë gjyqësore.

Dëshiroj të theksoj se shkresa e dërguar nga ana ime tregon se unë vazhdimisht dhe periodikisht kam ushtruar kontroll mbi dosjet e deleguara tek oficerët e policisë gjyqësore, konform nenit 304 të Kodit të Procedurës Penale, duke kërkuar edhe zyrtarisht dërgimin e procedimeve penale të shoqëruara me relacion shpjegues mbi veprimet e kryera.

*Vendimi i pushimit të procedimit penal me nr. *** i është dërguar për njoftim shtetases Xh. D., me shkresën nr. ***, datë 29.10.2015, dhe ndaj vendimit të pushimit nuk është ushtruar ankim në gjykatë”.*

Vlerësimi i kryer nga Komisioni

Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerësoi materialet e dosjes penale, arrin në përfundimin se subjekti duhet të kishte treguar kujdesin e duhur profesional në lidhje me verifikimin e ecurisë së hapave proceduralë hetimore në lidhje me këtë dosje, si dhe me respektimin e afateve hetimore me qëllim pengimin e zvarritjeve të panevojshme, qofshin ato të karakterit objektiv apo edhe subjektiv.

Pavarësisht problematikave të mësipërme, Komisioni i vlerëson ato me një peshë minimale, se nuk arrijnë deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Dosja 3 – vendimi për pushimin e procedimit penal nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, regjistruar në datën 29.12.2014, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit I. X., pas kallëzimit të ardhur nga Komisariati i Policisë Kavajë, datë 7.8.2014. Nga aktet e procedimit penal nuk evidentohet të ketë urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore, por rezulton se nga prokurorja Edina Kurti në datën 3.3.2015 është bërë një vendim kryerje këqyrjeje në zyrën e ALUZINI-t Kavajë, ku është urdhëruar OPGJ-ja. Në procesverbalin e këqyrjes të datës 25.3.2015 konfirmohet se shtetasi I. J. X. ka aplikuar në datën 29.12.2014 për një ndërtim sipas formularit të aplikimit të bërë në korrik të vitit 2012. Në datën 20.4.2015 është bërë vendimi për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit teknik dhe në datën 25.5.2015 është përpiluar aktekspertimi përkatës, ku është konkluduar se punimet, e konstatuar në kohën e shkuarjes nga policia, nuk hynin në kategorinë e ndërtesës, duke mos përmbushur kriteret për të qenë ndërtim i paligjshëm. Në datën 10.6.2015 subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes, bazuar në nenin 328, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale. Vendimi i pushimit të procedimit penal me nr. ***, pasi është miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, është dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 9.7.2015, për njoftim shtetasit I. X., person i cili ka bërë ndërtimin. Ndaj këtij vendimi pushimi sipas shkresës nr. *** prot., datë 29.3.2018, nuk është bërë ankim në gjykatë.

Pas analizimit të dosjes së fashikullit penal konstatohet:

Sipas urdhrit mbi regjistrimin e procedimit penal konstatohet se subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, nuk ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale sipas kërkesave të pikës 3 të udhëzimit nr. 241, datë 22.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” i ndryshuar, të Prokurorit të Përgjithshëm, pavarësisht nga fakti që në referimin e policisë gjyqësore është evidentuar emri i personit i cili mendohet se lidhet me veprën penale.

Nga aktet e procedimit penal nuk evidentohet të ketë urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore, por rezulton se nga subjekti i rivlerësimit në datën 3.3.2015 është bërë një vendim kryerje këqyrjeje në zyrën e ALUZINI-t Kavajë lidhur me faktin nëse ka praktikë legalizimi nga shtetasi I. X. dhe për këtë është urdhëruar oficeri i policisë gjyqësore, që është caktuar me vendim zëvendësimi të datës 16.2.2015.

Referuar materialeve që i përkasin procedimit penal, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal në datën 29.12.2014, ndërkohë që shkresa e drejtuesit të Prokurorisë e datës 7.8.2014 urdhëron regjistrimin brenda afatit 30-ditor. Gjithashtu konstatohet se urdhri i regjistrimit të procedimit penal nga prokurori, datë 29.12.2014, është marrë në të njëjtën datë që është bërë aplikimi pranë ALUIZNI-t nga shtetasi I. X..

Në vendimin për pushimin e çështjes, i datës 10.6.2015, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, argumenton se, duke qenë se sipas formularit të deklaramentit rezulton se ndërtimi është kryer në vitin 2012, ligji nr. 22/2014, "Për dhënie amnistie", e përjashton nga ndjekja penale shtetasin I. X.. Në ligjin nr. 22/2014 "Për dhënie amnistie", neni 5, është parashikuar pushimi i ndjekjes penale, i cili kërkon plotësimin e dy kushteve në mënyrë kumulative, së pari, vepra penale të jetë kryer përpara datës 30.12.2013 dhe, së dyti, vepra penale të parashikojë një dënim deri në dy vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë. Si rrjedhim, konstatohet se vepra penale nuk mund të futet në atë bashkësi veprash që përfshihen në nenin 5 të ligjit të sipërpërmendur, pasi kallëzimi i ardhur nga Komisariati i Policisë Kavajë për kryerjen e veprës penale "ndërtim të paligjshëm" mban datën 7.8.2014.

Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me këto konstatime të Komisionit.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka shpjeguar se: *"Sipas formularit të Drejtuesit të Prokurorisë, në datën 7.8.2014 është regjistruar kallëzimi nr. ***, datë 7.8.2014, me shënimin 'Për vlerësim - pas administrimit të tabelës fotografike', si dhe disa akteve në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, më 29.12.2014 është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal nr. ***, për veprën penale 'ndërtim të paligjshëm', të parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal. Bazuar në nenin 287/1 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. Në këto kushte është urdhëruar vetëm regjistrimi i procedimit penal, duke ngarkuar me hetimin oficerin e policisë gjyqësore që ka kryer veprimet e para hetimore, si dhe cilësuar edhe në formularin e Drejtuesit të Prokurorisë.*

*Në datën 16.2.2015 Drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur zëvendësimi i oficerit të policisë gjyqësore me një tjetër oficer, për të vazhduar hetimet në procedimin penal nr. ***. Në fashikull nuk ka një urdhër shkresor në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore të deleguara për oficer të policisë gjyqësore, por për shkak të ngarkesës dhe hetimit në dinamikë ka pasur dhe ka raste që oficerit të policisë gjyqësore i janë deleguar veprimet edhe verbalisht, si në rastin konkret, nisur edhe nga fakti i zëvendësimit të oficerit të policisë gjyqësore, i cili ka qenë i ngarkuar fillimisht me hetimin.*

*Urdhri i regjistrimit të procedimit penal është në datën 29.12.2014. Me vendimin e datës 3.3.2015 është vendosur këqyrja e praktikës së aplikimit të shtetasit I. X. në zyrën e ALUIZNI-t Kavajë. Më 25.3.2016 është mbajtur edhe procesverbali i këqyrjes nga oficeri i policisë gjyqësore i ngarkuar me hetimin. Nga këqyrja dhe administrimi i praktikës së ALUIZNI-t rezulton se praktika në emër të shtetasit I. X. është me nr. *** prot., datë 29.12.2014, ku kjo datë rastësisht përkon me datën e regjistrimit të procedimit penal, por në një kohë kur kallëzimi është regjistruar në datën 7.8.2014 dhe çështja ishte në hetim.*

Në datën 20.4.2015 kam vendosur kryerjen e ekspertimit teknik në lidhje me ndërtimin. Në datën 25.5.2015 është administruar akti i ekspertimit teknik, ku nga eksperti është konkluduar, ndër të tjera, se punimi që po kryhej nuk hyn në kategorinë e ndërtesave, pra nuk i përmbush kriteret për të qenë ndërtim i paligjshëm, i cili po kryhej në truallin në pronësi të shtetasit I. X.. Sipas ligjit nr. 10 199, datë 23.4.2009, 'Për planifikimin e territorit', dhe VKM-së Nr. 502, datë 13.7.2011, 'Për miratimin e rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit', për këtë punim të kryer nuk merret leje ndërtimi.

Në këto kushte është vendosur pushimi bazuar në nenin 328, germa 'b' e Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Në vendimin e pushimit është shkruar që, sa i takon formularit të deklarimit, rezulton se ndërtimi është kryer në vitin 2012, ku ligji nr. 22/2014, 'Për dhënie amnistie', e përjashton nga ndjekja penale shtetasin I. X.. Pra, referuar kohës kur është kryer ndërtimi dhe ligjit nr. 22/2014, shtetasi I. X. përjashtohet nga ndjekja penale pikërisht për shkak të amnistisë. Pavarësisht datës që i referohet materiali kallëzues, data 4.8.2014, nga hetimi dhe aktekspertimi ka rezultuar se ndërtimi ishte kryer që në vitin 2012, pra plotësohej kushti që vepra penale ishte kryer përpara datës 30.12.2013.

Por, pavarësisht këtij interpretimi, sqaroj se procedimi penal është pushuar bazuar në nenin 328, germa 'b' e Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, referuar tërësisë së akteve të administruara, hetimeve të kryera, konkretizuar me procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, tabelën fotografike dhe aktekspertimin teknik, ku është konkluduar se nuk ndodhemi përpara kryerjes së një ndërtimi të paligjshëm”.

Vlerësimi i kryer nga Komisioni

Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerësoi materialet e dosjes penale, arrin në përfundimin se subjekti duhet të kishte treguar kujdesin e duhur në lidhje me respektimin e afateve hetimore, por, pavarësisht kësaj, Komisioni nuk e konsideron me aq peshë saqë të ndikojë negativisht në lidhje me vlerësimin profesional të subjektit, për sa kohë që e gjen të drejtë vendimmarrjen e subjektit dhe hapat proceduralë të ndjekur, që kanë çuar në këtë vendimmarrje.

Dosja 4 – kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. *** e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, regjistruar në datën 5.4.2014, në ngarkim të shtetasit R. L., për veprën penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, regjistruar mbi bazën e ngjarjes së datës 4.4.2014. Pas regjistrimit, subjekti i rivlerësimit brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 258/1 të Kodit të Procedurës Penale ka bërë kërkesën për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe në respektim të kushteve dhe kriterëve ligjore të parashikuara nga nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, e parashikuar nga neni 234 i këtij Kodi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 7.4.2014, ka pranuar kërkesën e prokurorisë për vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 16.6.2014, ka pranuar kërkesën e prokurores, si në deklarimin fajtor të të pandehurit, edhe në llojin e masës së dënimit të dhënë. Ndaj këtij vendimi gjyqësor, referuar dosjes të marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe informacionit nga Gjykata e Apelit Durrës me nr. *** prot., datë 17.4.2018, nuk rezulton të jetë ushtruar ankim.

Nuk janë konstatuar mangësi në lidhje me këtë dosje.

Dosja 5 – kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. *** e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë, regjistruar me urdhrin e datës 9.4.2014, pa emër personi që i atribuohet vepra penale, për veprat penale “vjedhje” dhe “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuara nga nenet 134/1 dhe 291 të Kodit Penal. Vendimi për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimi i akuzës është marrë në datën 10.11.2014 nga prokurorja për shtetasin K. M., duke e akuzuar për veprat penale “vjedhje” dhe “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuara nga nenet 134/1 dhe 291 të Kodit Penal. Në datën 11.12.2014 subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për dërgimin e çështjes për gjykim në ngarkim të të pandehurit K. M., i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 134/1 dhe 291 të Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 13.4.2016, ka pranuar kërkesën e prokurores Edina Kurti si në deklarimin fajtor të të pandehurit, edhe në llojin e masës së dënimit të dhënë. Ndaj këtij vendimi gjyqësor rezulton të jetë ushtruar ankim nga mbrojtësi i të pandehurit në Gjykatën e Apelit, e cila, me vendimin nr. ***, datë 22.6.2017,

ka vendosur mospranimin e ankimit për shkak të moslegjitimit të avokatit për të bërë ankim. Me shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2018, të Gjykatës së Lartë, rezulton që nuk ka rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës.

Pas analizimit të dosjes së fashikullit penal konstatohet:

Nga materialet që i përkasin procedimit penal rezulton se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale në datën 15.10.2014, ndërsa regjistrimi i procedimit penal është bërë në datën 9.4.2014 nga subjekti. Nga momenti i regjistrimit të procedimit penal deri në momentin e urdhërimit të regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, konstatohet se ka kaluar një periudhë prej rreth 5 muajsh dhe gjatë kësaj periudhe nuk janë kryer veprime hetimore të mëtejshme.

Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me këto konstatime të Komisionit.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka shpjeguar se: *“Në datën 9.4.2014 është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale ‘vjedhje’, të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Rasti i referohet ngjarjes së datës 8.4.2014, ku katër persona kanë shkuar tek një lokal në aksin rrugor Golem-Rrogozhinë dhe, pasi kanë konsumuar ushqim në vlerën 2,850 lekë, kanë ikur pa paguar. Bazuar në nenin 287/1 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe, në të njëjtën kohë, ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. Në këto kushte është urdhëruar vetëm regjistrimi i procedimit penal dhe kryerja e veprimeve hetimore në drejtim të elementeve të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal, nisur nga mekanizmi i ngjarjes.*

Po ashtu, gjatë hetimit ka pasur dyshime edhe në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, ku me shkresën e datës 20.10.2014, të DRSHTRR-së Berat, jemi informuar se shtetasi K. M. është i pajisur me leje drejtimi mjete të kategorisë B në datën 22.9.2015, pra disa muaj pas ngjarjes.

Kanë qenë pikërisht këto veprime hetimore që kanë konkretizuar në datën 22.10.2014 urdhrin për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale shtetasit K. M.. Po ashtu, gjatë hetimit janë hasur problematika edhe në lidhje me njoftimin e shtetasit K. M., ku pikërisht për këtë fakt është vendosur edhe mosgjethja e tij dhe dërguar çështja për gjykim në mungesë të të pandehurit, mbrojtur nga një mbrojtës i caktuar kryesisht sipas vendimit që ndodhet në fashikull.

*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 13.4.2016, ka vendosur, për sa ka kërkuar edhe prokuroria, deklarimin fajtor të të pandehurit K. M. për veprat penale të parashikuara nga neni 134/1 dhe 291 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin e datës 22.6.2017, ka vendosur mospranimin e ankimit të mbrojtësit të të pandehurit.*

Sqaroj se në mars të vitit 2014 jam rikthyer në detyrë, pas lejes së lindjes, dhe deri në dhjetor të vitit 2014 kam përballuar një ngarkesë pune prej 193 materialesh kallëzuese”.

Vlerësimi i kryer nga Komisioni

Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerësoi materialet e dosjes penale, arrin në përfundimin se subjekti duhet të kishte treguar kujdesin e duhur në lidhje me respektimin e afateve hetimore, por, pavarësisht kësaj, Komisioni nuk e konsideron me aq peshë saqë të ndikojë negativisht në lidhje me vlerësimin profesional të subjektit, për sa kohë që Komisioni e gjen të drejtë vendimmarrjen e subjektit dhe hapat proceduralë të ndjekur, që kanë çuar në këtë vendimmarrje.

Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore - vlerësimet)

Nga verifikimi i të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore nuk rezulton që subjekti Edina Kurti: të ketë masa disiplinore lidhur me punën e kryer; të ketë të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje të drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta; të ketë të dhëna të dokumentuara të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm; të ketë pasur ndaj saj procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Lidhur me vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me vlerësimin e punës, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë me vlerësimin “shumë mirë”, dokumentuar me aktin e lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016.

Lidhur me ankesat, shkresa me nr. *** prot., datë 18.5.2018, e sektorit të protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme, rezulton se:

Në datën 19.2.2018 shtetasi D. Ç. ka paraqitur një letër në Prokurorinë e Përgjithshme (pas përgjigjes së parë nga Prokuroria e Përgjithshme, ankuesi ka paraqitur një tjetër ankesë për subjektin pranë këtij institucioni), duke ngritur pretendime lidhur me veprimtarinë e prokurores Edina Kurti në procedimin penal nr. *** në ngarkim të shtetasit Q. Ç., djali i shtetasit D. Ç.. Ky i fundit është gjetur fajtor dhe dënuar për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga neni 79, germa “dh” e Kodit Penal, që lidhen me ngjarjen e datës 6.12.2016.

Pas analizës së kryer, Komisioni arrin në përfundimin se pretendimet e ngritura në letër nga ankuesit nuk qëndrojnë, për vetë faktin se pretendimeve të ankuesit u është dhënë përgjigje edhe nga gjykata gjatë zhvillimit të gjykimit të kërkesës për gjykim të dërguar nga ana e prokurores. Prokurorja ka pasqyruar në dosje të dhënat e sjella nga policia gjyqësore dhe veprimet hetimore të kryera gjatë hetimit, me të cilat rezulton se janë njohur të dy mbrojtësit e të pandehurit, të cilët, duke nënshkruar pa objeksione në njohjen me aktet dhe kërkesën për gjykim, kanë qenë dakord me vendimmarrjen e subjektit për dërgimin e çështjes për gjykim.

ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (a) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (b) pesë dosjeve të përzgjedhura me short; dhe (c) të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara rezulton se prokurorja Edina Kurti shfaq aftësi të mira në drejtim të zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme. Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit Edina Kurti ka aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e përgatitura prej saj paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore dhe etike. Teksti është i ndarë në paragrafë, fjalitë janë të qarta dhe vendosen referencat ligjore përkatëse penale, procedurale dhe, për rastet kur është e nevojshme, bëhet referimi edhe tek ligjet e tjera.

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se për tri vite 2014, 2015 dhe 2016, subjektit i janë caktuar për ndjekje gjithsej 667 çështje, nga të cilat ka përfunduar 637 çështje. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e

zhvilluar në datën 26.3.2018 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë për përzgjedhjen e pesë dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016 rezulton se prokurorja Edina Kurti tregon kujdes për respektim të afateve ligjore të kërkuara; në dosjet e shortuara me autor, veprimet hetimore kanë përfunduar brenda afatit tremujor të parashikuar në ligj nga momenti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale.

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Edina Kurti ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me përfundimin e një numri relativisht të madh çështjesh në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve të caktuara asaj për ndjekje për tri vite dhe vlerësimet që ka marrë në këto tri vite.

Subjekti i rivlerësimit Edina Kurti kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzimore u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme e duke arritur në vendimmarrje objektive. Përgjithësisht, veprimet procedurale janë dokumentuar mirë.

Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

Është për t'u evidentuar se në përgjithësi fashikujt e procedimeve të administruara përmbajnë formularët për kontrollin e ushtruar në dosjen penale, ku shprehet mendimi i drejtuesit të Prokurorisë mbi përfundimin e çështjes, dhe në fashikujt e procedimeve penale të dërguara për gjykim është përfshirë formulari mbi përfundimin e gjykimit, ku jepet një tablo përmbledhëse e kohës së regjistrimit e të dërgimit të çështjes për gjykim, emrin e të pandehurit dhe akuzën për të cilën është dërguar kërkesa për gjykim, datën e konkluzioneve dhe kërkesat e prokurorit në konkluzionet përfundimtare, datën e dhënies së vendimit përfundimtar të gjykatës dhe dispozitivin lidhur me deklarinimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit, qëndrimin e prokurorit të seancës për ushtrimin e ankimit dhe qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë për ushtrimin e ankimit (shihni dosjet lidhur me aktet e përzgjedhura nga subjekti me nr. 1 dhe 3 dhe dosjet e shortuara me nr. 1, 3, 4 dhe 5).

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nga verifikimi në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, sipas shkresës me nr. *** prot., datë 13.4.2018, rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016 për subjektin e rivlerësimit Edina Kurti nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Edina Kurti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nga tri dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e rëna në short vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Nga tri dokumentet ligjore dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Edina Kurti për të bashkëpunuar me kolegët

dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi, subjekti rezulton të ketë qenë pjesëmarrëse në trajnimin e zhvilluar në Shkollën e Magjistraturës me temë "Aftësimi i prezantimit të çështjes në gjyq", në datat 26-27 qershor 2014.

DENONCIME

Bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioni ka analizuar 8 denoncimet për subjektin e rivlerësimit, si vijon:

1. Denoncim nr. * prot., datë 14.9.2018, i shtetasit Z. S.,** regjistruar në Komision, me objekt "në lidhje me dy gjyqet e zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë i është mohuar e drejta nga subjekti i rivlerësimit dhe një subjekt tjetër për arsye korrupsioni". Denoncuesi ka bashkëlidhur dy vendime, përkatësisht: (i) vendimin nr. *** dhe vendimin nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e prokurorit të çështjes. Me vendimin nr. ***, datë 29.6.2016, me objekt "ankim ndaj mosfillimit të kallëzimit nr. ***, datë 12.6.2017", Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit Z. S. për prishjen e vendimit për mosfillimin e kallëzimit penal dhe vazhdimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit Q. E.. Kallëzimi penal është regjistruar me nr. ***, datë 12.6.2017, mbi bazën e materialeve të dërguara nga Komisariati i Policisë Rrogozhinë, për veprën penale "kanosje", parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit Xh. S.. Gjykata, pasi analizoi provat, vendosi rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në prova dhe në ligj, pasi organi i akuzës ka kryer të gjitha veprimet e domosdoshme për hetimin e kësaj çështjeje. Ndërsa në vendimin nr. ***, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur pranimin e kërkesës së organit të prokurorisë për pushimin e çështjes penale të procedimit penal nr. ***, datë 6.11.2017, në lidhje me kallëzimin nr. ***, datë 21.6.2017, për veprën penale "shpërdorim të detyrës" në ngarkim të shtetasit S. Xh..

Nga analiza e vendimeve bashkëlidhur denoncimit ka rezultuar se nga ana e organit të akuzës janë kryer një sërë veprimesh hetimore. Nisur nga fakti që pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, për vetë faktin se u është dhënë përgjigje edhe nga gjykata gjatë zhvillimit të proceseve, si dhe nuk referojnë ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e mëtejshëm të hetimit.

2. Denoncim i shtetasit V. T., i përsëritur 5 herë, regjistruar në Komision me nr. *** prot., datë 23.11.2018, nr. *** prot., datë 3.7.2019, nr. *** prot., datë 19.8.2019, nr. *** prot., datë 27.11.2019, nr. *** prot., datë 24.3.2020 dhe nr. *** prot., datë 29.1.2019, drejtuar subjektit të rivlerësimit dhe disa subjekteve të tjera, me objekt "shpërdorim detyrë", pasi vepronjë të organizuar dhe bëjnë akuza me bindje juridike dhe arrestime të paligjshme. Denoncuesi pretendon se qëndrimi i tij në burg përbën shkelje të rëndë të së drejtës dhe lirive themelore, pasi vendimmarrja është e padrejtë dhe e pabazuar në prova, pasi procesverbalet janë të papërdorshme në drejtim të fajësisë. Pretendimet denoncuesi i ngre kryesisht në lidhje me vendimin nr. ***, datë 6.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me objekt "vleftësimin e masës së sigurimit", për të cilin është vendosur pranimi i kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit për "Vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal", ndaj të dyshuarit, shtetasit V. T., për kryerjen e veprës penale "dhunë në familje", parashikuar nga germa "a" e pikës 4 të nenit 134 të Kodit Penal.

Nga analiza e vendimit bashkëlidhur denoncimit ka rezultuar se nga ana e organit të akuzës janë kryer një sërë veprimesh hetimore, janë respektuar të drejtat procedurale të palëve, konkretisht, të ndaluarit i është caktuar mbrojtës kryesisht, i janë bërë me dije faktet dhe provat dhe shkaqet e arrestimit/ndalimit, si dhe në vendim disponohet për të drejtën e ankimit.

Nisur nga fakti që pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, për vetë faktin se u është dhënë përgjigje edhe nga gjykata gjatë zhvillimit të procesit, si dhe nuk referojnë ndonjë provë apo shkelje procedurale konkrete nga subjekti i rivlerësimit, nuk janë konstatuar *indicie* për thellimin e mëtejshëm të hetimit.

3. Mbi informacionin e marrë nga portali [https://*.tvklan.al](https://***.tvklan.al)*****

“Prokuroria e Durrësit, me prokurore Edina Kurti, ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, pasi personi është arrestuar më 28 qershor 2020 dhe çështja është dërguar për gjykim më 5 nëntor 2020, pas gati 5 muajsh, duke kaluar afatin e hetimeve”.

Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë dosje të fashikullit përkatës për procedimin penal ndaj shtetasit I. P.. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2022, vendosi në dispozicion kopje të fashikullit.

Nga shqyrtimi i dosjes rezultoi se në datën 29.6.2020 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë është regjistruar procedimi penal me të pandehur I. P. për veprën penale “dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal, mbi bazë të materialeve të dërguara nga Komisariati i Policisë Kavajë. Për trajtimin e materialit kallëzues është caktuar me short në cilësinë e prokurorit të çështjes subjekti i rivlerësimit. Në datën 29.9.2020 prokurorja e çështjes vendos zgjatjen e afateve të hetimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2020 për një periudhë kohe prej dy muajsh, nga data 29.9.2020 deri në datën 29.11.2020.

Në datën 2.11.2020 subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë kërkesën për dërgimin e çështjes penale për gjykim ndaj të pandehurit I. P. për veprën penale “dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. *** datë 17.3.2021, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit I. P. për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal “dhunë në familje” dhe dënimin e tij me 18 muaj burgim. Vendimi është apeluar pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Pas analizimit të dosjes së fashikullit penal konstatohet se:

- Procesverbali, datë 29.6.2020, për marrjen e të dhënave nga shtetasja K. P., në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, konstatohet se është mbajtur jo në përputhje me kërkesat e pikës 3 të nenit 297 të Kodit të Procedurës Penale, e cila parashikon se “nëse të dhënat duhet të merren nga një i mitur duhet të sigurohet prania e prindit ose kujdestarit ose e një personi të rritur, të zgjedhur nga i mituri, si dhe prania e psikologut”. Bazuar në të dhënat e referuara në procesverbal, rezultoi se shtetasja K. P. ka qenë e mitur në kohën që është thirrur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, si dhe të dhënat janë marrë në prani të koordinatorit të viktimave dhe jo në prani të psikologut.
- Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale, rezultoi se oficeri i policisë gjyqësore ka mbajtur një procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime, I. P., në datën 28.6.2020, ora 23:30, ndërsa në datën 29.6.2020, ora 00:30, oficeri i policisë gjyqësore ka mbajtur një procesverbal për arrestimin në flagrancë të shtetasit I. P.. Sa i takon identifikimit të gjendjes së flagrancës, në zbatim të nenit 252 të Kodit të Procedurës Penale, arrestimi do të konsiderohet i kryer në kushtet e flagrancës, nëse është realizuar në kryerje e sipër të veprës penale ose menjëherë pas kryerjes së saj kur ndiqet nga policia gjyqësore, i dëmtuari ose persona të tjerë ose kur kapet me sende dhe prova materiale nga të cilat duket se ka kryer veprën penale, ndërkohë që në datën 28.6.2020 shtetasi I. P. është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime nga oficeri i policisë gjyqësore. Ndërsa pretendimi i ngritur në portal për tejkallim të afateve të hetimit nuk qëndron, pasi referuar akteve të dosjes penale rezultoi se subjekti i rivlerësimit në datën 29.9.2020 ka marrë vendim për zgjatjen e afateve të hetimit bazuar në nenin 324/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Sa më sipër, subjektit i janë kërkuar shpjegime lidhur me këto konstatime të Komisionit.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka shpjeguar se: *“Në datën 29.6.2020 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë është regjistruar procedimi penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit I. P., për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal. Pas hetimit të procedimit penal dhe tërësisë së akteve të administruara, në datën 2.11.2020 është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë procedimi penal në ngarkim të të pandehurit I. P., i akuzuar për kryerjen e veprës penale ‘dhunë në familje’, të kryer në prani të fëmijëve, të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal.*

*Në lidhje me procesverbalin e datës 29.6.2020, për marrjen e të dhënave nga shtetasja e mitur K. P., ky pretendim është ngritur edhe gjatë gjykimit të seancave paraprake nga mbrojtësja e të pandehurit. Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë me nr. ***, datë 15.12.2020, gjykata ka analizuar, ndër të tjera, pasi ka dëgjuar edhe parashtrimet e mia si prokurore e çështjes (f. ***, pika *** e vendimit), se:*

‘Në lidhje me pretendimet për pavlefshmëri të procesverbaleve të marrjes në pyetje të fëmijëve të mitur A. P. dhe K. P., të datave 29.6.2020 dhe 23.9.2020, gjykata vlerëson se pretendimet e ngritura janë të pabazuara dhe se ata janë pyetur në prani të psikologut dhe avokatit, pra kanë pasur asistencë psikologjike dhe ligjore’.

*Në lidhje me arrestimin në flagrancë të shtetasit I. P., gjithashtu Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 1.7.2020, ka vendosur vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit I. P., i dyshuar për kryerjen e veprës penale ‘dhunë në familje’, të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 6.7.2020.*

*Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. ***, datë 17.3.2021, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit I. P. për kryerjen e veprës penale ‘dhunë në familje’, të parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal dhe dënimin me 18 (tetëmbëdhjetë) muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale - dënimin përfundimisht me 12 (dymbëdhjetë) muaj burgim. Masë e njëjtë kjo me atë të kërkuar edhe nga prokurori.*

*Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 6.10.2021, ka vendosur mospranimin e ankimit të bërë nga i pandehuri për shkak se nuk ka më objekt”.*

Vlerësimi i kryer nga Komisioni

Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerësoi materialet e dosjes penale, i konsideron ato të mjaftueshme dhe bindëse, duke arritur në përfundimin se veprimet procedurale të kryera nga subjekti janë të rregullta dhe në përputhje me ligjin, duke u konfirmuar si të tilla edhe nga gjykatat me vendimmarrjet përkatëse.

4. Mbi informacionin e marrë nga portali [https://top-channel.tv/*\)](https://top-channel.tv/***))**

“Një 29-vjeçar ishte dënuar me 6 vite e 8 muaj burg nga Gjykata e Apelit e Milanos, Itali. Ky vendim u ekzekutua në shtetin shqiptar dhe prej vitit 2017 qytetari ndodhej në burg. Por, në 2018-ën Gjykata Kushtetuese Italiane ia uli dënimin nga 6 vite e 8 muaj burg në 5 muaj e 3 muaj burg. Vendimi i Kushtetueses Italiane mbërriti në Shqipëri në vitin 2020 në Ministrinë e Drejtësisë dhe më pas në Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë Kavajë dhe Burgun e Rrogozhinës.

Në vitin 2020 Prokuroria e Kavajës tentoi që të ‘njohë’ këtë vendim në gjykatë, por u rrëzua, me arsyetimin se ‘nuk ishte bërë kërkesa në mënyrën e duhur’. Prokurorja ‘harroi’ të korrigjonte gabimin apo ta apelonte, pasi u transferua në Prokurorinë e Durrësit. Dhe, gjatë kësaj kohe gjykata dhe prokuroria i kanë rrëzuar kërkesat mbrojtjes për shuarje mase.

Aktualisht, me uljet e dënimit, qytetari duhet të ishte liruar nga burgu në fillim të muajit dhjetor 2021”.

Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë dosje të fashikullit përkatës për procedimin penal ndaj shtetasit Xh. K. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2022, vendosi në dispozicion kopje të fashikullit.

Nga shqyrtimi i dosjes, në vitin 2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka marrë një vendim për “njohjen e vendimit penal të huaj”, dhënë nga gjykatësi për hetimet paraprake pranë Gjykatës së Milanos, që ka marrë formë të prerë në datën 24.3.2017, me anën e të cilit shtetasi Xh. K. është dënuar me 6 vjet e 8 muaj burg. Vendimi është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës në datën 4.4.2018.

Ndërkohë, në datën 22.5.2020, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë është përcjellë dokumenti me nr. prot., ***, me lëndë “Mbi njohjen e vendimit penal italian në ngarkim të shtetasit shqiptar Xh. K., në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese Italiane, e cila ka vendosur “Ripërcaktimin e masës së dënimit për shtetasin shqiptar Xh. K. prej 5 vitesh, 3 muaj e 3 ditë”. Pra, nga 6 vite e 8 muaj burg, dënimi është reduktuar në 5 vite e 3 muaj e 3 ditë burg.

Në vijim të kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë “Njohjen e vendimit penal të huaj në zbatim të sentencës nr. 40/2019 të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë në datën 19.10.2020 ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurores Edina Kurti, me arsyetimin se “mjete për të rregulluar situatën i zgjedhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë është jo i duhuri. Gjykata vlerëson se një mjet i mundshëm për t’u përdorur në rastin konkret mund të jetë rishikimi i vendimit që ka realizuar njohjen e vendimit penal të huaj”.

Pas analizimit të dosjes së fashikullit penal konstatohet se:

- Sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, datë 19.10.2020, mjete për të rregulluar situatën i zgjedhur nga Prokuroria, është jo i duhuri. Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë thuhet se “një mjet i mundshëm për t’u përdorur në rastin konkret është rishikimi i vendimit që ka realizuar njohjen e vendimit penal të huaj”.
- Pas këtij vendimi, nga aktet e fashikullit penal konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka apeluar këtë vendim me qëllim korrigjimin e objektit të kërkesës. Vendimi është rishikuar vetëm në datën 10.1.2022 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, pas kërkesës së Prokurorisë Kavajë, përfaqësuar nga një subjekt tjetër rivlerësimi. Referuar dispozitivit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, datë 10.1.2022, rezulton se shtetasi Xh. K. është mbajtur në burg tej kohës së caktuar në vendimin e ripërcaktimit të dënimit (rreth një javë tej afatit). Qëndrimi në burg i shtetasit Xh. K., tej kohës së caktuar në vendimin e dënimit, përbën shkelje të drejtave dhe lirive themelore, të sanksionuara në nenin 27 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime lidhur me këto konstatime të Komisionit.

Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka shpjeguar se: “Me shkresën nr. ***, datë 22.5.2020, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme ka dërguar për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë shkresën me lëndë mbi njohjen e vendimit penal italian në ngarkim të shtetasit shqiptar Xh. K.. Në shkresë cilësohet se: ‘Në vijim të komunikimeve tona lidhur me njohjen dhe ekzekutimin në Shqipëri të vendimit penal italian të dhënë në ngarkim të shtetasit Xh. K., ju përcjellim shkresën nr. ***, datë 18.5.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, me anë të së cilës ka transmetuar njoftimin dhe aktet e autoriteteve italiane për ripërcaktimin e masës së dënimit të dhënë në ngarkim të këtij subjekti, si dhe komunikimin e tyre. Sipas shënimit të Drejtuesit të

Prokurorisë Kavajë, në këtë shkresë praktika fillimisht i është dhënë për ndjekje prokurorit D. B., i cili kishte bërë njohjen e vendimit penal të huaj më parë, po ashtu edhe prokurorit të ekzekutimeve G. Ç., pasi bëhej fjalë për ripërcaktim të masës së dënimit të dhënë’.

Duke qenë se kjo kërkesë nuk ishte trajtuar ndonjëherë nga prokuroria në lidhje me ripërcaktimin e masës së dënimit të dhënë, pra pa objekt/mjet konkret ligjor, u shtrua për diskutim në mbledhje me Drejtuesin e Prokurorisë dhe kolegët. ‘Referuar materialit të dërguar nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe në komunikim me to është vendosur që t’i drejtoheshim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë me kërkesë për njohje vendimi penal të huaj, në zbatim të sentencës nr. 40/2019 të Gjykatës Kushtetuese Italiane. Bazuar në urdhëresën datë 21.10.2019 të gjyqtarit për hetimet paraprake pranë Gjykatës së Milanos, i cili ka ripërcaktuar dënimin me burgim prej 5 vjetësh, 3 muajsh dhe 3 ditësh burgim për shtetasin Xh. K., i cili ndodhej në I EVP Rrogozhinë’. Kërkesa është bërë nga ana ime në datën 27.5.2020, me objekt njohjen e vendimit penal të huaj në zbatim të sentencës nr. 40/2019 të Gjykatës Kushtetuese italiane. Bazuar në urdhëresën datë 21.10.2019 të gjyqtarit për hetimet paraprake pranë Gjykatës së Milanos, i cili ka ripërcaktuar dënimin me burgim prej 5 vjetësh, 3 muajsh dhe 3 ditësh burgim për shtetasin Xh. K.. Kërkesa është bërë pikërisht për t’i dhënë rrugë praktikës nëpërmjet gjykatës, ku njëkohësisht një kërkesë e tillë ishte paraqitur në gjykatë edhe nga mbrojtësi i shtetasit Xh. K..

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin datë 18.6.2020, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore në lidhje me objektin njohje e vendimit penal të huaj. Përfundimisht, në datën 19.10.2020, pas disa seancash gjyqësore në lidhje me mjetin e kërimit, gjykata, pasi dëgjoi edhe mbrojtësin, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, vendosi rrëzimin e kërkesës.

Në arsyetim të vendimit, gjykata konstaton se vendimi i Gjykatës Kushtetuese Italiane tregon se vendimi i njohjes është në kundërshtim me ligjin dhe duhet riparë (nuk ka qenë vendim penal i formës së prerë). Për sa i përket mjetit që duhet zgjedhur për të rregulluar situatën, gjykata vlerëson se një mjet i mundshëm për t’u përdorur në rastin konkret mund të jetë rishikimi i vendimit që ka realizuar njohjen e vendimit penal të huaj.

Në lidhje me këtë vendim është njoftuar Drejtuesi i Prokurorisë, si dhe Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Gjithashtu ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim as nga shtetasi Xh. K., pasi mbrojtësi pohoi se do t’i drejtoheshin gjykatës me një kërkesë të re pas administrimit të së gjithë praktikës nga autoritetet e drejtësisë italiane, ku do të saktësohej edhe mjeti i kërimit.

Në këto kushte, në datën 8.9.2021, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë është regjistruar çështja penale me kërkues Xh. K. me objekt: Njohjen dhe vazhdimin e ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë. Në këtë gjykim kanë marrë pjesë prokurorët e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, ndërkohë që unë vijoja punën si prokurorë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, nga muaji maj i vitit 2021.

Më tej me vendimin nr. 333, datë 21.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, është vendosur rrëzimi i kërkesës së kërkuesit Xh. K., qëndrim i cili edhe nga prokuroria është mbajtur i tillë. Objekt i këtij gjykimi rezulton sërish njohja e vendimit penal të huaj, ku mbrojtësi në seancën e datës 21.12.2021 ka cituar se shtetasi Xh. K. e ka përfunduar dënimin.

*Ndodhur në këto kushte, shtetasi Xh. K. i është drejtuar emisionit investigativ ‘***’. Pas interesimit të gazetarit investigativ në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në datën 10.1.2022 mbrojtësi i shtetasit Xh. K., por edhe prokuroria i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për rishikim vendimi penal dhe Gjykata në të njëjtën datë ka vendosur pranimin e kërkesës, duke urdhëruar edhe lirimin e menjëhershëm të shtetasit Xh. K..*

Sqaroj se shtetasi Xh. K. nuk ka qëndruar në burg tej kohës së caktuar në vendimin e ripërcaktimit të dënimit për shkak të mosankimimit të vendimit datë 19.10.2020 nga ana ime. Vetë fakti që gjykata me vendimin datë 10.1.2022 ka vendosur pranimin e kërkesave të

kërkuesit Xh. K., si dhe të prokurorisë, tregon të kundërtën. Gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit të njohur me vendimin e datës 9.2.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si dhe të dërgojë çështjen për rigjykim nga një tjetër trup gjykues.

*Gjej rastin të theksoj se në lidhje me këtë transmetim unë kam bërë edhe një reagim në emisionin ‘*** duke sqaruar pozicionin tim ligjor’.*

Vlerësimi i kryer nga Komisioni

Komisioni, pasi mori në analizë shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerësoi materialet e dosjes penale, konstaton se kërkesa për njohjen e vendimit penal të huaj është bërë si nga ana e subjektit, ashtu edhe nga ana e përfaqësuesve të të dënuarit dhe, pavarësisht vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës, konstatohet se nuk është bërë ankim në një gjykatë më të lartë as nga vetë avokatët e të dënuarit, çka do të thotë se ata kanë qenë në dakordësi dhe në të njëjtën linjë kërkimi si edhe vetë subjekti i rivlerësimit. Vlen të theksojmë se kërkimi i subjektit të rivlerësimit në gjykatë është bërë në konsultë me Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Edhe pas rrëzimit të kërkesës së subjektit nga gjykata, përfaqësuesit e të dënuarit kanë paraqitur kërkesë të re në gjykatë, ku përfshihej përsëri kërkimi i bërë më parë nga subjekti i rivlerësimit, çka nënkupton se edhe vetë përfaqësuesit ligjorë të të dënuarit e kanë gjetur të drejtë mënyrën e kërkimit në gjykatë të bërë nga ana e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht vendimit të gjykatës. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte reaguar në kohë ndaj vendimit datë 19.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për rrëzimin e kërkesës, me ankim ose me paraqitjen e një kërkesë të re në gjykatë, në një formë apo mënyrë tjetër, por marrë në konsideratë faktin se edhe vetë kërkesat e përfaqësuesve ligjorë të të dënuarit kanë qenë në të njëjtën linjë me atë të subjektit, si dhe nisur nga fakti se kjo çështje është vazhduar më tej nga prokurorë të tjerë për arsye të transferimit të subjektit të rivlerësimit në një prokurori tjetër, problematika e konstatuar nuk vlerësohet se arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin profesional, bazuar në pikën 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe dy çështjeve të tjera gjyqësore të trajtuara, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar rrethana, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Edina Kurti, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 1.11.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore në pakicë/kundër

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore

Ester Arapi